Hec "Smokthine" me fuqi 9,2 MW	9.200	"Albania Green Energy" sh.p.k	35 kV	32,761
Hec "Gjanç " me fuqi 2,96 MW	2.960	"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	35 kV	9,295
Hec "Bogove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"Wonder power" sh.a	35 kV	8,751
Hec "Stranik" me fuqi 4.6 MW	4.600	"Hidroinvest 1" sh.p.k	35kV	8,799
Hec "Zall Tore" me fuqi 3 MW	3.000		35kV	9,473
Hec "Borje" me fuqi 1.5 MW	1.500		35kV	5,869
Hec "Cernaleve " me fuqi 2.95 MW	2.950		"HIDROALBANIA Energji" sh.p.k	35kV
Hec "Cernaleve 1" me fuqi 3.27 MW	3.270		35kV	10,092
Hec "Peshke" me fuqi 3.43 MW	3.430	"Koka & Ergi Energy Peshk" sh.p.k	35kV	14,278
Hec "Selishte" me fuqi 2 MW	2.000	"Selishte" sh.p.k	35kV	5,329
Hec "Pobreg" me fuqi 12,3 MW	12.300	"Energy Plus" sh.p.k	35kV	44,457

Hec "Vlushe" me fuqi 14.2 MW	14.200	"Hec Vlushe" sh.p.k	35kV	35,761	
Hec "Faqekuq 1,2" me fuqi (3 MW; 3.4 MW)	6.400	"HP OSTROVICA" sh.p.k	35kV	18,327	
Hec "Koka 1" me fuqi 3,2 MW	3.200	"Snow Energy" sh.p.k	35kV	8,610	
Hec "Stravaj" me fuqi 3,6 MW	3.600	"Stravaj Energji" sh.p.k	35kV	15,156	
Hec"Vertop" me fuqi 1,52 Mw	1.520	"Hydro Salillari Energy" sh.p.k	35kv	2,044	
Hec"Martanesh" me fuqi 10,5 MW	10.500	"Albanian Power" sh.p.k	35kV	25,066	
Hec"Verba 1,2" me fuqi (2 MW, 3 MW)	5.000	"Hydro power Plant Of Korca" sh.p.k	35kV	14,559	
Hec"Fterra" me fuqi 1,08 MW	1.080	"Hidro Borshi" sh.p.k	35kV	11,336	
Hec"Treska4" me fuqi 3,6 MW	3.600	"Hec-Treske" sh.p.k	35kV	9,001	
Hec"Treska e Re" 5 me fuqi MW			35kV	257	
Hec"Sotire1 & 2" me fuqi 2,2 MW	2.200	"Hidro Energy Sotire" sh.p.k	35kV	7,053	
Hec"Sh.ales" me fuqi 1,08 MW	1.080	"Gjoka Konstruksion Energji" sh.p.k	35kV	2,870	
Hec"Strelce" me fuqi 1,174 MW	1.174		35kV	6,487	
Hec"Qarr" me fuqi 1 MW	1.000	"Hec Qarr & Kaltan" sh.p.k	35kV	4,789	
Hec "Vithkuq" me fuqi 2,715 MW	2.715	"Favina 1" sh.p.k	35/10kV	12,461	
Hec "Sasaj" me fuqi 8,6 MW	8.600	"Energo – Sas" sh.p.k	35kV	27,005	
Hec "Tervol" me fuqi 10.6 MW	10.600	"Hec i Tervolit" sh.p.k	35kV	39,365	
Hec"Lena 1" me fuqi 1,95 MW,;	1.950	"Gama Energy" sh.p.k	35kv	12,135	
Hec"Lena 2" me fuqi 2,3 MW	2.300		35kv		
Hec"Lena 2A" me fuqi 0,25 MW	0.250		35kv		
Hec "Driza" me fuqi 3,408 MW	3.408	"Mesopotam Energy" sh.p.k	35kv	3,408	
Hec Strelca 1,2,3 (1.504 MW, 0.325 MW, 3.52 MW)	5.349	"Strelca Energy" sh.p.k	35kv	5,967	
Hec "Ujanik 2" me fuqi 2,5 MW	2.500	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k	35kv	5,424	
Hec "Nishove" me fuqi 1,36 MW	1.360	"Nishova Energy" sh.p.k	35kv	1,478	
Hec "Ballenje" me fuqi 1,9 MW	1.900	"Ballenja Power Martanesh" sh.p.k	35kv	1,590	
Hec Gavran&Gavran 1	2.213	"Gavran Energy" sh.p.k	35kv	731	
Hec"Kacni" me fuqi 3,87 MW	3.870	"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	20kV	6,900	
Hec "Arras" me fuqi 4,8 MW (Diber)	4.800	"Balkan Green Energy" sh.p.k	20kV	13,256	
Hec "Lenie" me fuqi 400 kW	0.400	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10kV	2,980	
Hec "Çorovode" me fuqi 200 kW	0.200		10kV	864	
Hec "Bulqize" me fuqi 0,6 MW (Diber)	0.600	"Balkan Green Energy" sh.p.k	10kV	1,933	
Hec "Homesh" me fuqi 0,395 MW (Diber)	0.395		10kV	269	
Hec "Orgjost" me fuqi 1,2 MW (Kukes)	1.200		10kV	4,797	
Hec "Lekbibaj" me fuqi 1,4 MW (Tropoje)	1.400		10kV	5,285	
Hec "Dukagjin" me fuqi 0,64 MW (Shkoder)	0.640		10kV	2,292	
Hec "Marjan" me fuqi 0,2 MW (Korce)	0.200		10kV	583	
Hec "Lozhan" me fuqi 0,1 MW (Korce)	0.100		10kV	243	
Hec "Barmash" me fuqi 0,83 MW (Kolonje)	0.830		10kV	1,495	
Hec "Treske 2" me fuqi 0,25 MW (Korce)	0.250		10kV	796	
Hec "Nikolice" me fuqi 0,7 MW (Korce)	0.700		10kV	1,803	
Hec "Funares" me fuqi 1,92 MW (Librazhd)	1.920		10kV	6,035	
Hec "Lunik" me fuqi 0,2 MW (Librazhd)	0.200		10kV	1,183	
Hec "Ujanik" me fuqi 0,63 MW (Skrapar)	0.630		10kV	1,639	
Hec "Leshnice" me fuqi 0,38 MW (Sarande)	0.380		10/6kv	732	
Hec "Velcan" me fuqi 1,2 MW (Korce)	1.200		10kV	3,488	
Hec "Rajan" me fuqi 1,02 MW (Kolonje)	1.020		10kV	2,544	
Hec "Lure" me fuqi 0,75 MW (Diber)	0.750		10kV	808	
Hec "Xhyre" me fuqi 570 kW	0.570		"Amal" sh.p.k	10kV	2,464
Hec "Murdhar 1" me fuqi 2.68 MW	2.680		"HydroEnergy" sh.p.k	10kV	14,661
Hec "Murdhar 2" me fuqi 1 MW	1.000			10kV	7,914
Hec "Dishnice" me fuqi 0.2 MW	0.200		"Dishnica Energy" sh.p.k	10kV	685
hec "Lubonje" me fuqi 0.3 Mw	0.300		"Elektro Lubonje" sh.p.k	10kV	406
Hec"Shemri" me fuqi 1 MW	1.000		"Erald Energjitik" sh.p.k	10kV	2,484
Hec"Mgulle" me fuqi 0.28 MW	0.280			10kV	1,912
Hec"Kryezi 1" me fuqi 0.6 Mw	0.600		"Bekim Energjitik" sh.p.k	10kV	4,095
Hec"Carshove" me fuqi 1.5 Mw	1.500		"ERMA MP" sh.p.k	10kV	3,771
Hec"Ura e Dashit" me fuqi 1,2MW	1.200	10kV		10,336	
Hec"Gizavesh" me fuqi 0.5 MW	0.500	"Dosku Energy" sh.p.k	10kV	2,533	

Hec"Ostren i Vogel" me fuqi 0,32 MW	0.320	"Lu & Co Eco Energy" sh.p.k	10kV	1,041
Hec"Kozel" me fuqi 0,5 MW	0.500	"E.T.H.H. "sh.p.k	10kV	1,493
Hec"Helmes 1" me fuqi 0,8 MW	0.800		10kV	2,544
Hec"Helmes 2" me fuqi 0,5, MW	0.500		10kV	1,348
Hec"Qafezeze" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Caushi Energji" sh.p.k	10kV	1,953
Hec"Trebisht" me fuqi 1,775 MW	1.775	"SA.GLE.Kompani "sh.p.k	10kV	2,202
Hec"Mollaj" me fuqi 0,6 MW	0.600	"Energji Xhaci" sh.p.k	10kV	1,275
Hec"Tucep" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Tucep" sh.p.k	10kV	1,352
Hec"Shutine" me fuqi 2,4 MW	2.400	"Shutina energji"sh.p.k	10kV	2,026
Hec "Shpelle" me fuqi 400 kW	0.400	"Sarolli" sh.p.k	10kV	1,794
Hec "Treska 1" me fuqi 130 kW	0.130	Star NRG sh.p.k	10kV	835
Hec "Bicaj" me fuqi 3,1 MW	3.100	"EN-KU" sh.p.k	10kV	38
Hec "Leskovik 1" me fuqi 1072 kW	1.072	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	451
Hec "Leskovik 2" me fuqi 1100 kW	1.100		10kV	625
Hec "Orenjë" me fuqi 875 kW	0.875	"Juana" sh.p.k	10kV	1,178
Hec "Tamarë" me fuqi 750 kW	0.750	"WTS Energji" sh.p.k	10kV	880
Hec "Selce" me fuqi 1600 kW	1.600	"Selca Energji" sh.p.k	10kV	5,016
Hec "Radove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"MTC Energy" sh.p.k	10kV	10,040
Hec"Gurshpat 1" me fuqi 0,84 MW,	0.840	"Gurshpat Energy" sh.p.k	10kV	4,241
Hec"Gurshpat 2" me fuqi 0,83 MW	0.830		10kV	5,148
Hec"Perrollaj" me fuqi 0,5 MW	0.500	"Fatlum" sh.p.k	10kV	663
Hec"Koxheraj" me fuqi 0,62 MW	0.620	"Koxherri Energji" sh.p.k	10kV	961
Hec "Shtika" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Perparimi SK" sh.p.k	10kV	2,113
Hec "Labinot –Mal" me fuqi 0.25 MW	0.250	"Ansara Koncension" sh.p.k	6kV	383
Hec"Belesova 1" me fuqi 0.150 MW	0.150	"Korkis 2009" sh.p.k	6kV	280
Hec "Muhur" me fuqi 0,25 MW (Diber)	0.250	"Balkan Green Energy" sh.p.k	6kV	841
Hec"Picar 1" me fuqi 0,2 MW	0.200	"Peshku Picar 1" sh.p.k	6kV	531
Hec "Klos" me fuqi 1,95 MW	1.950	"Malido-Energji" sh.p.k	6kV	3,656
Hec "Zerqan" me fuqi 0,625 MW (Diber)	0.625	"Balkan Green Energy" sh.p.k	6kV	1,225
Hec "Kerpice" me fuqi 0,42 MW (Gramsh)	0.420	"Balkan Green Energy" sh.p.k	6kV	705
Hec "Borsh" me fuqi 0,25 MW (Sarande)	0.250	"Balkan Green Energy" sh.p.k	6kV	914
Hec"Cekrez 1,2" me fuqi (0,23 MW; 0.43 MW)	0.660	"Zall Herr Energji 2011"sh.p.k	6kV	4,065
Hec"Bisak" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Bardhgjana" sh.p.k	6kV	4,855
Hec "Benë" me fuqi 1000 kW	1.000	"Marjakaj" sh.p.k	6kV	1,358
Hec" Kumbull- Merkurth" me fuqi 0.83 Mw	0.830	"DN & NAT Energy"sh.p.k	6kV	2,292
Hec"Bistrica 3" me fuqi 1,57 MW,	1.570	"Bistrica 3 Energy" sh.p.k	6kV	10,104
Hec"Hurdhas 1" me fuqi 1,71MW,	1.710	"Komp Energji" sh.p.k	6kV	4,989

2,044,735

Figure 21 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et Private/Koncension për vitin 2016 (Burimi: OSHEE sh.a, KESH sh.a).

H/C PRIV/KONC SIPAS NIVELIT TE TENSIONIT TE PIKES SE LIDHJES				
	Nr. Impianteve	Nr. Subjekteve	Kapaciteti MW	Prodhimi 2016 (MWh)
220,110 Kv	32	20	345	1,382,940
35 Kv	38	31	150	465,194
20 Kv	2	2	9	20,156
10 Kv	53	31	46	140,246
6 Kv	14	12	11	36,199
	139	96	561	2,044,735
H/C PRIVATE/KONCESION SIPAS KAPACITETIT TË INSTALUAR				
	Nr. Impianteve	Nr. Subjekteve	Kapaciteti MW	Prodhimi 2016 (MWh)
MBI 15 MW	6		221	882,017
2- 15 MW	57		272	951,505
0-2 MW	76		69	211,212
	139	96	561	2,044,735

TE DHENA MBI SUBJEKTET DHE IMPIANTET PRIVATE/KONCESION, TE CILAT NUK KANË PATUR KONTRATA SHIT- BLERJE ME FPSH APO FSHU GJATE VITIT 2016				
HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2016
Hec "Ulez" me fuqi 25,2 MW	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	427,571
Hec "Shkopet" me fuqi 24 MW	24.000		110 kV	
Hec "Bistrica 1" me fuqi 22,5Mw	22.500		110 kV	
Hec "Bistrica 2" me fuqi 5 Mw	5.000		110 kV	
Hec "Peshqesh" me fuqi 27,94 MW,;	27.940	"Ayen As Energi" sh.a	220 kV	107,995
Hec "Banje" me fuqi 73 MW	73.000	"Devoll Hydropower" sh.a	110 kV	69,848
	177.640			605,413

TE DHENA MBI SUBJEKTET DHE IMPIANTET PRIVATE/KONCESION, TE CILAT KANË PATUR KONTRATA SHIT- BLERJE ME FPSH APO FSHU GJATE VITIT 2016			
NUMRI IMPIANTEVE	KAPACITETI	NUMRI SUBJEKTEVE	PRODHIMI
133 IMPIANTE	384 MW	93 SUBJEKTE	1 439 321 MWh

Një central Fotovoltaik i UKKO sh.a. me kapacitet rreth 1 MW ka prodhuar për nevojat e saj dhe ka pasur një kontratë bilaterale me OSHEE sh.a. nëpërmjet së cilës rakordohet sasia e prodhuar dhe sasia e konsumuar. Diferencat sistemohen në sasi energjetike për prodhim më të madh.

Prodhimi i këtij centrali nuk është përfshirë në bilancin energjetik të OSHEE sh.a. pasi nuk janë kryer rakordimet e nevojshme sipas kontratës ndërmjet tyre.

Prodhimi i përgjithshëm neto për vitin 2016 nga gjeneruesit privatë/koncesion ishte **2,044,735 MWh** ose **28.6 %** e prodhimit të përgjithshëm vendas **7,136,352 MWh**.

PRODIMI NE MWh I CENTRALEVE QE KANE HYRE NE PRODHIM GJATE VITIT 2016																
CENTRALET	KAPACITET I (MW)	SUBJEKTI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHIATOR	TETOR	NETOR	DHJETOR	2016	
Hec "Cernaleve 1" me fuqi 3.27 MW	3.27	"HIDROALBANIA Energji" shpk	0	985	1,588	1,541	1,406	672	338	212	342	911	1,513	584	10,092	
Hec "Ujanik 2" me fuqi 2,5 MW	2.5	"HP Ujaniku Energy" shpk	35kv	0	1,143	1,093	790	879	312	0	0	35	337	553	283	5,424
Hec "Nishove" me fuqi 1,36 MW	1.36	"Nishova Energy" shpk	35kv	0	590	340	180	205	107	0	0	0	0	57	0	1,478
Hec "Ternove" me fuqi 0,921 Mw	0.921	"DITEKO" shpk	111 kV			6	3,022	1,921	(9)	4	1,167	561	(16)	638	312	7,606
Hec "Vertop" me fuqi 1,52 Mw	1.52	"Hydro Salillari Energy" shpk	35kv	0	0	0	227	678	365	0	0	0	330	270	174	2,044
Hec "Trebisht" me fuqi 1,775 MW	1.775	"SA.GLE.Kompani" shpk	10kV	0	0	0	88	801	170	0	0	18	231	642	252	2,202
Hec "Koxheraj" me fuqi 0,62 MW	0.62	"Koxherri Energji" shpk	10kv	0	0	0	188	227	75	19	6	58	154	160	75	961
Hec "Shtika" me fuqi 1,3 MW	1.3	"Perparimi SK" shpk	10kv	0	0	0	1,117	441	236	2	0	10	14	225	68	2,113
Hec "Ballenje" me fuqi 1,9 MW	1.9	"Ballenja Power Martanesh" shpk	35kv	0	0	0	0	710	73	0	0	0	292	457	57	1,590
Hec "Malla" me fuqi 5,455 MW	5.455	"Gjure Rec" shpk	110 kV							297	183	246	1,611	2,000	718	5,056
Hec "Rapuni 2" me fuqi 4.1 MW	4.1	"C & S Construction Energy" shpk	110 kV								2	758	2,426	3,460	1,808	8,453
Hec "Banje" me fuqi 73 MW	73	"Devoll Hydropower" sha	110 kV									2,066	19,991	27,453	20,338	69,848
Hec "Borje" me fuqi 1.5 MW	1.5	"HIDROALBANIA Energji" shpk											1,414	3,069	1,387	5,869
Hec "Treska e Re" 5 me fuqi MW		"Hec-Treske" shpk		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	247	11	257
Hec Gavran&Gavran 1	2.213	"Gavran Energy" shpk												568	164	731
Hec Prella me fuqi 14.97 MW	14.97	"Prelle Energji"	110 kV												103	103
	116.404															123,828

Figure 22 Prodhimi nga HEC –et private që kanë filluar prodhimin gjatë 2016.

Në tabelën 22, është paraqitur prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike i HEC-ëve që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2016.




Figure 23 Ecuria e Prodhimit nga HEC-et prodhues me përparesi (Burimi: ERE).

Në grafikun e Figurës 23 është paraqitur ecuria e prodhimit nga HEC-et prodhues me përparësi privatë ose të dhënë me konçension (deri 15 MW), si dhe nga HEC Ashta gjatë periudhës 2006 – 2016.

Nga grafiku vihet re ritmi i lartë i rritjes së prodhimit nga HEC-et e dhënë me konçension, veçanërisht gjatë periudhës 2008-2016. Një rritje e konsiderueshme u vërejt gjatë vitit 2013 dhe 2016.

Në grafikun e figurës 24 janë paraqitur të ardhurat nga shitjet e energjisë elektrike të subjekteve private tek KESH/FPSH, OSHEE/FSHU.




Figure 24 Të ardhurat e realizuara nga shitjet e prodhuesve me përparësi (Burimi: OSHEE sh.a + KESH sh.a).

1.2.5 Efiçienca e Prodhimit të Energjisë Elektrike

Efiçienca e prodhimit të energjisë elektrike të sistemit tonë Elektroenergjetik për vitin 2016 vlerësohet si më poshtë:

- Akumulimi i energjisë elektrike në formë rezerve potenciale hidroenergjetike është kryer në përputhje me situatat hidrike dhe nevojave për energji;
- Është kryer optimizim i prodhimit dhe import/eksportit në funksion të nevojave për energji elektrike;
- Është realizuar mbulimi i pikut të ngarkesës;
- Është përshtatur prodhimi publik sipas kushteve hidrologjike;
- Shkarkimet e ujit janë kryer për mbrojtjen e sigurisë së digave;

1.3 Transmetimi i Energjisë Elektrike

1.3.1 Veprimtaria e OST sh.a.

Veprimtaria e Transmetimit të Energjisë Elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. OST sh.a. është krijuar në vitin 2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar vertikalisht që kryente funksionet e gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në tre shoqëri të veçanta.

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

“Sistemi i Transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

OST sh.a. kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispeçerimit dhe Operatorit të Tregut.

OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- (i) furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe klientëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit,
- (ii) transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit,
- (iii) si dhe për tranzitimin dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Në këtë kuadër ai zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planët e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit me vendet fqinje. OST sh.a. dispeçeron sistemin Elektroenergjetik nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera.

Një rol i rëndësishëm është dhe ai i Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike, funksionet e të cilit po zgjerohen gradualisht me hapat që po hidhen për krijimin dhe konsolidimin e një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë elektrike në rajon.

Gjatë vitit 2016 Operatori i Tregut ka zhvilluar rregullisht ankandin vjetor, mujor dhe ditor të kapaciteteve të interkonjeksionit për kufirin Shqipëri-Kosovë, ndërsa për kufinj të tjerë ky ankand zhvillohet nga Zyra e Koordinuar e Ankandëve për Europën Juglindore SEE CAO.

Operatori i Tregut në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike ka kryer procesin e përgatitjes së pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjellta për pjesëmarrësit e tregut.

1.3.2 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV, 110 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkonjeksionit ndërkombëtar.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit janë:

• Linjat e transmetimit 400 kV	445.6 km
• Linjat e transmetimit 220 kV	1150.3 km
• Linjat e transmetimit 150 kV	34.4 km
• Linjat e transmetimit 110 kV	1586.5 km

Në përbërje të linjave të mësipërme përfshihen dhe linjat e interkonjeksionit me vendet fqinje:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tirane (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tirane (Shqipëri) – Prishtine (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierze (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplík (Shqipëri) – Podgorice (Mali i Zi)
- Linjë e interkonjeksionit 150 kV Bistrice (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).

Kapaciteti i shkëmbimit me vendet fqinje është i mjaftueshëm për të realizuar shkëmbimet e nevojshme dhe tranzitimet e kërkuara në çdo kohë.




Figure 25 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.




Figure 26 Sistemi i Transmetimit Shqiptar.

Fuqia transformuese e nënstacioneve të sistemit të transmetimit sipas nivelit të tensionit		
Emërtimi	Njësia	Fuqia
Transformatorë 400/220 kV	MVA	1,200
Transformatorë 400/110 kV	MVA	300
Transformatorë 220/110/20 kV	MVA	240
Transformatorë 220/110/TM kV	MVA	2,120
Transformatorë 220/20 kV	MVA	126
Transformatorë 150/110 kV	MVA	40

Gjatësia e Linjave dhe Kablove të Transmetimit (OST)		
Voltazhi (kV)	Gjatësia (km)	
	Linja Ajrore	Kabull
400	293.6	
220	1150.3	
154	34.4	
110	1576.15	6.3
Total	3054.4	6.3

Kapaciteti i Transformatorëve (MVA) (OST)					
Emri i Nënstationit	Numri Transform.	Fuqia	Voltazhi		
		TL(MVA)	TL(kV)	TM(kV)	TU(kV)
FIERZA	1	30.0	242.0	121.0	10.5
FIERZA	2	30.0	242.0	121.0	10.5
VAU DEJA	1	120.0	230.0	121.0	10.5
VAU DEJA	2	120.0	230.0	121.0	10.5
KOPLIKU	1	90.0	220.0	115.0	38.5
BURRELI	1	60.0	230.0	115.0	11.0
BURRELI	2	60.0	230.0	121.0	11.0
TIRANA1	1	120.0	220.0	115.0	37.6
TIRANA1	2	120.0	220.0	115.0	37.6
TIRANA1	3	120.0	220.0	115.0	37.6
TIRANA1	4	63.0	220.0		21.6
TIRANA1	5	63.0	220.0		21.6
TIRANA2	1	300.0	400.0	230.0	20.0
TIRANA2	2	300.0	400.0	230.0	20.0
TIRANA2	3	120.0	220.0	115.0	20.8
TIRANA2	4	120.0	220.0	115.0	20.8
RRASHBULL	1	100.0	220.0	115.0	20.0
RRASHBULL	2	100.0	220.0	115.0	20.0
SH.ARRE	1	100.0	225.0	130.0	15.0
SH.ARRE	2	90.0	220.0	115.0	38.5
ELBASAN1	1	90.0	220.0	115.0	38.5
ELBASAN1	2	90.0	220.0	115.0	38.5
ELBASAN1	3	120.0	220.0	115.0	37.6
ELBASAN2	1	300.0	410.0	220.0	30.0
ELBASAN2	2	300.0	410.0	220.0	30.0
FIERI	1	120.0	220.0	115.0	37.6
FIERI	2	120.0	220.0	115.0	37.6
FIERI	3	120.0	220.0	115.0	37.6
BABICA	1	100.0	220.0	115.0	37.0
BABICA	2	100.0	220.0	115.0	37.0
ZEMBLAK	1	150.0	400.0	115.0	20.0
ZEMBLAK	2	150.0	400.0	115.0	20.0
BISTRICA	1	40.0	170.0	115.0	6.0
TOTAL		4026.0			

1.3.3 Bilanci i energjisë elektrike të transmetuar nga OST sh.a.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet bilanci energjetik i OST sh.a. për vitin 2016 krahasuar me atë të vitit 2015 (GWh).

Nr.	Bilanci Energjetik i OST sh.a (GWh)	2015	2016
I	ENERGJI TOTALE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT	7,830	8,462
1	- Prodhimi vendas	5,475	6,636
2	- Energji në marrje	2,355	1,827
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	7,672	8,272
1	- Energji në dhënie	956	1,869
2	- Energji e transmetuar për OSHEE sh.a.	6,106	5,901
3	- Energji e transmetuar për klientë të lidhur në rrjetin e transmetimit	610	503
III	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+NV	159	190
	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+NV (%)	2.03	2.25

Figure 27 Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2016 krahasuar me atë të vitit 2015 (GWh).

1.4 Gjendja e Përgjithshme e Sistemit të Energjisë Elektrike referuar Nenit 25 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

a) Siguria Operative e Rrjetit.

Një nga detyrat kryesore të OST-së është sigurimi i aftësisë afatgjate të Sistemit për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurtë, të besueshme dhe efikase Sistemin e Transmetimit, duke kontribuar njëkohësisht në sigurinë e furnizimit nëpërmjet sigurisë së Sistemit dhe kapaciteteve të qëndrueshme të transmetimit.

Duhet theksuar se me vënien në punë të linjës 400 kV Elbasan2 – Tirana2 – Podgorica2, dhe n/st 400/220/110 kV Tirana2, siguria e operimit të rrjetit transmetues është rritur së tepërmi. Për më tepër, me ndërtimin e linjës tjetër të re të interkonjeksionit Tirana2 – KosovaB, e cila është gati për tu vënë në operim, rritet edhe me tej siguria e operimit të sistemit. Me investimet e bëra në rrjetin e transmetimit dhe sidomos me vënien në punë të sistemit të kontroll monitorimit SCADA/EMS, OST sh.a. siguron shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e Sistemit të

Transmetimit, bazuar në standartet dhe praktikat më të mira, të cilat aplikohen nga operatorët e sistemeve të transmetimit të ENTSO-E, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe shkëmbim të sigurtë dhe cilësor të energjisë elektrike në vend dhe rajon.

Sigurinë operative të rrjetit, OST sh.a. e garanton nëpërmjet zbatimit të kodit të operimit, pjesë e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, i cili përcakton kërkesat minimale të qarta dhe objektive për sigurinë e punës në kohë reale, dhe arritjen e qëllimit kryesor për të mbajtur në operim të vazhdueshëm Sistemin Transmetues Shqiptar të ndërlidhur me Sistemin European të Transmetimit (zona sinkrone e Europës Kontinentale) në mënyrë që të kontribuojë për një kuadër të harmonizuar për zbatimin e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe për të siguruar mos-diskriminim, konkurrencën efektive dhe funksionimin efikas të tregut. Rregullat për Sigurinë e Operimit paraqesin principet e sigurisë operative në aspektin e nevojave teknike, duke konsideruar operimin e tregut në pajtueshmëri dhe në mbështetje me sigurinë e furnizimit. Këto parime të sigurisë operative janë thelbësore për OST-në për të menaxhuar përgjegjësitë e saj për funksionimin e Sistemit në interkonjeksion, me një nivel të lartë të koordinimit, besueshmërisë, cilësisë dhe stabilitetit. Një objektivi kyç i OST-së është arritja e një kuadri teknik të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë zbatimin e të gjitha proceseve të nevojshme të kërkuara për sigurinë e operimit, duke marrë parasysh sfidat aktuale dhe të pritura, përfshirë rritjen e shpejtë të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe ndikimin e tyre në operimin e Sistemit.

Garantimi i Sigurisë Operacionale, besueshmërisë dhe cilësisë nënkupton sigurimin e një niveli të përbashkët të sigurisë brenda Sistemit Interkonjektiv European, që kërkon bashkëpunimin e ngushtë të OST-ve, Sistemeve të Shpërndarje-ve, dhe Përdoruesve të rëndësishëm të Rrjetit. Në mënyrë që të përcaktohen kërkesa të qarta dhe objektive, nga ana e OST-së janë konsideruar kategoritë e mëposhtme:

Gjëndjet e Sistemit

Monitorimi i vazhdueshëm i situatës së Sistemit, bazuar në sistemin SCADA, me vlerat e matura në kohë reale (realizuar nga Qendra e Re Dispeçer) të parametrave operacionale, me informacione permanente online të gjëndjes së ndërsjelltë të Sistemit midis OST-ve fqinje, bën të mundur vlerësimin efektiv të situatës së Sistemit, dhe gjithashtu mundëson përgatitjen e veprimeve përmirësuese, në mënyrë që të mbahet Sistemi në një gjëndje normale apo të kthehet në normalitet sa më shpejt të jetë e mundur në raste të avarive. Monitorimi i gjëndjes së Sistemit kontribuon për një sjellje koherente dhe të koordinuar të Sistemeve të ndërlidhura të Transmetimit, si në zonën e përgjegjësisë të OST-së ashtu edhe ndërmjet zonave të përgjegjësisë.

Qendra e Kontrollit të Sistemit në OST është e pajisur me një sistem kompleks kompjuterik që siguron grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave nga objektet (nënstationet dhe centralet). Disponueshmëria e tyre mbështetet në redundancën e komponentëve të hardware-it dhe software-it, si dhe bazat e tyre të të dhënave. Pra, qendra e kontrollit në QDS është e pajisur me një sistem kontrolli kompjuterik (SCADA/EMS) që kryen këto funksione kryesore:

- Grumbullimin, përpunimin, shfaqjen (në ekran) dhe arkivimin e të dhënave të marra në distancë;
- Analizën sistematike të sigurisë operative në kohë reale dhe në mënyrë të studimit (study mode);
- Kontrollin fuqi-frekuencë;
- Kontrollin e tensionit.

Gjithashtu janë të përfshira sisteme të tjera kompjuterike, të tilla si:

- Mjetet e specializuara (softe) për analiza të Sigurisë Operative;
- Bordi imitator (mimic-board) për të siguruar shfaqjen e nyjeve të rrjetit sipas lidhjes së tyre, nivelin e tensionit dhe mbingarkesës, rrjedhën e fluksit në linja dhe transformatorë.

Këto mjete e lejojnë Operatorin e Sistemit të monitorojë situatën e Sistemit dhe gjëndjen e elementëve të sistemit të transmetimit, të shfaqë statusin e një nënstationi apo të një zone (topologjinë, flukset dhe tensionet), dhe për të kontrolluar në distancë pajisjet.

Rrjeti i Sigurisë së Telekomunikacionit

Rrjeti i telekomunikacionit është një rrjet i sigurtë i telekomunikacion-transmetimit që është i dedikuar për përdorim ekskluziv të funksionimit të rrjetit të energjisë. Infrastruktura e tij bazohet në fibrën optike të instaluar pothuajse në të gjitha linjat e sistemit të transmetimit. Rrjeti i telekomunikacionit i mundëson personelit operativ veprimin në nivele të ndryshme të kontrollit, përfshirë komunikimin me OST-të fqinje, për të shkëmbyer komandat dhe informacionet. Ai siguron bartjen e sinjaleve të destinuara për funksionimin e sistemeve të mbrojtjes në rrjetat dhe objektet elektrike ose për kryerjen e veprimeve në distancë nga pajisjet automatike të kontrollit lokal. Funksionimi normal i rrjetit të telekomunikacionit është jetike për funksionimin e Sistemit dhe sigurinë operationale dhe nënkupton redundancën e kanaleve të transmetimit në rrjetin e telekomunikacionit, dhe dublikimin e paisjeve lidhëse (ruterave).

Sistemi i Telekontrollit

Pajisjet e kontrollit dhe të sigurisë së rrjetit përbëjnë të ashtuquajturin sistem telekontrolli. Ky sistem shërben për:

- Garantimin e vrojtimit të Sistemit të Transmetimit, duke i siguruar Operatorit regjistrimin e të dhënave, në çdo kohë, për flukset e energjisë, topologjinë e rrjetit dhe vlerën e madhësive elektrike (frekuenca dhe tensioni) karakteristikë e operimit të Sistemit. Ky observim përfshin gjithashtu të dhënat nga OST-të fqinje, informacion që shërben për të menaxhuar kompleksitetin e shkëmbimeve në mënyrën më të mirë të mundëshme, duke siguruar njëkohësisht besueshmërinë e operimit të Sistemit interkonjektiv;
- Garantimin e kontrollit të Sistemit të Transmetimit duke i ofruar Operatorit dhe pajisjeve automatike të kontrollit mundësinë e operimit nëpërmjet telekontrollit të celsave, dhe nëpërmjet kontrollit automatik të centralizuar të frekuencës;
- Furnizimin me informacion të besueshëm për funksionet komplekse të analizës së sigurisë operative, të cilat i mundësojnë Operatorit:
 - o të parashikojë pasojat e ngjarjeve të tilla si stakim të objekteve gjeneruese apo të elementëve të sistemit të transmetimit,
 - o përgatitjen e veprimeve përmirësuese.

Sistemi i telekontrollit është me rëndësi jetike për besueshmërinë dhe sigurinë e Sistemit, dhe për këtë arsye merren të gjitha masat për të siguruar vazhdimësinë e të gjitha karakteristikave relevante të tij:

- Rrjeti i telekomunikacionit është i dedikuar për operimin e sigurtë të Sistemit, dhe për këtë arsye OST ka një qendër rezervë të kontrollit të lidhur në rrjetin e telekomunikacionit të sigurisë dhe e pajisur me pajisje të kontrollit;
- Të gjitha të dhënat që merren në distancë, thirren apo përftohen dhe përpunohen në mënyrë të dyfishtë me anë të kanaleve të ndryshme;
- Së fundi, furnizimi i pandërprerë me energji elektrike i pajisjeve të telekontrollit dhe pajisjeve të telekomunikacionit në QDS sigurohet nga burime mikse dhe të pavarura të jashtme dhe burime të brendshme.

Menaxhimi i Kontrollit të Frekuencës

Qëllimi i menaxhimit të kontrollit të frekuencës është mbajtja e një ekuilibri të vazhdueshëm ndërmjet prodhimit dhe konsumit, duke siguruar cilësi të frekuencës dhe stabilitet të Zonës Sinkrone. Për këtë qëllim, OST siguron (aktualisht nëpërmjet një kontrate bilaterale me KESH) rezerva adequate (në rritje dhe ulje) të fuqisë aktive. Në Kodin e Transmetimit janë vendosur kriteret për dimensionimin dhe krijimin e këtyre rezervave.

Kontrolli i Tensionit dhe Menaxhimi i Fuqisë Reaktive.

Kushtet e tensionit në Sistemin e Transmetimit janë të lidhura direkt me situatën e energjisë reaktive në nyjet e sistemit. Për të kompensuar për një konsum të tepërt të energjisë reaktive, OST sigurohet që prodhuesit më efikasë dhe efektivë (aktualisht centralet e KESH-it) të gjenerojnë/absorbojnë mjaftueshëm energji reaktive, përveç fuqisë reaktive nga burime të tjera të instaluar në Sistemin e Transmetimit. OST siguron gjithashtu një ekuilibër të vazhdueshëm dhe lokalisht të mjaftueshëm të fuqisë reaktive, që të jetë në gjëndje për të ruajtur nivelet e duhura të tensionit. Në këtë kontekst, qëllimi i kontrollit të tensionit dhe të menaxhimit të energjisë reaktive është për të siguruar që:

- Nivelet e tensionit, flukset e energjisë reaktive dhe burimet e energjisë reaktive monitorohen, kontrollohen dhe mbahen në kohë reale brenda kufijve të Sigurisë Operative, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve të Sistemit të Transmetimit dhe sigurimin e stabilitetit të tensionit,
- Rezerva adequate e menjëherëshme e fuqisë reaktive është në dispozicion në gjeneratorët në punë, në reaktorët dhe kapacitorët, në mënyrë që të sigurojë funksionimin teknik të të gjithë sistemit energjitik, dhe të jetë në gjëndje për të rivendosur gjëndje normale pas avarive.

Për këtë qëllim, në Kodin e Rrjetit për sigurinë operative të ENTSO-E është vendosur të bëhet monitorim permanent online dhe shkëmbimi i informacionit që realizohet nga OST-të në zonat përkatëse të observimit.

Menaxhimi i Rrymës së Lidhjes së Shkurtër

Menaxhimi i rrymës së qarkut të shkurtër është i nevojshëm për të parandaluar nga dëmtimi të gjitha llojet e objekteve të gjenerimit, elementët e Sistemit të Transmetimit dhe pajisjeve të lidhura me të, dhe për të ruajtur sigurinë e personave; nëpërmjet ç'kyçjes së shpejtë dhe selektive të pjesës në qark të shkurtër. Pra, objektivi i menaxhimit të rrymës së qarkut të shkurtër është mbajta e ndikimit të rrymave të lidhjes së shkurtër në një nivel që siguron funksionimin e sigurtë të sistemit të transmetimit, me anë të sistemit përkatës të mbrojtjes. Kjo nënkupton:

- Llogaritjen e saktë të rrymave të lidhjes së shkurtër nga ana e specialistëve të planifikimit të OST-së duke ndjekur parimet e standartizuara dhe sigurimin e të dhënave nga OST-të fqinje, OSHEE dhe Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit;
- Monitorimin e rrymave të lidhjes së shkurtër dhe marrjen e masave përmirësuese, parandaluese dhe kuruese në qoftë se kufijtë e sigurisë operative janë, ose kanë tendencë për t'u shkelur;

- Sigurimin e informacionit dhe të komunikimit me OST-të fqinje, OSHEE dhe Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit, të afektuar, në mënyrë që të jenë në gjëndje të marrin në konsideratë efektin e sistemeve të tjera të transmetimit dhe shpërndarjes.

Menaxhimi i Fluksit të Energjisë

Çdo element i Sistemit të Transmetimit ka kufijtë e sigurisë operative në drejtim të rrjedhës së energjisë. Këto kufizime janë të rëndësishme për mbrojtjen e pajisjeve dhe njerëzit në afërsi të një elementi të caktuar të Sistemit të Transmetimit, duke marrë parasysh kufizimet teknike të materialeve të përdorura, me qëllim shmangien e dëmtimit apo vjetërimit të parakohëshëm të pajisjes. Pra, menaxhimi i fluksit të energjisë ka të bëjë me krijimin apo përcaktimin e mjeteve operacionale për të mbajtur rrjedhën e energjisë brenda kufijve të sigurisë operative në çdo element të sistemit të transmetimit. Për të qenë në gjëndje për të monitoruar dhe kontrolluar parametrat operacionale është e nevojshme që të ketë informacion të saktë mbi gjëndjen e Sistemit dhe gjithashtu të vlerësimit të gjëndjes së Sistemit. Për këtë, OST kontrollon parametrat operacionale brenda zonës së vet të përgjegjësisë dhe, në mënyrë të koordinuar, merr në konsideratë parametrat operativë nga zona e observimit që përfshin pjesë të OST-ve fqinje. Kjo nënkupton të dhëna strukturore dhe në kohë reale të shkëmbimit të informacionit ndërmjet OST-ve në zonat e ndërthurura të observimit, dhe ndërmjet OST dhe OSHEE në zonën e përgjegjësisë të OST-së. Për të qenë në gjëndje për të përballuar avaritë në Sistem, nga ana e OST-së përgatiten veprimet përmirësuese individuale dhe të koordinuara, dhe zbatohen kur është e nevojshme, për të parandaluar shkeljen e limiteve të Sigurisë Operative dhe për të suportuar kthimin në normalitet në rastet e situatave alerte ose në emergjencë.

Analiza e Kontigjencave dhe Trajtimi

Me qëllim mbajtjen e sigurisë së operimit të Sistemit, bëhet analiza e kontigjencës (e ndodhjes së ngjarjeve të pa-parashikuara) që do të thotë kryerja e simulimit të stakimit të elementëve të Sistemit. Kjo analizë kryhet për zonën e observimit të OST-së, duke respektuar kufijtë e sigurisë operative dhe ndërkohë bëhet përgatitja për kryerjen e veprimeve përmirësuese para dhe pas incidentit, kur kërkohet nga rezultati i analizës.

Parimet kryesore që ndiqen në lidhje me analizën e kontigjencave, të cilat gjithashtu përshkruajnë qëllimet e përgjithshme dhe objektivat e analizës së kontigjencës në kohë reale dhe në fazën e planifikimit operativ janë:

- Sigurimi i parandalimit dhe/ose kurimit për sa i përket veprimeve përmirësuese, të kërkuara për të ruajtur sigurinë e operimit, për të gjitha kontingjencat e besueshme që ndikojnë në Sistemin e Transmetimit.
- Koordinimi i analizave dhe veprimeve përmirësuese, kurdo që është e nevojshme, për të siguruar rezultatin e dëshiruar - ruajtjen e sigurisë operative në Sistem dhe në Interkonjeksion.
- Mbeshtetja në të dhënat e duhura dhe informacionin në kohë reale dhe atë të bazuar në parashikimin e ngarkesave. Përdorimi i modelit të përbashkët të rrjetit rajonal, dhe shkëmbimi i të gjitha të dhënave të nevojshme dhe informacionit ndërmjet OST-së, OSSH-së dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.
- Suportimi i përpunimit të dispozitave të standarteve PAN-Europiane për analizat e kontingjencave për të ruajtur sigurinë e operimit duke maksimizuar përdorimin e Sistemit.

Mbrojtja

Pajisja e mbrojtjes është përdorur për të mbrojtur asetet e Sistemit të Transmetimit nga dëmtimet. Skemat e sistemit të mbrojtjes janë përdorur për të zbuluar kushtet anormale të sistemit dhe ndërmarrin veprime korigjuese të paracaktuara, për të ruajtur integritetin e sistemit, me një performancë të pranueshme të sistemit, në mënyrë të koordinuar. Funkcionet për mbrojtjen e Sistemit analizohen duke u mbështetur në llogaritjet e rrjetit, duke konsideruar funksionimin korrekt dhe jo korrekt. Nëse parashikohen pasoja të papranueshme, funksionaliteti dhe redundanca e Skemës së Mbrojtjes së Sistemit përshtaten në përpunime me rrethanat për të përmbushur kërkesat e sigurisë operationale. Funksionaliteti dhe statusi i gjëndjes së sistemit monitorohen, komunikohen dhe koordinohen ndërmjet OST-ve fqinje dhe palëve të tjera të prekura nga sistemi i mbrojtjes.

Menaxhimi i Stabilitetit Dinamik

Qëllimi i Vlerësimit të Stabilitetit Dinamik (VSD) është për të siguruar ndërjegjesimin e operatorit të OST-së në lidhje me gjëndjen aktuale dhe parashikimin në të ardhmen të situatës së Sistemit në lidhje me stabilitetin, në situatën (N) dhe në atë të mundëshme (N-1). Përveç kësaj, VSD mbështet vendimet ndaj veprimeve më efektive dhe efikase përmirësuese, për parandalimin e incidenteve ose korigjimin e pasojave të tyre, nëse ato ndodhin.

Përdorimi i gjerë i VSD lejon aplikime të ndryshme, jo vetëm në kohë reale, por edhe në fazat e planifikimit operacional. Një theks është vënë në trajnimin e stafit operativ të

OST duke bërë përdorimin e VSD, si dhe për mirëmbajtjen e vazhdueshme të modeleve dhe të simulatorit përkatës.

Trajnimi Operativ dhe Çertifikimi

Në përputhje me Udhëzimet e Praktikës së Mirë për Sigurinë Operacionale, trajnimi është i nevojshëm në mënyrë që të garantojë se Operatorët e Sistemit dhe personeli tjetër operativ janë të aftë, të mirëtrajnuar, dhe se punonjësit që operojnë Sistemin në kohë reale janë të çertifikuar për të vepruar në mënyrë të sigurtë gjatë të gjitha situatave operacionale.

Në këtë kontekst, OST ka filluar zbatimin e një trajnimi dhe procesi të gjerë çertifikimi, i cili do të mundësojë njohjen dhe reagimin ndaj kushteve operative jonormale në afatet kohore përkatëse dhe, kur është e përshtatshme, në mënyrë të koordinuar me OST-të e tjera. Për më tepër, zbatimi i standarteve operative mund të sigurohet nga zhvillimi i programeve që përfshijnë trajnimin fillestar, zhvillimin e vazhdueshëm të personelit dhe ri-vlerësimin e rregullt të çertifikimit.

Kodi i Operimit vendos detyrimin për OST-në që të ketë të aktivizuar programet e vazhdueshme zhvillimore për stafin e saj në dhomën e kontrollit dhe të bashkërendojë e bashkëpunojë në trajnimet ndër-sistimore për çështje të transmetimit rajonal. Stafit i trajnuar OST-së do të jetë në gjendje të veprojë në mënyrë efektive në balancimin e Sistemit dhe në maksimizimin e mundësisë për transfertat ndërkufitare të cilat të dyja ofrojnë përfitime reale ekonomike për konsumatorët, mjaft më sinjifikative se sa rritja e kostos së investuar më shumë në trajnimin e stafit të OST-së në dhomën e kontrollit. Për më tepër, duke investuar në trajnimin e stafit operativ të OST-së, do të zvogëlohet probabiliteti i avarive të mëdha me përhapje të gjerë të shoqëruara me ndërprerjen e furnizimit, të cilat nëse ndodhin mund të zgjasin për shumë orë apo edhe ditë, dhe për të cilat ka një kosto shumë të madhe ekonomiko sociale.

b) Balanca e parashikuar e kërkesës dhe e furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare, dhe

c) Niveli i pritshëm i kërkesës dhe perspektiva e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetë vjeçare nga data e raportit.

Mbi bazën e deklarimeve të pjesëmarrësve të tregut, bazën e të dhënave historike të OST-së, dhe duke konsideruar rritjen potenciale të gjenerimit të PPE + PVE dhe reduktimin e humbjeve jo teknike në rrjetin e shpërndarjes, është pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST, të jetë e rendit 1.5-2%, dhe mbi këtë bazë, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i parametrave kryesorë

energjetikë dhe sigurimi i balancës së Sistemit për pesë vjeçarën, siç jepet në tabelat e mëposhtme:

Viti 2017		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	616	478	511	412	415	417	486	498	425	442	456	579	5,735
Konsumi per KK	GWh	40	36	41	53	70	44	43	48	98	105	85	77	740
Humbje + N.V.	GWh	15	14	14	13	13	12	13	14	12	12	14	15	161
Kerkesa totale	GWh	671	528	566	478	498	473	542	560	535	559	555	671	6,636
Viti 2017		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Prodhimi	GWh	507	394	433	370	386	365	378	396	377	396	397	508	4,905
KESH	GWh	379	280	293	236	248	261	293	310	308	309	293	374	3,582
PVE+PPE	GWh	128	114	140	134	139	104	85	86	69	87	104	133	1,323
Viti 2017		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Importi	GWh	164	134	133	108	112	108	164	164	158	164	158	164	1,730
OSHEE	GWh	129	104	98	63	47	68	126	119	63	64	88	102	1,070
FK → KK	GWh	35	30	35	45	65	40	38	45	95	100	70	62	660

Viti 2018		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	555	470	445	350	355	360	400	420	380	445	460	555	5,195
Konsumi per KK	GWh	110	100	120	125	130	130	140	140	150	150	145	140	1,580
Humbje + N.V.	GWh	16	14	14	13	13	12	13	14	12	12	14	15	162
Kerkesa totale	GWh	681	584	579	488	498	502	553	574	542	607	619	710	6,937
Prodhimi	GWh	510	395	440	375	390	370	365	375	365	400	405	515	4,905
KESH	GWh	380	280	295	235	250	260	280	290	280	310	295	375	3,530
PVE+PPE	GWh	130	115	145	140	140	110	85	85	85	90	110	140	1,375
Importi	GWh	171	189	139	113	108	132	188	199	177	207	214	195	2,032
OSHEE	GWh	60	55	35	30	30	60	65	65	55	60	65	70	650
FK → KK	GWh	111	134	104	83	78	72	123	134	122	147	149	125	1,382

Viti 2019		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	500	423	401	315	320	324	360	378	342	401	414	500	4,677
Konsumi per KK	GWh	164	147	175	185	190	180	190	192	200	210	203	197	2,233
Humbje + N.V.	GWh	16	14	15	14	13	12	14	15	12	12	14	15	166
Kerkesa totale	GWh	680	584	591	514	523	516	564	585	554	623	631	712	7,076
Prodhimi	GWh	520	405	450	400	405	380	365	375	370	405	410	515	5,000
KESH	GWh	380	280	295	250	255	260	280	290	280	310	295	375	3,550
PVE+PPE	GWh	140	125	155	150	150	120	85	85	90	95	115	140	1,450
Importi	GWh	160	179	140	114	117	136	199	210	184	218	221	196	2,075
OSHEE	GWh	57	50	30	30	30	60	60	60	50	60	65	67	620
FK → KK	GWh	103	129	110	84	87	76	139	150	134	158	156	129	1,455

Viti 2020		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	490	415	390	305	310	315	350	370	330	390	400	490	4,555
Konsumi per KK	GWh	185	168	196	206	211	201	211	213	221	231	224	218	2,485
Humbje + N.V.	GWh	17	14	15	14	13	12	15	16	12	12	14	16	170
Kerkesa totale	GWh	692	597	601	525	534	528	576	599	563	633	638	724	7,210
Prodhimi	GWh	530	415	460	410	415	390	370	380	370	405	420	530	5,095
KESH	GWh	380	280	295	250	255	260	280	290	280	310	295	375	3,550
PVE+PPE	GWh	150	135	165	160	160	130	90	90	90	95	125	155	1,545
Importi	GWh	162	182	141	115	119	138	206	219	193	228	218	194	2,115
OSHEE	GWh	55	45	30	30	35	45	55	55	40	45	50	55	540
FK → KK	GWh	107	137	111	85	84	93	151	164	153	183	168	139	1,575

Viti 2021		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	442	369	344	259	264	269	304	324	284	343	354	444	4.000
Konsumi per KK	GWh	243	226	255	264	269	259	269	271	279	289	282	276	3.182
Humbje + N.V.	GWh	17	15	15	14	13	13	15	16	13	12	14	16	173
Kerkesa totale	GWh	702	610	614	537	546	541	588	611	576	644	650	736	7.355
Prodhimi	GWh	540	425	470	420	425	395	375	385	375	410	430	540	5.190
KESH	GWh	380	280	295	250	255	260	280	290	280	310	295	375	3.550
PVE+PPE	GWh	160	145	175	170	170	135	95	95	95	100	135	165	1.640
Importi	GWh	162	185	144	117	121	146	213	226	201	234	220	196	2.165
OSHEE	GWh	55	40	30	30	30	40	50	50	35	40	45	55	500
FK → KK	GWh	107	145	114	87	91	106	163	176	166	194	175	141	1.665

ç) Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi.

Për këtë çështje kemi informacion vetëm për ato centrale të cilat janë parashikuar të lidhen në rrjetin e transmetimit (janë në fazë ndërtimi apo kanë marrë miratimin paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit), si më poshtë:

1. Kaskada e Lumit Devoll, (Moglica 171 MW)
2. HEC Kalivaç, 100 MW
3. HEC Fang, 72 MW
4. HEC Gostime, 21.5 MW
5. HEC HEC Qarishte, 37 MW
6. HEC Lumzi, 11 MW
7. HEC Kalivare, 5 MW
8. HEC Stavec, 20.77 MW
9. HEC Topojan, 10.2 MW
10. HEC Darsi, 11 MW

d) Parashikimi i investimeve, për jo më pak se pesë vitet e ardhshme, që planifikohen të realizohen nga OST sh.a. apo çdo palë tjetër, lidhur me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkonjeksionit.

OST sh.a. kryen studime të vazhdueshme si për zona të veçanta të rrjetit të transmetimit ashtu edhe të lidhjes së sistemit elektroenergjitik Shqiptar me sistemet e vendeve fqinje. Studimet më të rëndësishme dhe që kanë rëndësi të veçantë kryhen në bashkëpunim me institucionet studimore ndërkombëtare në kuadrin e WBIF.

Gjatë fazave të planifikimit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit me qëllim: (i) Rehabilitimin dhe Fuqizimin e rrjetit të transmetimit; (ii) Krijimin e nyjeve të reja lidhëse; (iii) përmirësimin e procesit të menaxhimit, kontrollit, matjes etj, OST sh.a. merr në konsideratë zhvillimin kombëtar dhe rajonal në përputhshmëri të plotë me direktivat e ENTSO-E (Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike).

Të gjitha projektet në proces implementimi dhe ato të planifikuara janë të lidhura me shërbimin e sistemit të transmetimit, i cili mund të kryhet plotësisht vetëm nëpërmjet realizimit të investimeve të nevojshme për fuqizimin dhe modernizimin e tij.

Informacion për investimet e parashikuara për linjat e interkonjeksionit dhe për ndërtimin e linjave të brendshme të rrjetit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në linjat e interkonjeksioneve ndërkufitare.

Nga pikëpamja strategjike, projektet që përforcojnë lidhjet interkonjektive me rajonin, duke krijuar kushte më të mira për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajonin e Evropës Juglindore, janë:

➤ **Linja e Interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (AL) – Manastir (MK).**

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan2 - Manastir, afërsisht 151 km, 56 km në territorin Shqiptar.
- Zgjerimin e nënstacionit 400 kV Elbasan2 me zbarre dyfishe 400 kV, një dalje të re linje 400 kV dhe një shunt-reaktor 120 MVar.

Projekti do të ketë impakt të rëndësishëm në:

- Krijimin e mundësive tregtare për shkëmbime ekonomike të energjisë elektrike nëpërmjet vendeve të rajonit.
- Ndarjen e rezervës kapacitive që do të kontribuojë në një siguri më të madhe të funksionimit të sistemeve elektroenergjetike të Shqipërisë dhe Maqedonisë.
- Suportin reciprok në raste emergjente.
- Shfrytëzimin optimal të burimeve të rajonit që rezultojnë me kosto më të ulët të energjisë elektrike.
- Dispatchimin optimal të njësive gjeneruese.
- Besueshmëri më e lartë e sistemit elektroenergjetik.
- Reduktimin e kostos së gjenerimit.
- Reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit.

➤ **Linja 400 kV Elbasan2 – Fier**

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re 400 kV, Elbasan2 – Fier, rreth 70 km, dhe dy daljet 400 kV respektivisht në nënstacionet Elbasan2 dhe Fier;

- Zgjerimin e nënstacionit Fier me një transformim 400/220 kV dhe lidhjen e tij me rrjetin e transmetimit.

Ky projekt, si pjesë e projektit të mësipërm, do të ketë impakt në:

- Rritjen e standardeve, cilësisë dhe efikasitetit të Sistemit të Transmetimit në zonën qendrore dhe jugore të vendit.
- Reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, sidomos në rrjetin 220 kV.
- Zvogëlimin e energjisë së mosfurnizuar (ENS).
- Zvogëlimin e mbingarkimit të rrjetit 220 kV.
- Rritjen ekonomike në zonën qendrore dhe jugore si rezultat i një cilësie më të lartë furnizimi dhe reduktimit të ndërprerjeve të energjisë.

dh) Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit

Përsa i përket cilësisë së mirëmbajtjes së Rrjetit të Transmetimit, OST në zbatim të Rregullores së shfrytëzimit teknik organizon monitorimin dhe kontrollin periodik të të gjithë elementëve të Sistemit të Transmetimit, duke hartuar planin e kontrollit dhe të mirëmbajtjes, në të cilin detajohen veprimet që do të realizohen për kryerjen e remonteve për pajisjet e nënstacioneve dhe kontrollet periodike për linjat e transmetimit. Kontrollet periodike dhe skanimit me kamera termike i linjave të transmetimit dhe nënstacioneve kanë ndihmuar në identifikimin në kohë të problemeve të cilat pas punimeve riparuese dhe ndërhyrjeve jashtë radhe janë eliminuar në kohë të shkurtër duke bërë edhe parandalimin e dëmtimeve të pajisjeve. Kontrollet me qëllim parandalues të difekteve kanë ndikuar në rritjen e cilësisë të furnizimit me energji elektrike.

Sa i përket pajisjeve transformuese që përbëjnë asetin kryesor në marrjen e kapaciteteve të prodhimit dhe transmetimit, defektet në to mund të sjellin probleme, të cilat lidhen me shpërndarjen e ngarkesës dhe mungesën e kapaciteteve rezervë. Në rastin e dëmtimeve të riparueshme, për zëvendësimin e transformatoreve kërkohet kohë e gjatë, e cila shoqërohet me humbje të mëdha financiare. Për këtë, për transformatorët 400 kV të sistemit të transmetimit, OST po merr masa për zbulimin e defekteve që në fillësë nëpërmjet vlerësimit të gjëndjes së transformatorit në kohë reale, duke mundësuar eliminimin e anomalive që në gjëndjen fillestare të shfaqjes së tyre.

Për një pasqyrë të cilësisë së punës së Sistemit të Transmetimit, më poshtë jepen tabelat për stakimet për avari për vitin 2016:

PASQYRA E STAKIMEVE TE LINJAVE PER Vitin 2016

Emertimi	stakime gjithsej	tranzi tore	qendru eshme	kushte atmosfer.	difekt linje	paisje primare	mbrojtja	SHAM SHAF	OSHEE	te ndrysh me	kohe zgjatja
Linja 400kV	14	8	6	9	2	0	0	0	0	3	7h 25'
Linja 220kV	87	40	47	41	28	13	1	0	0	4	132h 30'
Linja 110kV	381	233	148	206	50	38	53	4	12	18	508h 55'
Linja gjithsej	482	281	201	256	80	51	54	4	12	25	

N/stacione	stakime gjithsej	tranzi tore	qendru eshme	kushte atmosfer.	probleme vaji,gazi	paisje primare	mbrojtja	SHAM SHAF	personel	te ndrysh me	kohe zgjatja
AUTO, TR	32	9	23	5	5	12	6	0	0	4	109h 40'
Celsa TRR TT	4	0	4	0	0	4	0	0	0	0	17h 30'

e) Masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike, masat e përshtatshme, në rast nevojë, të rritjes së sigurisë së furnizimit.

Masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve të furnizimit, si dhe masa të tjera në rast nevojë për të ruajtur sigurinë e punës së Sistemit përbildhen në të ashtuquajturat veprime përmirësuese që paraqesin masat e zbatuara nga OST, në mënyrë që të ruhet siguria operationale. Në veçanti, veprimet përmirësuese shërbejnë për të përbushur kriterin (N-1) dhe për të ruajtur limitet e sigurisë operationale. Ato kategorizohen si veprime përmirësuese para-avari (dmth parandaluese) ose pas-avari (d.m.th korrigjuese ose kurative) brenda zonës së kontrollit të OST-së ose ndërmjet OST-ve të ndërlidhura.

Veprimet përmirësuese parandaluese zbatohen normalisht në stadin e planifikimit operational ose të skedulimit, për të ruajtur gjëndjen normale të Sistemit në situatën e ardhshme operative, dhe për të parandaluar përhapjen e avarive jashtë zonës së përgjegjësisë së OST-se. Veprimet përmirësuese parandaluese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispeçimit (të agregatëve) ose të lejimit të tregtimit në kah të kundërt, kur është e mundur;
- Ndryshime në topologjinë e rrjetit;
- Komutimin manual të pajisjeve të energjisë reaktive (ancafkat e transformatorëve, reaktorët, blloqet e kondensatorëve statike, ose ndryshimin e nivelit të set-point të kontrollorëve të tyre;
- Kërkesën për suport shtesë të energjisë reaktive nga centralet;
- Mundësimin e skemave disponibël të sistemit të mbrojtjes (SH.AM).

Veprimet përmirësuese korigjuese janë veprime, të cilat zbatohen menjëherë ose relativisht shpejt pas ndodhjes së një emergjence, e cila çon në një gjendje të ndryshme nga situata normale. Me veprimet korigjuese Sistemi do të kthehet përsëri në gjendje normale. Veprimet përmirësuese korigjuese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispeçimit ose të tregtimit në kah të kundërt, duke përfshirë aktivizimin e rezervave të OST-së;
- Kontrollin e pajisjeve të energjisë reaktive (ancafkat e transformatorëve, reaktoret, blloqet e kondensatorëve, etj);
- Menxhimin e tensionit me anë të gjenerimit/absorbimit të energjisë reaktive nga centralet;
- Veprime të skemave të sistemit të mbrojtjes, p.sh. ndryshimin e topologjisë së rrjetit, kufizimin e prodhimit apo ngarkesës, në varësi të specifikimeve të mbrojtjes.

Plani i Mbrojtjes së Sistemit në rast të Situatës në Emergjencë

Siguria operationale nënkupton aftësinë për të siguruar funksionimin normal të Sistemit, për të kufizuar kohëzgjatjen dhe numrin e ç'rregullimeve, për të parandaluar shqetësime të mëdha, dhe për të kufizuar pasojat e një shqetësimi të madh në rast se kjo ndodh dhe gjithashtu me qëllim për të lehtësuar Rivendosjen e Sistemit pas një shqetësimi të madh (blac-kout), për kthimin e Sistemit në funksionimin normal.

Plani i mbrojtjes së Sistemit është i lidhur me një gjendje emergjente, me procesin relevant të informacionit dhe veprimeve përmirësuese dhe përbëhet nga një sërë masash të koordinuara, të cilat synojnë të mbajnë integritetin e Sistemit, në rast të kushteve që rezultojnë nga trazirat ekstreme.

Masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit

Masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit paraqiten si veprime emergjente përmirësuese. Në vijim, jepen shembuj të masave të aplikueshme të Planit të Mbrojtjes së Sistemit në rastet e kufizimeve për ngarkesën, frekuencën, flukset e energjisë dhe të tensionit.

Kufizime të ngarkesës/frekuencës

- Lëshimi ose ndalimi i njësive të prodhimit të energjisë;
- Rritja ose zvogëlimi (automatizisht ose me kërkesë) i nivelit të prodhimit të njësive gjeneruese;
- Përshtatja e mënyrës së kontrollit të LFC aktive;

- Përdorimi manual apo automatik i reduktimeve, shkarkimit të ngarkesës;
- Ndryshimet e pikave të punës të rregullatorëve të tensionit të transformatorëve në nivelin e shpërndarjes.

Kufizime të fluksit të energjisë

- Anullimi i remonteve të elementëve të rrjetit dhe vënia në punë sa më urgjent të jetë e mundur;
- Stakimi automatik i njësisë (gjeneruese) që aktivizohet nga stakimi i një linje relevante të transmetimit;
- Tregtimi në kah të kundërt me zonat fqinje të përgjegjësive;
- Ndërhyrja në skedulim;
- Ngrirja e shkëmbimeve të planifikuara;
- Reduktimi i programit të shkëmbimit;
- Reduktimi i kapaciteteve të interkonjeksionit;
- Shkarkimi manual i ngarkesës i objekteve me marrëveshje për ndërprerje;
- Shkarkimi automatik i objekteve me marrëveshje për ndërprerje, shkaktuar nga stakimi i një linje transmetimi;
- Shkarkimi i mëtejshëm i ngarkesës në varësi të situatës.

Kufizimet e tensionit

- Kërkesa për vlera maksimale apo minimale të gjenerimit të fuqisë aktive dhe reaktive;
- Zvogëlimi i fuqisë aktive në favor të prodhimit shtesë të fuqisë reaktive;
- Parandalimi i njësisë me ofrimin, injektimin e energjisë reaktive shtesë;
- Stopimi i optimizimit të tensionit dhe energjisë reaktive;
- Ndalimi i mirëmbajtjes dhe kycja e elementëve që më parë ishin në remont;
- Bllokimi i pozicionit të ancafkave në transformatorët me rregullim nën ngarkesë.

- Ndërprerjet e planifikuara për mirëmbajtjen e Rrjetit të Transmetimit

Planifikimi i mirëmbajtjes së Rrjetit të Transmetimit konsiston në përgatitjen e planit të remonteve të linjave dhe pajisjeve të nënstacioneve. Plani i remonteve të linjave përgatitet:

- Për linjat e interkonjeksionit dhe një pjesë të linjave të brendshme 400 kV dhe 220 kV që ndikojnë në shkëmbimet e energjisë elektrike në rajon, në koordinim me OST-të e vendeve fqinje.

Plani i remonteve për rrjetin e transmetimit 110 kV përgatitet duke:

- patur parasysh kërkesat e Nësive Operative;
- koordinuar me OSHEE që është përdoruesi më i madh i rrjetit të transmetimit;
- koordinuar me prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike remonti i të cilëve planifikohet të bëhet në muajt me prodhim minimal të energjisë.

Plani i remonteve të nënstacioneve përgatitet duke patur parasysh, propozimet e Njësive Operative dhe koordinohet me planin e remonteve të linjave edhe të OSHEE. Plani i remonteve mund të konsultohet me përdoruesit e rrjetit të transmetimit në faqen zyrtare të OST sh.a., në linkun: <http://www.ost.al/sq/kalendari-remonteve/>

- **Kërkesat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Përdoruesve të Sistemit për zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit**

Vitet e fundit, në Shqipëri është zhvilluar ndërtimi i centraleve hidrike. Territori i vendit tonë paraqet një hidrologji të mirë dhe të qëndrueshme përgjatë gjithë vitit dhe në shumicën e kohës me prurje të konsiderueshme të të gjithë lumenjve që shfrytëzohen për prodhimin e energjisë elektrike.

Shumë shoqëri të cilat kanë marrë të drejtën e ndërtimit të centraleve konsumatorë apo gjeneruese kanë realizuar projekte mjaft interesante, ku më së shumti lidhen me prodhimin e energjisë elektrike nga burimet hidrike. Në dekadën e fundit janë vënë në operim mjaft hidrocentrale të cilat kanë një shtrirje gjatë gjithë territorit të Shqipërisë, ku dhe shumë të tjerë janë në proces ndërtimi.

Kërkesat për lidhjen e burimeve të reja në sistemin e transmetimit janë shtuar dhe, sipas parashikimeve pritet që vitet e ardhshme të ndërtohen burime të rëndësishme të energjisë elektrike, kryesisht HEC-e, por edhe Impiante Fotovoltaike dhe Eolike. Kërkesat për ndërtimin e këtyre të fundit kanë arritur në një fuqi të instaluar të madhe.

Bazuar në informacionet si dhe në të dhënat e marra nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore, është ndërtuar plani i zgjerimit të burimeve gjeneruese kryesore deri në vitin 2020 dhe më tej deri në vitin 2030. Përveç kaskadës së Devollit, kaskadës

së Fanit dhe disa centraleve më të vegjël të cilët janë në fazë ndërtimore, koha e komisionimit të centraleve të tjerë të mëdhenj është e pa përcaktuar.

- **Funksionimi i Sistemit të Transmetimit**

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit e krijuar në 14.07.2004. Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionin me sistemet e tjera ndërkufitare për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Bazuar në këtë rol të rëndësishëm, kompania e mbështet zhvillimin e vet në planet afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vend. Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me dispozitat dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Në lidhje me funksionimin e sistemit të transmetimit për vitin 2016 rezulton se sistemi në tërësi nuk është ballafaquar me avari të rënda apo ngjarje të paparashikuara të shoqëruara me ndërprerjen apo kufizimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në vend. Operimi i Sistemit të Transmetimit është realizuar duke synuar një balancë të qëndrueshme ndërmjet prodhimit dhe konsumit të energjisë, si parakusht për një sistem të qëndrueshëm që garanton sigurinë e furnizimit me frekuencën e vendosur prej 50 Hz. Operimi në kohë reale i Sistemit ka konsistuar në harmonizimin (ruajtjen e balancës) ndërmjet gjenerimit dhe konsumit, në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim sigurimin e stabilitetit të SE dhe ruajtjen e parametrave cilësorë të furnizimit apo kushteve të operimit për të gjithë përdoruesit. Ndërkohë nëpërmjet Qendrës Kombëtare Dispeçer është realizuar drejtimi operativ i punës së bashkërenduar i centraleve gjeneruese, rrjetit të transmetimit dhe nënstacioneve deri në ndërfaqen me sistemin e shpërndarjes me qëllim mbajtjen e balancës në SEE, krijimin e kushteve për kryerjen e remonteve nga Njësitë Operative të Transmetimit, eliminimin e avarive dhe defekteve në SEE në kohën më të shkurtër të mundëshme dhe koordinimin sipas nevojës me OST-të fqinje.

- **Përdorimi i të ardhurave të siguruara nga ankandet e kapaciteteve ndërkufitare.**

Në lidhje me përdorimin e të ardhurave të siguruara nga kufizimet e kapaciteteve ndërkufitare gjatë vitit 2016, të ardhurat nga alokimi u përdorën kryesisht për shlyerjen e detyrimeve për principalin dhe interesin e kredive që lidhen me investimet për rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit të transmetimit.

- **Kontratat për sigurimin e shërbimeve ndihmëse, të lidhura me ofruesit e këtij shërbimi dhe vii) Kontratat e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit**

Për vitin 2016, OST sh.a. ka bërë të mundur sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit si dhe blerjen e humbjeve në rrjetin e transmetimit me anë të kontratave bilaterale të lidhura me KESH sh.a. në përputhje me vendimet Nr. 102, datë 23.06.2016 dhe Nr. 137, datë 15.08.2016 të Entit Rregullator të Energjisë.

Neni 62 i Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” parashikon se: *“Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.”*

Aktualisht shërbimet ndihmëse dhe shërbimi i balancimit të sistemit mund të sigurohen vetëm nga njësitë gjeneruese në kaskadën e lumit Drin, përkatësisht nga HEC Fierze, Koman dhe Vau i Dejës. Të gjithë centralet e tjerë gjenerues të energjisë elektrike, për shkak se në tërësinë e tyre janë pa basene ujëmbledhëse dhe kanë fuqi të instaluar të vogël, nuk mund të realizojnë rregullimet e nevojshme për ruajtjen e balancës në sistemin elektroenergjitik. Vetëm këto tre hidrocentrale janë të pajisur me rregullatorët sekondarë, me RTU që bëjnë të mundur lidhjen me sistemin SCADA/EMS. Lidhja me sistemin SCADA/EMS është e domosdoshme për të realizuar marrjen e sinjaleve komanduese/aktivizuese për rregullimin sekondar fuqi - frekuencë. Ndërkohë që asnjë nga subjektet e tjera të cilat kanë ndërtuar njësi gjeneruese të energjisë elektrike nuk kanë të instaluar pajisjet e nevojshme të komandimit për të realizuar këtë proces. Në këto kushte KESH sh.a. mbetet i vetmi gjenerues i cili është i aftë teknikisht për të siguruar shërbimet ndihmëse. Gjithashtu, pavarësisht nga vënia në punë e centraleve të reja, siç është HEC Peshqesh apo se fundmi dhe HEC Banja, përsëri situata e centraleve me aftësi teknike për ofrimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit mbetet e njëjtë. Në këto kushte është e qartë se mungojnë alternativat për

krijimin e një tregu konkurrues me shumë ofrues të aftë teknikisht për të siguruar shërbimet ndihmëse dhe të balancimit.

OST vlerëson se *aktualisht nuk plotëson kushtet* për krijimin e një tregu konkurrues për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për shkak të kufizimeve teknike që kanë pjesën më të madhe të njëjësive gjeneruese, përjashtuar ato të KESH sh.a.

Sidoqoftë OST sh.a. në hartimin e planit të zhvillimit ekonomik për vitin 2017 ka bërë një vlerësim të fondit financiar të nevojshëm për sigurimin me bazë tregu të shërbimeve ndihmëse, humbjeve dhe shërbimeve të ridispecimit. Miratimi i fondit financiar bën teknikisht të mundur që OST sh.a., në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të prokurojë energjinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Përveç kësaj nëse miratohen fondet e nevojshme financiare, OST sh.a. mund të sigurojë me bazë tregu shërbimet ndihmëse të ridispecimit dhe shërbimet ndihmëse të rregullimit terciar i cili në përputhje me Manualin Operacional dhe Kodet e ENTSO-E mund të prokurohet edhe jashtë zonës së kontrollit.

Në pasqyrat më poshtë detajohen sipas zërave përkatës, specifikimet dhe vlerat në ALL dhe EURO të vlerësuara në Projekt-Programin e Zhvillimit Ekonomik nga OST sh.a. për vitin 2017, për sigurimin e këtyre shërbimeve me bazë tregu.

	Ne mln leke
Sherbime qe prokurohen	487.8
Internet, sherbim e bankare, ERE etj	20
Blerjet e vogla	80
Program furnitura totale	588

	Ne mln leke	Euro
ENTSO-E	35.0	250,000
MED TSO-E	1.4	10,000
SCC Serbi	30.1	215,000
CAO	12.6	90,000
Organizmat rajonale e europiane	79	565,000

	Ne mln leke	Euro
Blerja e humbjeve	1,101.21	8,038,000
Sherbime ndihmëse- Rregullimi sekondar	134.41	981,120
Sherbime ndihmëse- Rregullimi terciar	360.04	2,628,000
Sherbime ndihmëse- Ridispecimi	493.20	3,600,000
Humbje dhe sherbime ndihmëse	2,089	15,247,120

Humbjet			
Energjia	Cmimi (€/MWh/h)	Vlera ne €	Vlera ne mln Leka
160,760	50	8,038,000	1,101,206,000

Sherbime ndihmëse- Rregullimi sekondar

Kapaciteti	Kapaciteti (MW)	Cmimi (€/MWh/h)	Nr. Ditëve	Nr. Orëve	Vlera ne €	Vlera ne mln Leka
R-	35	0.8	365	24	245,280	33.60
R+	35	2.4	365	24	735,840	100.81
Totali					981,120	134.41

Sherbime ndihmëse- Rregullimi terciar

Kapaciteti (MW)	Cmimi (€/MWh/h)	Nr. Ditëve	Nr. Orëve	Vlera ne €	Vlera ne mln Leka
100	3	365	24	2,628,000	360

Sherbime ndihmëse- Ridispecimi

Kapaciteti (MW)	Cmimi (€/MWh/h)	Nr. Ditëve	Nr. Orëve	Vlera ne €	Vlera ne mln Leka
100	60	100	6	3,600,000	493

1.5 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i licencuar nga ERE sipas dispozitave të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në ligj. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes; përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike; mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar. Në përputhje me Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike, OSHEE sh.a. prokuron energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE.


Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 dhe VKM Nr. 244, datë 30.3.2016, OSHEE sh.a ka vijuar të kryejë funksionin e Furnizuesit Universal për nevojat e klienteve tariforë.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE sh.a.) është organizuar në 10 Zona Shpërndarje dhe 40 Agjenci .

Më poshtë paraqiten të dhënat dhe pesh.at specifike të mesatarizuara që zënë treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2016 në raport me energjinë totale të furnizuar ne rrjet .

TE DHENA MBI AGJENSITE E SISTEMIT TE SHPERNDARJES 2016																
Agjensi/Drejtori	PROGRESIVI 2016			Arketimet 000/leke			Pesha specifike ne furnizim (%)	Pesha Speike ne shtje (%)	Peshaspecificke ne humbje (%)	Pesha specifike ne arketim (%)	Numri i Konsumatoreve					
	Energji e Blere (MW)	Energji e Shitur (MW)	Humbje (MW)	Arketim tot 2016	Arketim 2007-2015	Arketim fatura 2016					Gjithsej	Familjare	Privat	Buxhetor	Jo-Buxhetore	Konsum vetiak
Agjensia Tirana 1	860,032	745,538	114,495	10,065,981	1,488,129	8,577,852	13.78	11.95	1.83	17.46	117,754	96,858	20,280	444	161	11
Agjensia Tirana 2	692,112	569,929	122,182	7,537,963	974,080	6,563,883	11.09	9.13	1.96	13.36	112,305	95,515	16,057	548	176	9
Agjensia Tirana 3	654,526	442,688	211,838	6,105,561	1,165,459	4,940,103	10.49	7.09	3.39	10.06	76,977	66,534	10,024	299	113	7
Agjensia Durres	377,793	297,129	80,664	3,932,376	602,305	3,330,070	6.05	4.76	1.29	6.78	77,134	67,496	9,212	332	89	5
Agjensia Kavaje	135,135	102,313	32,822	1,272,666	209,706	1,062,961	2.17	1.64	0.53	2.16	41,277	37,321	3,600	259	91	6
Agjensia Kruje	162,971	92,158	70,812	959,112	197,850	761,262	2.61	1.48	1.13	1.55	17,519	15,272	2,078	123	43	3
Agjensia Shijak	151,603	105,642	45,961	1,423,050	268,116	1,154,934	2.43	1.69	0.74	2.35	26,039	23,121	2,698	122	95	3
Agjensia Ballsh	53,969	42,881	11,088	255,832	51,859	203,973	0.86	0.69	0.18	0.42	8,937	7,969	834	80	50	4
Agjensia Fier	272,659	222,228	50,431	2,295,106	347,413	1,947,693	4.37	3.56	0.81	3.96	56,553	48,749	7,283	378	137	6
Agjensia Patos	67,286	52,208	15,078	507,820	94,726	413,094	1.08	0.84	0.24	0.84	16,116	14,387	1,550	123	53	3
Agjensia Elbasan	290,185	232,400	57,785	3,095,668	452,366	2,643,302	4.65	3.72	0.93	5.38	70,853	61,287	8,865	436	252	13
Agjensia Gramsh	20,017	16,662	3,356	223,681	28,494	195,187	0.32	0.27	0.05	0.40	8,501	7,483	830	125	58	5
Agjensia Librazhd	47,552	34,983	12,569	468,900	77,286	391,614	0.76	0.56	0.20	0.80	17,087	15,000	1,847	151	81	8
Agjensia Pecin	31,817	22,747	9,070	274,821	42,040	232,780	0.51	0.36	0.15	0.47	8,416	7,413	889	77	34	3
Agjensia Biliisht	35,276	28,330	6,946	385,281	56,074	329,207	0.57	0.45	0.11	0.67	13,562	12,211	1,139	157	54	1
Agjensia Kolonje	14,960	10,019	4,941	136,365	16,628	119,736	0.24	0.16	0.08	0.24	5,768	4,894	671	164	31	8
Agjensia Korce	175,949	134,810	41,139	1,800,049	255,768	1,544,280	2.82	2.16	0.66	3.14	47,876	42,421	5,002	319	127	7
Agjensia Pogradec	73,845	57,795	16,050	790,017	118,285	671,732	1.18	0.93	0.26	1.37	25,763	22,935	2,498	260	65	5
Agjensia Delvine	17,966	14,531	3,435	183,018	28,648	154,369	0.29	0.23	0.06	0.31	6,419	5,556	695	122	43	3
Agjensia Gjirokastr	100,026	80,349	19,677	1,028,647	134,439	894,208	1.60	1.29	0.32	1.82	22,371	19,111	2,763	413	80	4
Agjensia Permet	22,549	18,747	3,801	246,904	31,383	215,521	0.36	0.30	0.06	0.44	9,075	7,749	1,093	181	48	4
Agjensia Saranda	99,300	81,701	17,599	1,097,675	155,741	941,935	1.59	1.31	0.28	1.92	31,526	27,264	3,845	342	72	3
Agjensia Tepelene	33,873	21,739	12,134	270,580	45,248	225,332	0.54	0.35	0.19	0.46	8,940	7,777	986	140	32	5
Agjensia Koplík	57,914	27,783	30,131	322,847	69,616	253,230	0.93	0.45	0.48	0.52	9,244	8,238	909	64	32	1
Agjensia Lezhe	164,894	104,250	60,643	1,302,319	228,494	1,073,825	2.64	1.67	0.97	2.19	29,015	25,608	3,114	199	90	4
Agjensia Puke	28,006	13,512	14,494	162,143	38,267	123,876	0.45	0.22	0.23	0.25	5,577	4,911	544	90	30	2
Agjensia Shkoder	422,887	242,079	180,808	2,968,907	626,047	2,342,860	6.78	3.88	2.90	4.77	61,426	52,576	8,156	539	145	10
Agjensia Berat	123,746	99,354	24,392	1,339,852	187,874	1,151,978	1.98	1.59	0.39	2.34	35,063	30,223	4,438	298	93	11
Agjensia Kuçove	47,491	38,106	9,385	428,007	66,352	361,655	0.76	0.61	0.15	0.74	14,748	12,401	2,143	127	75	2
Agjensia Lushnje	159,832	122,323	37,509	1,651,404	278,535	1,372,869	2.56	1.96	0.60	2.79	43,535	37,455	5,656	318	101	5
Agjensia Skrapar	23,756	18,164	5,592	224,680	35,843	188,837	0.38	0.29	0.09	0.38	7,646	6,616	860	117	45	8
Agjensia Has	26,462	10,425	16,037	145,671	39,548	106,123	0.42	0.17	0.26	0.22	3,418	3,044	305	50	19	0
Agjensia Kukes	78,397	43,222	35,175	452,564	109,395	343,168	1.26	0.69	0.56	0.70	10,811	9,449	1,162	158	38	4
Agjensia Tropoje	54,740	17,809	36,931	222,148	65,468	156,680	0.88	0.29	0.59	0.32	4,841	4,152	577	80	30	2
Agjensia Bulqize	43,958	35,892	8,066	518,626	82,736	435,890	0.70	0.58	0.13	0.89	8,595	7,695	774	84	36	6
Agjensia Diber	61,606	35,327	26,279	464,541	98,855	365,686	0.99	0.57	0.42	0.74	16,244	14,384	1,610	193	51	6
Agjensia Lac	147,757	86,694	61,063	637,267	137,150	500,117	2.37	1.39	0.98	1.02	15,104	13,290	1,661	97	52	4
Agjensia Mat	49,848	30,777	19,071	406,784	87,512	319,272	0.80	0.49	0.31	0.65	12,149	10,828	1,097	141	72	11
Agjensia Mirdite	38,782	22,186	16,596	324,235	63,056	261,179	0.62	0.36	0.27	0.53	7,353	6,408	779	119	45	2
Agjensia Himare	2,852	1,975	877	180,314	16,694	163,620	0.05	0.03	0.01	0.33	5,716	5,016	624	56	19	1
Agjensia Selenice	7,457	2,917	4,540	165,778	38,016	127,762	0.12	0.05	0.07	0.26	7,425	6,698	621	53	52	1
Agjensia Vlore	308,964	221,604	87,360	2,403,100	436,917	1,966,182	4.95	3.55	1.40	4.00	64,800	55,679	8,613	386	119	3
TOTAL	6,240,751	4,601,926	1,638,825	58,678,261	9,548,422	49,129,839					1,189,478	1,028,994	148,382	8,764	3,129	209

Figure 28 Agjensite e Rrjetit të Shpërndarjes dhe Pesh.a Specifike në Furnizim dhe humbje të Energjisë Elektrike (Burimi: OSHEE sh.a).



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna mbi Linjat, Kabinat dhe Transformatorët në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2016.

Numri total i kabinave ne rrjet																				
TIPI DHE NUMRI I KABINAVE													FUQIA E INSTALUAR (kVA)				NUMRI I TRANSFORMATOREVE TE FUQISE TM/TU			
METALIKE			MURATURE			BOX			SHTYLLLORE			NUMRI TOTAL I KABINAVE	6 kv	10kv	20kv	Total	6 kv	10kv	20kv	Total
6 kv	10 kv	20 kv	6 kv	10 kv	20 kv	6 kv	10 kv	20 kv	6 kv	10 kv	20 kv									
399	306	12	3,346	3,877	3,251	29	57	1,000	7,486	5,390	86	25,239	1,837,976	1,637,846	4,940,538	8,416,360	11,218	9,622	4,743	25,583
Numri i kabinave ne pronesi te OSHEE																				
TIPI DHE NUMRI I KABINAVE													FUQIA E INSTALUAR (kVA)				NUMRI I TRANSFORMATOREVE TE FUQISE TM/TU			
METALIKE			MURATURE			BOX			SHTYLLLORE			NUMRI TOTAL I KABINAVE	6 kv	10kv	20kv	Total	6 kv	10kv	20kv	Total
6 kv	10 kv	20 kv	6 kv	10 kv	20 kv	6 kv	10 kv	20 kv	6 kv	10 kv	20 kv									
300	218	1	1,978	2,772	1,826	8	43	959	2,049	2,183	52	12,389	901,419	935,998	1,098,940	2,936,357	4,515	5,250	2,870	12,635

GJATESIA E LINJAVE NE TENSION TE MESEM (km)	
Linja Ajrore	
6kV	5,281.12
10kV	7,462.98
16kV	-
20kV	146.81
35kV	1,112.18
Linja Kabllore	
6kV	290.38
10kV	180.99
16kV	-
20kV	1,653.02
35kV	10.00
TOTAL LINJA TM	16,137.47

GJATESIA E LINJAVE NE TENSION TE ULET (km)	
Linja Ajrore TU	23,484.55
Linja Kabllore TU	1,677.17
TOTAL LINJA TU	25,161.71

Figure 29 Të dhënat mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (Burimi: OSHEE).

Treguesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2016 paraqiten në tabelën në vijim:

TABELA ME TE DHENA TE OSHEE Sh.a 2016		2016
A	Energji Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	6,399,716
A.1	Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSHEE Sh.a	5,737,920
A.1.1	Nga KESH -Gen nepermjet OST	3,875,645
A.1.2	Nga OST si import i OSHEE Sh.a	1,587,671
A.1.3	Nga OST per llogari te klienteve te OSHEE Sh.a prodhuarnga HEC-et ne rrjetin e transmetimit	274,604
A.2	Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSHEE Sh.a	661,796
A.2.1	HEC Lanabregas	36,483
A.2.2	Impjantet Private/me Koncesion	625,314
B	Energji Totale ne Rrjetin e Shperndarjes (MWh)	6,399,716
C	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	1,794,451
C.1	Humbje Teknike njesite e TL (MWh)	155,629
C.2	Humbje Teknike ne Zona (MWh)	1,190,872
C.3	Humbje JoTeknike ne Zona (MWh)	447,951
C.1	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (%)	28.04%
C.1.1	Humbje Teknike njesite e TL (%)	2.43%
C.2.1	Humbje Teknike ne Zona (%)	19.08%
C.3.1	Humbje JoTeknike ne Zona (%)	7.00%
D	Energjia e shitur per te gjithë konsumatorët e OSHEE Sh.a	4,605,265
D.1	Shitur Klienteve Private (MWh)	1,515,870
D.1.2	Shitur per nevoja te veta te OSHEE Sh.a	10,041
D.1.3	Shitur Klienteve Private (pa ate per nevoja te veta dhe Ne TL)	1,505,829
D.2	Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)	292,095
D.3	Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)	210,039
D.4	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	2,587,261
D.4.2	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	2,513,273
D.4.3	Shitur Klienteve Familjare per Ambjentet e Perbashketa	73,987

Figure 30 Të dhënat mbi treguesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes gjatë vitit 2016.

Nga rezultatet e vitit 2016 evidentohet një performacë në rritje në drejtim të uljes së humbjeve dhe rritjes së nivelit të arkëtimit. Në paragrafet e mëposhtme paraqiten analizat e këtyre rezultateve.

1.6 Konsumi i Energjisë Elektrike

Konsumi total vjetor i energjisë elektrike (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar) në Shqipëri për periudhën 2002 deri në 2016 paraqitet në mënyrë grafike me poshtë.



Figure 31 Konsumi i përgjithshëm në vite.

Sic vërehet në paraqitjen grafike rezulton një ulje e konsumit në krahasim me periudhën 2011-2015.

Në tabelat vijuese jepen treguesit e sintetizuar nga të tre operatorët publik (KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.) të sistemit energjetik në Shqipëri.

TABELA ME TE DHENA TE OSHEE Sh.a 2016		2016	BILANCI I ENERGJISË OST 2016	2016
A	Energji Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	6,399,716	ENERGJI TOTALE QE HYN NË SISTEMIN E OST	8,462,262
A.1	Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSHEE Sh.a	5,737,920	- Prodhimi vendas me kesh sha	5,089,738
A.1.1	Nga KESH -Gen nepermjet OST	3,875,645	- Prodhimi vendas nga IPP me oshee sha	500,922
A.1.2	Nga OST si import i OSHEE Sha	1,587,671	- Prodhimi vendas nga Hec-et lokale me oshee sha	162,833
A.1.3	Nga OST prodhuar nga HEC-et ne rrjetin e transmetimit	274,604	- Prodhimi vendas nga hec Ashta	276,604
A.2	Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSHEE Sh.a	661,796	- Prodhimi vendas nga hec Peshqesh	107,995
A.2.1	HEC Lanabregas	36,483	- Prodhimi vendas nga hec Banje	69,847
A.2.2	Impjantet Private/me Koncesion	625,314	- Prodhimi vendas nga KURUM	427,570
B	Energji Totale ne Rrjetin e Shterperdarjes (MWh)	6,399,716	- Prodhimi vendas nga Hec Ulez	143,821
C	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	1,794,451	- Prodhimi vendas nga Hec Shkopet	114,558
C.1	Humbje Teknike njesite e TL (MWh)	155,629	- Prodhimi vendas nga Bistrica	169,191
C.2	Humbje Teknike ne Zona (MWh)	1,190,872	- Energji ne marrje	1,826,753
C.3	Humbje JoTeknike ne Zona (MWh)	447,951	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	8,272,253
C.1	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (%)	28.04%	- Energji ne dhënie	1,868,605
C.1.1	Humbje Teknike njesite e TL (%)	2.43%	- Energji e transmetuar per OSHEE sh.a	5,900,753
C.2.1	Humbje Teknike ne Zona (%)	19.08%	- Energji e transmetuar per klientet e kualifikuar	502,895
C.3.1	Humbje JoTeknike ne Zona (%)	7.00%	GSA sh.p.k.	425,874
D	Energjia e shitur per te gjithë konsumatorët e OSHEE Sh.a	4,605,265	KURUM INTERNATIONAL sh.a.	76,786
D.1	Shitur Klienteve Private (MWh)	1,515,870	AYEN AS FK	180
D.1.2	Shitur per nevoja te veta te OSHEE Sh.a	10,041	Devoll HPP	54
D.1.3	Shitur Klienteve Private (pa ate per nevoja te veta dhe Ne TL)	1,505,829	Humbje ne rrjetin e Transmetimit	190,008
D.2	Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)	292,095	- Nga kjo:	0
D.3	Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)	210,039	Nevoja vetjake	4,864
D.4	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	2,587,261	Humbje ne rrjetin e Transmetimit (%)	2.25
D.4.2	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	2,513,273		
D.4.3	Shitur Klienteve Familjare per Ambientet e Perbashketa	73,987		
			TE DHENA NGA KESH sha PER VITIN 2016 (MWh)	2016
			PRODHIMI BRUTO (MWh)	5,151,784
			HEC FIERZA	1,872,001
			HEC KOMANI	2,160,735
			HEC VAU DEJES	1,119,048
			KONSUMI VETIAK (MWh)	4,662
			HEC FIERZA	1,478
			HEC KOMANI	1,214
			HEC VAU DEJES	1,970
			HUMBJE NE PRODHIM (MWh)	55,506
			HEC FIERZA	19,385
			HEC KOMANI	25,163
			HEC VAU DEJES	10,957
			PRODHIMI NETO (MWh)	5,091,616
			HEC FIERZA	1,851,138
			HEC KOMANI	2,134,357
			HEC VAU DEJES	1,106,121
			TEC Vlorë (KONSUM)	-1,878
			Blerje ne tregun e parregulluar + optimizim (MWh)	129,620
			Shitje ne tregun e parregulluar + optimizim (MWh)	(1,021,345)
			Shkembimi KESH (MWh)	(18,394)



Figure 32 Treguesit e sintetizuar nga të tre operatorët kryesore të sistemit energjetik në Shqipëri 2016.

Bazuar në të dhënat e mësipërme të tabelave dhe informacioneve periodike apo specifike të operatorëve të tregut të energjisë u ndërtua Bilanci Energetik për vitin 2016 që paraqitet më poshtë.

BILANCI ENERJETIK VITI 2016 (MWh)											
Prodhimi Bruto KESH-Gen	5,151,784										
Humbjet ne prodhim KESH-GEN	55,506										
Konsumi Vetiak KESH-GEN	4,662										
	Neto KESH	Import OSHEE	Neto (Selit)	HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OSHEE	HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OST	UKKO	Neto Ashta	Neto Banja	Neto KURUM	H/C Peshqesh	Prodhim neto vendas
	5,091,616		36,483	625,314	500,922		276,604	69,848	427,571	107,995	7,136,352
Shitur OST per Humbje+konsum vetiak	-190,087										
Blere ne tregun e pa rregulluar+ Optimizim	129,620										
Shitje ne tregun e pa rregulluar+ Optimizim	-1,021,345										
Konsumi per TEC Vlora	-1,878										
Ballanca e shkembimeve	-18,394										
Te pa rakorduara,Disbalanca	8,585										
Shitur OSHEE sha nga prodhimi KESH Gen	3,998,117	962,277	36,483	625,314	500,922	276,604					
								69,848	427,571	107,995	
			6,399,716								
	0										
			6,399,716								
Shitur Kons Familjare	2,587,260										
Shitur Kons Jo Familjare	2,018,005		4,605,265								
Humbje tekn TL	155,629										6,399,716
Humbje teknike ne zona	1,190,872		1,794,451								
Humbje Jo teknike ne zona	447,951										
Konsumi I OSHEE											6,399,716
Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")											502,895
Konsumuar nga TEC Vlora 2016											1,878
Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)											190,087
KONSUMI TOTAL 2016											7,094,576

Figure 33 Bilanci Energetik viti 2016.

1.6.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

Në figurën e mëposhtme paraqiten pesh.at specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve tariforë.





Figure 34 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të klientëve.



Figure 35 Klientet Familjarë kundrejt konsumit total i vendit në vite.

Klientet privatë zënë 38 % te faturimit total te OSHEE sh.a., afërsisht e njëjta situatë krahasuar me vitin 2015.

Një peshë të rëndësishme në konsumin e energjisë elektrike zënë edhe konsumatorët buxhetorë dhe jo buxhetorë të cilët zënë rreth 13 % të faturimit total të OSHEE sh.a., afërsisht e njëjta situatë krahasuar me vitin 2015.

Në vendin tonë konsumi familjar në raport me konsumin e përgjithshëm të faturuar për klientet tariforë për vitin 2016 përbën rreth 49 %, afërsisht e njëjta situatë krahasuar me vitin 2015.

1.6.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të energjisë elektrike, tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuhet e plotë e konsumit dimër – verë.

Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparshme, edhe këtë vit vërehet i njëjti fenomen, ajo e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në dimër. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht prej efektit të përdorimi ose mospërdorimit të ngrohjes me energji elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt korrik dhe gusht tendenca e pikut është në rritje, i cili nga viti në vit po bëhet më evident dhe lidhet me përdorimin gjithnjë e në shkallë më të gjerë të pajisjeve klimatizuese.

Më poshtë paraqiten të dhënat e konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2016 krahasuar me të dhënat mesatare të periudhës 2009-2015.




Figure 36 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2016.

Në grafikun e mëposhtëm jepet profili mesatar ditor me bazë orare të ngarkesës për vitin 2016.




Figure 37 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2016.

PIKU I NGARKESËS (1 552 MW) datë 31.12.2016 ora 18:00

NGARKESA MINIMALE (359 MW) datë 18.02.2016 ora 04:00

1.7 Blerje Energjisë Elektrike në Treg të Parregulluar

Në zbatim të kërkesave të Modelit Shqiptar të Tregut, dhe VKM Nr.244 datë 30.03.2016, blerjet e energjisë elektrike në tregun e parregulluar, përfshirë importet, janë kryer nga OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a. dhe më poshtë po paraqesim një tabelë me të dhëna historike të blerjeve në tregun e parregulluar.

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
ENERGJI E BLERE ME CMIME TREGU NGA KESH & OSSH (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417	1,884	1,911	3,262	2,538	1,424	2,814	1,900	1,092

Në grafikun e Figurës 38 është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 2006 – 2016.

Për periudhën 2006-2016, me përjashtim të vitit 2010 dhe 2016 vendi ynë rezulton të jetë një importues neto i energjisë elektrike. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë aktorët e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.




Figure 38 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.).

1.8 Efektiviteti i Shitjes së Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2016 efektiviteti i shitjes të energjisë elektrike mbetet në vlera të rritura në raport me periudhën 2011-2014 në referencë gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efijencës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

1. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje.
2. Niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike së faturuar.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga Kompania për vitin 2016, arrijnë në 28.04%, duke shënuar një rënie të ndjeshme krahasuar edhe me vitin 2015.

Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSHEE sh.a. është 93.4 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar për vitin 2016 (shih tabelën e Faturim Arkëtimeve më poshtë) Kjo shifër përfshin edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007-2015 në vlef tën **9,537,411 000 lekë**.





Figure 39 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2007-2016.




Figure 40 Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2010-2016.

Viti 2016	Te arketueshme sipas 31.12.2015 OSHEE	Faturuar 2016	arketimi per faturat e 2016	Arketimi per faturat e 2007-2015	Arketimi total	Te Arketueshme per energjine e faturuar ne vitin 2016	Ndryshimi i gjendjes se Llogarive te arketueshme gjate vitit 2016	Shuarje Detyrimesh
	68,803,189	2	5	7	6=5+7	9=(2-5)		a+b
Janar	69,383,532	5,987,971	11,010	5,396,619	5,407,628	5,976,962	580,343	0
Shkurt	69,618,271	5,445,503	3,744,680	1,455,075	5,199,755	1,700,824	234,739	0
Mars	69,927,158	5,513,517	4,673,435	531,195	5,204,630	840,082	308,887	0
Prill	69,788,727	4,826,977	4,641,557	323,851	4,965,408	185,420	- 138,431	0
Maj	67,042,795	4,835,733	4,504,256	276,918	4,781,174	331,477	- 2,745,932	2,800,490
Qershor	67,501,589	4,525,728	4,203,847	245,816	4,449,663	321,881	458,794	0
Korrik	68,121,673	5,241,459	4,390,083	231,293	4,621,375	851,376	620,084	0
Gusht	68,364,412	5,309,834	4,799,986	267,109	5,067,095	509,848	242,739	0
Shtator	68,350,354	4,844,483	4,650,851	207,690	4,858,541	193,633	- 14,058	0
Tetor	68,499,705	4,834,628	4,480,377	204,901	4,685,278	354,252	149,351	0
Nentor	69,372,496	5,236,378	4,175,054	188,533	4,363,587	1,061,324	872,791	0
Dhjetor	70,720,061	6,410,681	4,854,705	208,411	5,063,116	1,555,976	1,347,565	0
Total		63,012,893	49,129,839	9,537,411	58,667,251	13,883,054		2,800,490

Figure 41 Faturim – Arkëtimet 2016.

ECURIA E TREGUESVE TE EFEKTIVITETIT TE SHITJES TE OPERATOTRIT TE SHPERNDARJES (%)

NIVELI I HUMBJEVE (%) 2009-2016												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	40.75	37.05	38.05	32.93	33.44	30.75	32.60	30.20	25.34	30.67	33.44	36.89
2010	38.62	35.41	36.90	31.37	35.17	31.45	26.94	29.69	21.47	20.61	22.16	29.05
2011	55.55	38.00	36.95	23.11	24.85	21.29	21.88	19.41	22.95	25.15	32.20	35.70
2012	35.72	59.16	55.23	45.41	38.87	39.77	45.51	45.51	42.09	35.53	41.89	49.32
2013	51.12	48.71	48.29	39.66	39.52	40.33	43.33	38.50	35.08	45.98	48.08	53.04
2014	47.00	42.14	42.78	35.69	36.85	34.10	36.59	36.36	31.67	34.52	32.88	37.54
2015	36.68	31.82	32.88	30.54	31.24	28.60	30.62	29.29	25.30	29.92	30.82	34.5
2016	34.69	29.00	29.93	26.07	26.97	24.35	25.97	25.15	22.12	27.11	29.30	30.99

Niveli i Arketimeve (%) 2009-2016												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	69.32	85.95	74.38	86.58	86.31	76.37	75.40	72.46	83.20	80.82	61.77	70.01
2010	55.37	66.28	86.63	89.46	86.70	79.42	74.84	124.98	84.20	70.81	56.15	66.48
2011	67.26	57.61	87.66	71.61	96.73	73.00	65.00	81.00	66.00	63.86	51.47	87.30
2012	59.80	79.20	78.50	78.00	94.70	83.50	91.60	102.90	74.00	98.00	72.60	78.00
2013	61.40	63.70	86.20	80.70	79.10	69.60	87.90	90.10	78.50	84.30	89.00	102.00
2014	84.90	77.10	85.90	85.50	81.90	80.20	86.70	83.60	102.60	101.00	101.90	141.00
2015	112.70	120.50	103.70	86.60	95.70	97.10	98.40	104.70	95.30	100.30	92.20	100.70
2016	92.10	87.00	95.60	90.10	99.10	92.00	94.20	96.70	91.50	96.70	90.30	96.70

Efektiviteti i shitjeve (%) 2009-2016												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	41.1%	54.1%	46.1%	58.1%	57.4%	52.9%	50.8%	50.6%	62.1%	56.0%	41.1%	44.2%
2010	34.0%	42.8%	54.7%	61.4%	56.2%	54.4%	54.7%	87.9%	66.1%	56.2%	43.7%	47.2%
2011	29.9%	35.7%	55.3%	55.1%	72.7%	57.5%	50.8%	65.3%	50.9%	47.8%	34.9%	56.1%
2012	38.4%	32.3%	35.1%	42.6%	57.9%	50.3%	49.9%	56.1%	42.9%	63.2%	42.2%	39.5%
2013	30.0%	32.7%	44.6%	48.7%	47.8%	41.5%	49.8%	55.4%	51.0%	45.5%	46.2%	47.9%
2014	45.0%	44.6%	49.2%	55.0%	51.7%	52.9%	55.0%	53.2%	70.1%	66.1%	68.4%	88.1%
2015	71.4%	82.2%	69.6%	60.2%	65.8%	69.3%	68.3%	74.0%	71.2%	70.3%	63.8%	66.0%
2016	60.2%	61.8%	67.0%	66.6%	72.4%	69.6%	69.7%	72.4%	71.3%	70.5%	63.8%	66.7%

Figure 42 Ecuria e treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatortit të Shpërndarjes (%)

(Burim: OSHEE).

Efektiviteti i shitjeve për periudhën 2009-2016 jepet në grafikun e mëposhtëm.




Figure 43 Efektiviteti i shitjeve të OSHEE 209-2016 (Burim: OSHEE).




Figure 44 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjitik.

Në figurën 44 është paraqitur ecuria e humbjeve totale përfshirë ato në sistemin e transmetimit, gjatë periudhës 2002 – 2016, kurse në grafikun e figurës 45 është paraqitur marrëdhënia e faturim-arkëtimeve gjatë së njëjtës periudhë.




Figure 45 Faturimi/Arkëtimi 2002-2016 (Burimi: OSHEE sh.a.).

PJESA II: Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror

2.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline)

Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburimi Sh.ah Deniz 2 (SD 2) në Azerbajxhan drejt Tregut European të Gazit. Transportimi përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë do të kryhet me anë të tubacionit South Caucasian Pipeline, ndërsa transportimi përmes Turqisë do të kryhet me anë të tubacionit TANAP deri në kufirin Turko-Grek.

Transportimi i mëtejshëm do të kryhet me anë të tubacionit Trans Adriatic Pipeline (TAP). TAP do të shtrihet përmes Greqisë, Shqipërisë, në tabanin e detit Adriatik për tu bashkuar me Sistemin Italian të Transmetimit të Gazit në zonën e San Foca në Italinë Jugore çka mundëson lëvizjen e mëtejshme drejt tregjeve evropiane.

Dihet se territori ku do të merret kjo sasi gazi është nga më të mëdhatë e krahasuar me Evropën, Afrikën Veriore dhe Rusinë. Në pamjen e mëposhtme jepen rezervat që disponojnë këto rajone. (Trilion M³)



Figure 46 Pasqyrim i Statistikave Botërore për Energjinë 2014.

Projekti fillimisht do të transportojë 10 bcm/vit, me mundësinë për zgjerimin më vonë të kapacitetit deri në 20 bcm/vit nëpërmjet shtimit të stacioneve të reja të kompresorëve. TAP është i projektuar gjithashtu që të mundësojnë rrjedhjen fizike të gazit në drejtim të kundërt.

Projekti TAP është zhvilluar nga kompania TAP AG. Aksionerët fillestarë të kompanisë kanë qenë: kompania zvicerane Axpo (42.5%), kompania norvegjeze Statoil (42.5 %) dhe kompania gjermane E.ON Ruhrgas (15%). Statoil është gjithashtu aksionere (25,5 %) në Konsorciumin Sh.ah Deniz që është kompania që shfrytëzon SD2.

Në 30 korrik 2013 struktura e aksionerëve të TAP ndryshoi si vijon; BP (20%), SOCAR (20%), Statoil (20%), Fluxys (16%), Total (10%), E.ON (9%) dhe Axpo (5%)

Ka pasur përsëri ndryshim aksionerësh për të cilin janë njoftuar të gjithë palët e interesuara përfshi edhe tre autoritetet kombëtare, ajo Greke, Italiane dhe Shqiptare.

Disa ndryshime në pronësinë e TAP AG - sidomos, dalje e përgjithshme e Total Gas Transport Ventures S.A.S. dhe E.ON (përmes Global Commodities SE), dalja e Statoil ASA si aksionerëve dhe hyrjen e Enagás Internacional SLU dhe SNAM S.p.A (Itali). Aksionerët aktual paraqiten sipas tabelës mëposhtme:

Aksionerët	Aksionerët përpara ndryshimit të parashikuar në 23 Korrik 2013	Aksionerët aktualë Për 2016	Ndryshimi
AzTAP (më parë e njohur si SOCAR GAS Pipelines GmbH)	20%	20%	0%
BP Gas Marketing Ltd	20%	20%	0%
SNAM S.p.A(Itali)	0%	20%	+20%
Fluxys Europe BV	16%	19%	+3%
Enagás Internacional S.L.U	0%	16%	+16%
Axpo Holding AG	5%	5%	0%
Total Gas Transport Ventures SAS	10%	0%	-10%
E.ON,Global Commodities SE	9%	0%	-9%
Statoil ASA	20%	0%	-20%

Figure 47 Aksionerët aktual TAP.

2.2 Ecuria e deritanishme e projektit TAP-AG në Shqipëri

Faktet dhe Shifrat Kryesore deri në fund të vitit 2016



Gjatësia	<p>~ 878 km</p> <ul style="list-style-type: none"> Në Greqi 550 km; Shqipëri 215 km; Detin Adriatik 105 km; Itali 8 km (~mikro tunel 1.5 km afrim drejt tokës) Pika më e lartë: 1,800 metra në Shqipëri Pika më e ulët: 820 metra në thellësi të detit Adriatik
Kapaciteti	<p>10 miliard metra kub Gaz Metan në vit, gas i mjaftueshëm për të furnizuar rreth 7 milion familje.</p> <p>Diametri: 48 inch (1.2 m) në tokë; 36 inch (0.91 m) në det.</p> <p>Rasti Kryesor. Dy stacione kompresimi (një në Kipoi, Greqi dhe tjetri në Fier, Shqipëri) dhe ndërtimi i tij për dërgim rivers (marrje dhe dërgim).</p> <p>Pjesa e Shtuar. Një kapacitet mbi 20 miliard metër kub Gaz Metan në vit duke instaluar dy stacione shtesë kompresimi një në Serres Greqi dhe tjetrin në Bilisht, Shqipëri.</p>
Lidhja	Infrastruktura e TAP do të lidhet me: Gazsjellësin TANAP Trans

	Anatolian, SNAM në Itali, dhe po ashtu do të lidhet me Interkonjektorin Greqi-Bullgari (IBG) dhe Gazsjellësin Ionian Adriatic (IAP).
Kohëzgjatja	Korrik 2015 – fillimi i punës përgatitore të ndërtimit në Shqipëri Prill 2016 – ka mbarruar dhënia e kontratave kryesore Maj 2016 – fillimi i ndërtimit të gazsjellësit dhe instalimeve mbi tokë Periudha e Dimrit 2017/2018 – Ndërtimi i gazsjellësit pjesa në det (Fundi) 2019 – të ketë mbarruar ndërtimi dhe dorrëzimi 2020 – gazi i parë i TAP do të fillojë punën
Investimet e TAP në Shqipëri	<ul style="list-style-type: none"> • Afërsisht 1.5 miliard euro do të investohen në Shqipëri nga TAP, përfshirë kostot e tubave, kompresoreve dhe të gjitha pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për ndërtimin e gazsjellësit.
Ecuria e Ndërtimit të pjesës së bregut (onshore) në Shqipëri	<ul style="list-style-type: none"> • 54 km rrugë e pastruar deri tani dhe po vazhdohet sipas programit të hartuar për këtë qëllim • 48 km tuba të lidhur deri tani dhe po vazhdohet me intensitet • 38 km tuba të salduara dhe të lidhura me njëra tjetrën • 29 km ka përfunduar gërmimi i trasesë ku do të shtrihet tubacioni • 28 km tuba të ulur dhe të shtrirë në tokë gati për lidhjen dhe saldimin e tyre me tubot e tjera • 24 km tuba të vendosur në trase përfundimisht • 76% (166km) të tubave dhe 70% (567Nr.) të tubove të shpërndara në portin e Durrësit.
Rrugët dhe Urat e kalueshme në zonat e Korcës, Beratit dhe Fierit	<ul style="list-style-type: none"> • 100% e punimeve për fazën e parë të ARB nuk kanë përfunduar ende(ecuri e kombinuar për shkak të kushteve dhe terrenit). Përbëhet nga 58 km rrugë, ndërtimi i 2 urave të reja dhe rregullimi i 40 të tjerave.Janë në vazhdim. • Faza e dyte e përditësimit të rrugëve, përbëhet nga përafërsisht 120 km rrugë dhe është ndërtuar nga kontraktori i EPC Spiecapag (AlbStar-it i është dhënë nënkontrata për një pjesë deri më sot).
Punësimi	<ul style="list-style-type: none"> • Në Shqipëri për projektin aktualisht po punojnë më shumë se 1,800 punonjës. • Përafërsisht 89% e të cilëve janë Shqiptarë.


<p>Procesi për të drejtën e kufizuar të përdorimit të tokës & Marrjen e Tokës (LEA)</p>	<p>E kryer në përputhje me standartet ndërkombëtare të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD).</p> <ul style="list-style-type: none"> ● 8,800 parcela toke të prekura në total në Shqipëri (shifra të llogaritura). ● Përafërsisht 1'300 parcela të prekura për Rrugët dhe Urrat e Aksesueshme. ● Përafërsisht 7'500 parcela të prekura për Gazsjellësin RoW, CS dhe AGI. ● Tokë e cila është marrë përkohësisht për të punuar është 8'170 ha, 8, 7 km². ● Tokë e marrë përgjithmonë për 8 BVS dhe për një stacion të qëndrueshëm në tokë, 1 stacion kompresori dhe 1 stacion matje në total 70 ha.
<p>Kadastra e Përmirësimit të të Dhënave</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● 13,000 parcela dokumentacion i përditësuar dhe përmirësuar, 17'000 hektarë. ● *25,000 është afërsisht numri i përfituesve.
<p>Gazsjellësi në Shqipëri</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Afërsisht 13,000 tuba do të përdoren për ndërtimin e pjesës së gazsjellësit në Shqipëri. ● Pesh.a e një tubi prej 18 metrash është 16'900 kg. ● Në Shqipëri do të përdoren tuba me gjatësi 18 dhe 12 meter dhe diametër 1.22 m. ● Pesh.a e tubave të celikut për pjesën e gazsjellësit në Shqipëri është përafërsisht 116.184 ton. ● Presioni maksimal i funksionimit në Stacionin e Kompresimit është 97/147 bar. ● Vëllimi i gërmimit të kanalit për pjesën Shqiptare të Gazsjellësit 215 km është 1.300.000 m³.
<p>Përfitimet e TAP në Shqipëri</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● E vendos Shqipërinë në hartën Europiane të Energjisë. ● Ndhmon në zhvillimin e infrastrukturës energjetike të vendit dhe tregun e brendshëm të energjisë. ● Rrit rëndësinë rajonale dhe gjeo-strategjike të vendit dhe ndihmon në integrimin komercial dhe fizik të Shqipërisë në Europë. ● Nxit zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës si dhe inkurajon investimet e huaja.

	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirëson infrastrukturën e rrugës në Shqipëri dhe ndihmon në shtimin e sigurisë rrugore. • Përmirësim i të dhënave të kadastrës në zonat ku kalon projekti. • Zbatimi i Investimeve Sociale dhe të Mjedisit që do të përmirësojë cilësinë e jetesës të komunitetit për zonat ku do të kalojë projekti TAP. • Së bashku me projektin IAP bëjnë përfundimisht vëndin tone një nje të rëndësishme në Ballkan • Vëndi jonë duke patur kapacitete të mëdha për magazinimin e gazit(St
Kontraktorët kryesore të TAP në Shqipëri	<ul style="list-style-type: none"> • JV Gener 2 dhe Sicilsaldo: Kontraktor për rehabilitimin e fazës së parë të Aksesit të Rrugëve dhe Urave (ARB) në Shqipëri. • Spiecapag: Kontraktori EPC për instalimin e dy pjesëve në tokë të gazsjellësit në Shqipëri (215km në total) • JV Renco S.p.A dhe Terna S.A: Kontraktori EPC për stacionet e kompresimit të projektit. • Saipem SpA: Kontraktori EPCI për pjesën në det të projektit. • ABKons: Mbështeti TAP studimin, shpërndarjen publike dhe konsultimet publike për raportin ESIA të TAP Shqipëri. Aktualisht po punon për procesin e të drejtës së kufizuar për përdorimin e tokës dhe marrjen e saj (LEA) për të siguruar mënyren e duhur në Shqipëri dhe për të mbështetur TAP në procesin e lejimit. • Ka një numër kompanish të tjera Shqiptare të cilat punojnë si nënkontraktore për Kontraktorët e EPC (sic janë AlbStar, Diamant Logistics, Startrans, Pelikan, Sterkaj, etj.)
Aksioneret	BP (20%), SOCAR (20%), Snam (20%), Fluxys (19%), Enagás (16%) dhe Axpo (5%)

ARB	Aksesi i Rrugëve dhe Urave
AGI	Instalimet mbi Tokë, sic janë Valvulat e Bllokimit ose Stacionet e Kompresimit
CS	Stacionet e Kompresimit
PY	Zona ku janë vendosur Tubat
BVS	Stacioni i Valvulave të Bllokimit

RoW	Rruga Specifike
EPC	Punimet inxhinierike, Prokurimi dhe Ndërtimi
LEA	Procesi i të drejtës së kufizuar për përdorimin e tokës dhe marrjen e saj (LEA)
EPCI	Punimet Inxhinierike, të Prokurimit, Ndërtimit dhe Instalimit
*	Numri i përfituesve bazohet në supozime dhe është përafërsisht. 4-5 bashkëpunëtorë për të njëjtën parcele

Korridori Jugor i Gazit (SGC)



Korridori Jugor i Gazit (SGC) është një nga zinxhirët më të ndërlikuar të gazit në botë, i cili synon të sjellë burime nga rajoni Kaspik në tregjet Europiane të energjisë për herë të parë. Gazi Natyror nga fush.a e Sh.ah Deniz do të bëjë një rrugë prej 3,500 km nga Deti Kaspik në Europë. Kjo do të kërkojë përmirësimin e disa infrastrukturave ekzistuese dhe zhvillimin e një zinxhiri për gazsjellësat e rinj.

- Zhvillimi i Sh.ah Deniz II, pusët e shpimit dhe prodhim detar i gazit në Detin Kaspik.
- Zgjerimi i impiantit të përpunimit të gazit në terminalin e Sangachal në bregun e Detit Kaspik në Azerbajxhan.
- Tre projekte gazsjellësish:
 - Gazsjellësi i Kaukazit të Jugut (SCPX) – Azerbajxhan, Gjeorgji
 - Gazsjellësi Trans Anatolian (TANAP) – Turqi
 - Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) – Greqi, Shqipëri, Itali

- Zgjerimi i rrjetit Italian të transmetimit të gazit.
- Mundësi për lidhje të tjera me rrjetet e gazit në Europën Juglindore, Qëndrore dhe Perëndimore

2.2.1 Vendimi i Përjashtimit të TAP AG-s

Vendimi i Përjashtimit është i mbështetur në paragrafin 4.5 të FJO i cili përjashton TAP-AG nga dispozitat e pronësisë, si përcaktohet në nenin 9(1) të Direktivës së Gazit.

I gjithë investimi që do të kryhet për këtë projekt do jetë rreth 45 miliard dollarë duke përfshiruar gjashtë shtete me një gjatësi tubacioni 3500 km.

Final Joint Opinion i qershorit 2013 përcaktonte se Vendimi Përjashtues do të humbte efektin dhe vlefshmërinë e tij nëse ndërtimi nuk do të fillonte brenda 3 viteve (pra, brenda Qershorit 2016) dhe nëse nuk fillonte veprimtaria operationale brenda 6 viteve të ardhshme. Gjithsesi, Komisioni i BE-së do të mund të aprovonte një shtyrje në rastin e ndonjë vonese të shkaktuar nga pengesa madhore përtej fuqisë së TAP-it. (kjo bazuar në nenin 36.9 të Direktivës 79/2003/EC).

Në vendimin e Komisionit European të Majit 2013 parashikohej se roli TAP-it është vetëm një nga elementet në vazhden e investimeve që nevojiten të kryhen për të siguruar prodhimin e Gazit të Shah Deniz 2 dhe transportimin e gazit për në BE. Veçanërisht, vendimi parashikonte se TAP-i nuk ka asnjë influence mbi zhvillimin e mëtejshëm të procesit; pra, asnjë influence mbi fushën e gazit të Shah Deniz 2, infrastrukturën e transportit nga Azerbajxhani për në Gjeorgji, si dhe infrastrukturën e transportit përgjatë Turqisë.

Në kohën që është marrë Vendimi Përjashtues për TAP-in, duke patur parasysh edhe kërkesën për shtyrje nga Konsorciumi nëpërmjet TAP-it dhe të miratuar nga tre Autoritetet, Janari vitit 2020-s deri në Dhjetor të vitit 2020, është vlerësuar si periudha kohore kur gazi do të hyjë në sistemin transportit të TAP-it.

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit të Ministrave të datës 13 Korrik 2009; Rregullores 715/2009/EC të Parlamentit European dhe Këshillit të datës 13 Korrik 2009, Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; Vendimit të Komisionit European C(2013) 2949 të datës 16 Maj 2013; ”Opinionit të Përbashkët Përfundimtar

të Rregullatorëve të Energjisë ‘mbi Aplikimin e TAP AG për Përrjashtim (Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin në Itali) AEEGSI, Enti Rregullator i Energjisë Shqipëri (ERE) dhe Autoriteti Rregullator Greqi (RAE), në vijim të Final Joint Opinion; Vendimit të Bordit Nr. 12, datë 14.02.2014 “Për Miratimin e Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përjashtimit të Gazësjellësit TAP. Kjo ishte një shtesë ose një amendim që u realizua në sajë të një diskutimi të gjatë midis tre Autoriteteve Rregullatore të Italisë, greqisë dhe Shqipërisë, sigurisht që ky diskutim i gjërë është bërë në përputhje të ndryshimeve të fundit të bëra nga Komisioni European në kuadër të transparencës.

2.2.2 Data e Planifikuar e Fillimit të TAP-it (PCD).

Projekti TAP-AG ka një ecuri shumë të mire i cili përputhet me grafikun e miratuar nga konsorciumi në lidhje me prodhimin e gazit nga vendburimi i Sh.ah Denizit, por gjithashtu edhe veprimeve të mëtejshme deri në fund të vitit 2016.

Përsa i përket TAP-it, procedura për të përcaktuar PCD-n përshkruhet në Marrëveshjen për Përcaktimin e Tarifave (TDA) të Korrikut 2013, ku palët që kanë rënë dakord janë BP Exploration (Sh.ah Deniz) Limited (për llogari të South Gas Corridor), SOCAR dhe TAP AG. Në TDA është sanksionuar e drejta e SDC-se për të përcaktuar PCD brenda parametrave të përcaktuar.

TAP-i nuk është një infrastrukturë ekzistuese, dhe si një projekt gazsjellësi ndërkufitar dhe i vetë qëndrueshëm ende për tu ndërtuar, TAP-i nuk do të marrë aktivitetet e OST-së, para datës në të cilën gazsjellësi TAP do të përfundojë dhe do të jetë në gjendje të marrë, transportoj dhe të dërgoj Gazin Natyror, ashtu si është përcaktuar në Commercial Operacioni Data (COD) në FJO.

Në Gusht 2013, të tre Rregullatorët Kombëtarë u njoftuan nëpërmjet një shkrese të hartuar nga TAP-i ku përmbledhesh TDA-ja (Marrëveshja e Përcaktimi të Tarifave), përfshirë edhe parimet e ‘funneling mechsansim’. Procesi për të përcaktuar PCD është gjithashtu i përfshirë në versionin Final të Kodit të Tarifës së TAP-it, i cili u miratua nga Rregullatorët Kombëtarë në Nëntor të 2013-ës.

2.2.3 Gjendja aktuale e Projekti TAP dhe projekte të tjera në sektorin e gazit.

Projekti TAP doli si një Projekt me Rëndësi Kombëtare në Dhjetor 2012, hartimi i një marrëveshjeje Ndërqeveritare midis tre shteteve; Greqisë, Italisë dhe Shqipërisë u arrit të bëhej, në Shkurt 2013. Qeveria shqiptare beri një marrëveshje me TAP-in, Host Government Agreement, HGA në Prill 2013 dhe një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) përmbështetjen e TAP & IAP në Maj 2013.

Nga qeveria shqiptare u aprovua më 03 Maj 2013, Vlerësimi i impaktit social dhe ambiental, gjë e cila hapi rrugën për veprime të mëtejshme. Gjatë vitit 2016-të Qeveria shqiptare negocijojë me TAP AG për mundësinë e përfitimit të mëtejshëm nga projekti TAP AG dhe rezultatet qenë domethënëse.

Në inaugurimin e punimeve të projektit TAP AG në mesin e vitit 2016 (në një nga inaugurimet të atij viti) kryeministri z.Edi RAMA premtoj se do të vazhdonte negociatat me TAP AG për përfitime të mëtejshme nga ky projekt, të paktën të ishin të njëjta me ato që merr vendi fqinjë i joni Greqia (në përputhje me gjatësinë e kalimit të tubacionit në vëndin tonë). Kjo sot është bërë një realitet, pothuajse dyfishuam të ardhurat për vëndin tonë nga ky projekt. Ministria e linjës disponon të gjitha të dhënat e mjaftueshme për këtë problem.

Projekti TAP-AG po shikohet si një projekt që krijon unazën (Ring) në Europe, kjo do të bëjë që të ketë diversitet furnizimi me Gaz Natyror por njëkohësisht lidhja në të ardhmen e afërt me Projektin IAP, do të bëjë vëndin tonë një nyje lidhëse në drejtim të Malit të Zi, Kosovë, Maqedoni dhe Kroaci.

Në lidhje me projektin IAP, qeveria ka aplikuar tashmë për financime të projektit pranë Komisionit European, dhe po punohet ngushtësisht me qeveritë e dy shteteve të tjera ku kalon ky projekt, Malit të Zi dhe Kroacisë për sigurimin e këtyre fondeve e duke shkuar drejt realizimit të këtij projekti.

Njëkohësisht projekti IAP, duke kaluar në drejtim të veriut, përshkon në mënyrë gjatësore territoret e vëndit tonë, dhe për rrjedhoje do të shërbejë si një magjstral, rrjet transmetimi i presionit të lartë, duke siguruar kështu një furnizim të qëndrueshëm afat gjatë me gaz të Kosovës.

Ky projekt do të bëjë lidhjen me projektin TAP-AG, nëpërmjet Shqipërisë, Malit të Zi do të përfundojë në Kroaci, dhe nga ky projekt do të përfitoj, Kosova dhe Bosnja Hercegovina. Gjatësia e këtij tubacioni do të jetë 511 km, do të transportojë 5 bcm/vit dhe përfituesit nga kjo sasi gazi do të jetë; Shqipëria me 1bcm/vit, Mali i Zi me 0,5

bcm/vit, Bosnja dhe Hercegovina 1bcm.vit, Kroacia me 2.5 bcm/vit. Kosova do të marrë gaz nëpërmjet Shqipërisë.

2.2.4. Aktivitetet të tjera gjatë 2016 ne lidhje me zhvillimet në sektorin e gazit.

Në lidhje me “Master Planin e Gazit Natyror për Shqipërinë dhe Identifikimi i Projekteve Prioritare ne Fushën e Gazit Natyror”, Enti Rregullator i Energjisë ne këtë projekt është Palë e Interesuar duke qënë aktive në diskutimin dhe orientimin e vendimarrjeve.

Ky projekt do te përfundojë ne Tetor 2016.

2.3 Zhvillime të tjera rreth Projektit TAP

2.3.1 Rreth vendimeve të marra për projektin.

Viti 2016-të ka qënë një vit ku puna për projektin TAP është intensifikuar së tepërmi dhe ku rezultatet kanë qënë konkrete dhe të dukshme. Ne jemi vendi i parë që filluam punimet e TAP-it duke u krahasuar me dy vendet fqinje Italinë dhe Greqinë.

Enti Rregullator i Shqipërisë së bashku me Entin Rregullator të Greqisë dhe Italisë, kanë marrë vendime të përbashkëta në lidhje me projektin TAP-AG. Këto vendime janë marrë në përputhje të plotë me Direktivën e Parlamentit European dhe të Këshillit, 2009/73/EC, Rregullores (EC) N0.715/2009 , të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr.D/2011/02/MC-EnC, si dhe ligjit “Për Gazin Natyror” Nr.102/2015, i cili tashmë ka reflektuar të gjitha kërkesat e Bashkimit European.

2.3.2 Vendimet e marra gjatë vitit 2016 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e gazit natyror.

Gjatë vitit 2016 janë marrë një sërë vendimesh me rëndësi për zhvillimin e tregut të gazit natyror në vendin tonë. Nga vendimet më të rëndësishme kanë qënë: Miratimi i vendimit paraprak për çertifikimin e TAP-AG si TSO dhe miratimi më parë i rregullores për çertifikim në përputhje me ligjin e ri të gazit natyror Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe konkretisht vendimet të marra janë:

Vendimi Nr.8 Datë 27.01.2016, “Mbi liçencimin e shoqërisë Phoenix Petroleum” sh.a, në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror“.

Vendimi Nr.44 Datë 12.04.2016 “Për liçencimin e shoqërisë Phoenix Petroleum sh.a., në aktivitetin e tregimit të gazit natyror“.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është i lidhur me VKM Nr.699, datë 16.08.2013 “Për Miratimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure“ ku, ndërmjet palëve: kompanisë Alpetrol sh.a. nga njëra anë dhe Shoqërisë Phoenix Petroleum sh.a. nga ana tjetër, janë lidhur marrëveshje për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve për disa vendburime nafte dhe gazi. Shoqëria në kërkesën për liçencim në aktivitetin e Furnizimit dhe Tregimit të Gazit Natyror e ka shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga Rregullat dhe Procedurat për Liçencimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçencave në Sektorin e Gazit Natyror.

Vendimi Nr .114 Datë 08.07.2016 “Për miratimin e rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror“.

Në kuadër të hartimit të akteve nënligjore që burojnë nga Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” neni 20, pika “ë”, neni 24 dhe neni 17, pika “ë”; neni 98 i Ligjit Nr. 102/2015 ”Për sektorin e Gazit Natyror”, ERE miratoi “Rregulloren për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

Kjo rregullore përcakton procedurat dhe afatet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet klienteve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në frymën e zbatimit të Ligjit Nr. 43/2015”Per sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit Nr. 102/2015 ”Për sektorin e Gazit Natyror” .

Për hartimin e kësaj rregulloreje është mbajtur në konsideratë, përveç praktikave më të mira të vendeve të rajonit dhe legjislacioni në fuqi si:

Kodi i Procedurave Administrative;

Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”;

Ligji Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Nëpërmjet kësaj rregulloreje garantohet roli i ERE-s në gjykimin sa më të drejtë, transparent në mbrojtje të të drejtave të klientëve dhe sigurimin e trajtimit sa më të barabartë dhe jodiskriminues ndaj operatorëve të tregut të energjisë në respekt dhe në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të tregut të energjisë elektrike.

Sikurse dhe në rastet e tjera për aktet nënligjore, mbas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të miratimit të tyre, nga Bordi i ERE-s, drafti i Rregullores u konsultua me të gjitha grupet e interesit

Me Vendimi Nr. 152 Datë 30. 09.2016 të Bordit të ERE-s filluan procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draft – Rregullores për Procedurat e Licensimit, Modifikimit, Transferimit të pjesshëm ose të plotë, Heqjen e Licensave në Sektorin e Gazit Natyror.

Ligji Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror “ në nenin 24 ka përcaktuar se «ERE miraton rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licensave, pagesat e aplikimeve për licensë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikim për çdo licensë”.

Në përputhje me këtë kërkesë të ligjit u vijua puna me hartimin e draft rregullores së sipërcituar në të cilën trajtohen elemente që kanë të bëjnë me procedurat e licensimit të veprimtarive të sektorit të energjisë elektrike, ku përcaktohen afatet, forma, mënyra dhe pagesat e aplikimit për çdo licensë.

Gjatë përpunimit të draftit të rregullores është synuar të hartohet një dokument ku të përcaktohen kompetencat e ERE-s për licensimin në fushën e gazit natyror. Gjithashtu në këtë draft përcaktohen qartë procedurat për licensimin, modifikimin, transferimin, dhe heqjen e licensës për çdo subjekt që kërkon të ushtroj aktivitet në sektorin e gazit natyror.

Rregullorja përcakton procedurat e licensimit për:

- Kryerjen e aktivitetit sikurse përcaktuar në Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror “ duke specifikuar kushtet për dhënien, modifikimin dhe rinovimin e një license si dhe autoritetin e ERE-s për përcaktimin e pagesave për kryerjen e çdo aplikimi për licensë.

Heqjen ose përfundimin e një license në përputhje me nenin 27 të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror „,

Aktualisht është realizuar procesi i konsultimit publik dhe është kërkuar opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vjenë.

Vendimi Nr. 185, Datë 23.11.2016 Mbi kërkesën e TAP AG për aprovimin e Programit të përputhshmërisë Rregullatore “Regulatory Compliance Programme” të rishikuar paraqitur në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar /Final Joint Opinion miratuar me Vendimin Nr. 12, datë 14.02.2014.

Me vendimin Nr. 12, datë 14.02.2014, ERE ka miratuar Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të

procedurës së përjashtimit të gazsjellësit TAP. Më datë 17.11.2016, TAP AG ka dërguar në ERE për miratim disa ndryshime në Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme, si detyrim i seksioneve 4.5.1 dhe 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion (FJO).

Ndërkohë vlen të theksohet se dy Rregullatorët pjesë e Final Joint opinion, ai i Greqisë dhe i Italisë i kanë miratuar gjithashtu këto ndryshime më herët.

2.3.3 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për TAP AG.

Enti Rregullator i Energjisë miratoi Metodologjinë e Tarifave për Gazin me anë të Vendimit Nr. 127, datë 7.11.2013, “Mbi Miratimin e Metodologjisë së Tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”

Në datën 8 Nëntor 2013, tre Rregullatorët e Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (Aeeg) aprovuan Kodin e Tarifave të propozuar nga kompania TAP AG për TAP, tubacionin e gazit që do të sjellë gazin e Azerbajxhanit në Itali, nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Kodi i Tarifave për TAP përshkruan metodologjitë e përdorura për përcaktimin e termave dhe kushteve të çmimeve që do të aplikohen për TAP do të aplikohen si për kapacitetet subjekt i aksesit të detyrueshëm të palëve të treta, edhe për kapacitetet e përjashtuara nga këto kërkesa.

Metodologjia e tarifave e propozuar nga TAP AG është transparente dhe jo diskriminuese. Kodi i Tarifave parashikon një zvogëlim të tarifës në rast të rritjes së kapacitetit të rezervuar në të ardhmen. Nga ana tjetër, në përputhje me Opinionin Final të Përbashkët, struktura e tarifave merr në konsideratë nivelin e ndryshëm të riskut ndërmjet investimit në kapacitetin fillestar dhe investimit për zgjerim në të ardhmen.

Metodologjia e Tarifave ka pësuar një sërë ndryshimesh që prej versionit të saj fillestar në sajë të komenteve të bëra prej të tre Rregullatorëve në mënyrë që dokumenti të reflektojë parimet bazë të përmendura në Final Joint Opinion. Versioni përfundimtar i metodologjisë së Tarifave është paraqitur në ERE për miratim në datën 14 tetor 2013.

Në përmbajtjen e kësaj metodologjie zbatohen kërkesat themelore të përcaktuara në Opinionin e Përbashkët në lidhje me tarifën; reflektimi në tarifë i

kostove efikase, që ato të jenë transparente dhe jo diskriminuuese; mekanizmi që tarifat të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren; marrja në konsideratë e nivelit të ndryshëm të riskut të investimit fillestar dhe zgjerimit të mëtejshëm; tarifa të njëjta për të njëjtin produkt pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përjashtuar nga aksesit i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përjashtuar.

2.3.4 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për Albagaz (OST/OSHT).

Me miratimin e ligjit Nr.102/2015 “Për Gazin Natyror” del si detyrë që nga ana e ministrisë të miratohet metodologjia e Gazit Natyror dhe më pas ERE të vazhdojë me “Metodologjinë e Tarifave të Gazit Natyror”. Aktualisht ne kemi filluar të punojmë për “Metodologjinë e Tarifave të Gazit” me kompaninë Becker Buttner Held (bbh), e cila është një kompani e specializuar në këtë fushë. Jemi në periudhën e shikimit të disa metodologjive dhe duke zgjedhur më të përshtatshëm që mund të përdorim për vendin tonë.

2.3.5 Kodi i Rrjetit të TAP AG dhe Kodi i Rrjetit të Albagaz.

Enti Rregullator i Energjisë është duke punuar së bashku me TAP AG, Baringa Partners një kompani Angleze e specializuar për problemet e gazit, si dhe përfaqësuesit e autoriteteve të Rregullatorit të Italisë dhe Greqisë, për përfundimin e Kodit të Rrjetit (Network Code).

2.3.6 Vëmëndjet kryesore që janë për sektorin e Gazit Natyror

Me miratimin e ligjit të ri të gazit Nr.102/2015, “Për Gazin Natyror” vëndi jonë ka implementuar “Paketën e Tretë të Energjisë” dhe është kështu një nga vendet e para së bashku me Serbinë dhe Malin e Zi që po aplikojnë këtë paketë.

Në këto kushte është i nevojshëm angazhimi jo vetëm i Entit Rregullator të Energjisë, por edhe institucioneve të tjera që kanë lidhje me këtë problem.

Vendi ynë ka ratifikuar Traktatin e Krijimit të Komunitetit të Energjisë dhe është palë kontraktuese e detyruar të ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky Traktat.

Njëkohësisht në fund të muajit Tetor 2015, ka hyrë në fuqi ligji i ri i “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i cili në nenin 35 pika 6 të tij, përcakton se: *“Licenca për transmetimin e gazit natyror, e dhënë para miratimit të këtij ligji, që lejon shoqërinë e gazit natyror*

(në këtë rast Albpetrol sh.a) të kryejë dhe të përmbushë detyrat që lidhen me transmetimin gazit natyror, konsiderohet si licencë e përkohshme, që autorizon ushtrimin e veprimtarisë së transmetimit, por në çdo rast nuk mund të zgjasë me vone se data 01 Qershor 2016.

Jemi duke punuar për përshtatjen e legjislacionit të Albagaz-it, në përputhje me Direktivën e gazit 2009/73/EC të Këshillit dhe Parlamentit Evropian datë 13 Korrik 2009, të Rregullores (EC) Nr. 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 13 Korrik 2009 dhe të ligjit të ri të gazit Nr. 102/2015.

Së bashku me Sekretariatit e Energjisë në Vjenë jemi duke përgatitur dy akte nënligjore të rëndësishme të cilët do na ndihmojnë të kryejmë çertifikimin e Albagaz-it, dhe konkretisht:

- “Kontratën për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhmërisë”. Kontrata midis Albagaz dhe Zyrtarit të Përputhmërisë është një kontratë tregtare, sipas të cilës Zyrtari i Përgjithshëm ofron shërbime sipas mandatit të vendosur nga Ligji 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe Programit të Përputhmërisë, ndërkohë që Albagaz siguron zbatimin e masave të nevojshme për shërbimet e Zyrtarit të Përgjithshëm që do të ofrohen dhe paguan për këto shërbime. Bazuar në praktikat më të mira të BE, rekomandohet që zyrtari i Përputhmërisë të përzgjidhet (qoftë person fizik apo juridik) dhe të mos punësohet nga Albagaz. Megjithatë, marrëdhëniet e punësimit midis Albagaz dhe Zyrtarit të Përputhmërisë nuk janë të ndalura, kështu që referencat për marrëdhëniet e mundëshme të punësimit jepen në këtë draft kontratë kur konsiderohen të nevojshme.
- “Mbi Miratimin e Udhëzimeve për Kriterin e Përcaktimit të Aksesit tek Hapësirat e Depozitimit të Gazit natyror”. Ky udhëzim bazohet në nenin 63, nenin 32 paragrafi 1 dhe nenin 16 paragrafi 6 i ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Qëllimi i këtij udhëzimi është të sigurojë një treg transparent dhe që funksionon mirë për depozitimin e Gazit Natyror në Shqipëri, po ashtu të ofrojë fleksibilitet dhe mjete për sigurinë e furnizimit për përdoruesit e rrjetit në mënyrë që të furnizojë konsumatorët e tyre në Shqipëri, gjë që do të kontribuojë në një treg të integruar dhe konkurues të gazit natyror në Komunitetin e Energjisë.

Këto dy amendime janë në përfundimin e miratimit të tyre dhe do të shërbejnë për plotësimin e kuadrit të legjislacionit sekondar të domosdoshëm për çertifikimin e Albagaz-it, si operator i transmetimit dhe shpërndarjes së Gazit Natyror. Kjo do të

shërbejë gjithashtu sepse pas certifikimit të Albagaz-it do të jepet licenca e aktivitetit të operatorit të transmetimit dhe shpërndarjes së Albagaz.

Të gjitha këto janë të nevojshme sepse:

- TAP-i tashmë ka filluar punimet e ndërtimit në territorin e vendit tonë. Brenda vitit 2019 ai do të ketë përfunduar ndërtimin e tij dhe do të jete i gatshëm për transportin e gazit drejt Italisë, por edhe për nevojat e vendit tonë. Është në të mirë të vendit tonë që OST-ja e re e gazit të bëhet funksionale menjëherë pasi duhet të futet në marrëdhënie kontraktuale me TAP-AG për punime ndihmëse.
- Këto marrëdhënie TAP-AG ndërkohë po i ndërton me vendet fqinje si Greqia dhe Italia.
- Jo më vonë se fillimi i operacioneve të TAP-it, do të bëhet një Testim i Tregut (MARKET TEST), për alokimin e kapaciteteve. Më pas do të ketë testime tregu çdo dy vjet sipas FJO të miratuar nga tre autoritetet e Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë.

2.3.7 Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare

Enti Rregullator i Energjisë ka një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me Energjinë Elektrike dhe Gazin Natyror.

ERE është aktiv në ECRB (Energy Community Regulatory Board), në ACER (Agency for the Cooperation of Energy Regulators), që të dy këto institucione janë pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vjenë. E-Contro, EnC pranë Energy Community në Vjenë. Jemi anëtar dhe bashkëpunojmë ngushtë me IGU (International Gas Union) ku marrim pjesë në të gjitha takimet që organizohen si për Gazin Natyror, Gazin Natyror të Lëngëzuar (LNG), Gazin Natyror të Kompresuar (CNP).

Në kuadër të bashkëpunimit shumë-palësh mes Enteve Rregullatore pjesëmarrëse të MEDREG (Shoqata e Rregullatorëve të Mesdheut) ERE është shumë aktive.

2.3.8 Domosdoshmëria e rishikimit nga Parlamenti për statusin dhe pavarësinë e ERE-es.

Për respektimin e direktivës së BE lidhur me një Ent Rregulator të Pavarur është e nevojshme dhe e domosdoshme miratimi nga Kuvendi i dy amendimeve, të cilat do të ndikonin në punën tonë në mënyrë cilësore dhe konkretisht:

- **Projekt-ligji “Për një shtesë në ligjin Nr. 152/2013, Për Nëpunësin Civil të Ndryshuar”**
- **Projekt-ligji “Për disa ndryshime në ligjin Nr.9584, datë 17.07.2006 “Për Pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe të Institucioneve të tjera të Pavarura, të krijuara me ligj”**Të dy këto amendime janë paraqitur nga një grup deputetësh të të gjithë krahëve politikë, që në muajin Prill të vitit 2015, janë diskutuar në Komisione Parlamentare, janë diskutuar në seancë Parlamentare, dhe mbetet vetëm për tu votuar në Parlament. Këtë e kërkojmë sepse:
 - Miratimi i këtyre dy amendimeve nga Kuvendi përmbush një nga kushtet kryesore të Implementimit të Paketës së Tretë të Energjisë, “Për një Pavarësi Funktionale dhe Financiare të Entit Regullator të Energjisë”, bazuar në Direktivën 2009/72/EC të Energjisë Elektrike, Neni 35 (4, 5) pika a,b dhe Direktiva 2009/73/EC të Gazit Natyror, neni 39 (4,5) pika (a,b), si dhe të ligjit “Për Sektorin e Energjisë”, “Per Sektorin e Energjisë” Nr. 43/2015, neni 11, pika 7-të e tij.
 - Enti Rregullator i Energjisë, është një Institucion i Pavarur, i cili nuk financohet nga buxheti i shtetit, por nga tarifat e rregullimit që merr nga kompanitë e rregulluara, kjo e bën atë më fleksibël në punën e tij, te veçantë në lidhje me institucionet e tjera të pavarura si dhe shumë specifik dhe me impakt të drejtpërdrejtë në ekonomi.
 - Mosmiratimi i këtyre amendimeve **ka penguar në miratimin e strukturës së këtij institucioni, ai vazhdon të funksionojë me strukturën e para 11 viteve, strukturë që i përkiste vetëm sistemit të energjisë elektrike duke mos patur asnjë shtesë për Gazin Natyror.** Në kushtet aktuale kemi shtimin në mënyrë intensive të problemeve të Gazit Natyror. Me projektin TAP dhe IAP, jemi vendosur në vështirësi të mëdha në realizimin e detyrave tona, të cilat kërkojnë një zgjidhje të shpejtë dhe profesionale. E kemi të domosdoshme ngritjen e Departamentit të Gazit, por që kemi pengesën kryesore, atë të miratimit të strukturës së këtij institucioni.
 - Mosmiratimi i këtyre dy amendimeve në këtë legjislaturë do të ishte një **pengesë e madhe dhe serioze në punën tonë, e cila sa vjen dhe shtohet me ritme të larta.**

PJESA III: Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë

3.1 Licencimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

3.1.1 Licencimet dhe Kërkesat e Trajtuara gjatë Vitit 2016.

Gjatë vitit 2016, ERE ka kryer një veprimtari të gjërë për licensimin e subjekteve në aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

Për aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në ERE, për vitin 2016 janë paraqitur 40 aplikime. Për 32 nga këto aplikime, Bordi i ERE-s ka vendosur licensimin e tyre, ndërsa 8 aplikime janë në proces dhe licensimi i tyre do të finalizohet gjatë vitit 2017 në përputhje me procedurat e ERE-s.

Edhe gjatë këtij viti, për të gjitha aplikimet e paraqitura, është respektuar me rigorozitet transparenca e parashikuar në procedurat për licensim, dhe miratimit të pajisjes me licencë të subjekteve aplikues, në zbatim të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe të “Rregullores për proçedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike“. Në përputhje me kuadrin ligjor të mësipërm janë zbatuar me korrektësi afatet e publikimit në median e shkruar të Vendimeve të Bordit të ERE-s për njohjen e të gjitha palëve të interesuara me këto Vendime. Gjithashtu çdo aplikim për licensim i është nënshtruar një analize të kujdesëshme të rregullshmërisë dhe plotësisht me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujrave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me aktivitetin që subjektet kanë kërkuar të licensohen.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten licensimet e miratuara nga Bordi i ERE-s sipas aktivitetëve të ndryshme gjatë viti 2016.

Licensimet e miratuara nga Bordi i ERE-s, sipas aktiviteteve të ndryshme gjatë 2016.

AKTIVITETI I LICENSUAR	Nr. I LICENSAVE TE MIRATUARA
Prodhim i energjisë elektrike	11
Tregtues i energjisë elektrike	11
Furnizues i energjisë elektrike	7
Modifikim i Licences ekzistuesë	1
Furnizim gazi natyror	1
Tregtim gazi natyror	1

3.1.2 Licensimet në Aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike.

Në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike janë licensuar 11 shoqëri private për prodhimin e energjisë elektrike nga 19 impjante hidro (Hec-e) me një fuqi totale të instaluar 317,491 MW, nga të cilët :

- 14 janë me kapacitet 0-5 Mw
- 1 është me kapacitet 5-10 MW
- 2 janë me kapacitet 10-20 MW
- 1 me kapacitet 73 MW
- 1 me kapacitet 182,5 MW

Në tabelën më poshtë paraqiten subjektet e licensuar, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike :

SUBJEKTI	OBJEKTI	FUQIA E INSTALUAR
“Përparim SK” sh.p.k	H/C “Shtika”	1,3 MW
“Dragobia Energy”sh.a	H/C “Çeremi” H/C “Dragobia”	8,6 MW 13,4 MW
“Ballenja Power Martanesh”sh.p.k	H/C “Ballenjë”	1,9 MW
“Hec Lashkiza”sh.p.k	H/C ”Lashkiza 1” H/C “Lashkiza 2”	4,4,076 MW 0,882 MW
“Liria Energji”sh.p.k	H/C ”Shpella poshtë 2”	2,3 MW

“Devoll Hydropower”sh.p.k	H/C ”Moglicë” H/C ”Banjë”	182,5 MW 73 MW
“Gavran Energy”sh.p.k	H/C “Gavran 1” H/C “Gavran ”	0,998 MW 1,215 MW
“Reka energy”sh.p.k	H/C “Zaje” H/C “Turaj” H/C “Xhaferaj-Mështekën” H/C “Novosej” H/C “Kollovoz”	0,22 MW 0,32 MW 3,68 MW 0,22 MW 1,5 MW
“Prell Energy” sh.p.k (Transferim)	H/C “Prellë”	14,970 MW
“Xhengo Energy” sh.p.k	H/C “Kasollet e Selcës”	4 MW
“Daab Energy Group”sh.p.k	H/C “Dobrenjë-Tomorricë”	2,4 MW

Nga Bordi i ERE-s është miratuar modifikimi i licensës së prodhimi të energjisë elektrike për një subjekt :

Është modifikuar licenca e prodhimit për subjektin “Balkan Green Energy” sh.p.k, duke hequr nga lista e 25 HEC-eve vendorë të kësaj license 3 Hec-e, Hec “Piqeras” me fuqi 0,2 MW, Hec “Lozhan” me fuqi 0,1 MW dhe Hec “Voskopojë” me fuqi 0,4 MW.

Tre subjekte te tjera janë në proces licensimi për prodhimin e energjisë elektrike nga 3 impjante hidrike (Hec-e), me fuqi të instaluar 18,147 MW dhe 1 TEC me fuqi të instaluar 2,85 MW :

Subjekti “Skatena Hec”sh.p.k për HEC “Skatenë” me fuqi 2,677 MW;

Subjekti “Albtek Energy”sh.p.k për TEC “Impianti i përpunimit të mbetjeve urbane Elbasan” me fuqi 2,85 MW;

Subjekti “MC Inerte Lumzi”sh.p.k për Hec “Tuç” me fuqi 4,47 MW;
Hec “Lumzi” me fuqi 11 MW;

Gjithashtu është në proces një kërkesë për modifikimin e liçensës së prodhimit, nga subjekti “Komp Energy” sh.p.k.

3.1.3 Licensimet në Aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike janë licensuar 11 subjekte. Në zbatim të nenit 5, pika 1, germa “e” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike“, e miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, të gjithë subjektet që kanë aplikuar për liçensë tregtimi mbas datës 29.06.2016, janë licensuar për një afat pesë vjeçar. Ndërsa subjektet që kanë aplikuar për liçensë tregtimi përpara kësaj date dhe kanë patur edhe liçensë prodhimi, në zbatim të Nenit 5, pika 1 germa “g” dhe pika 2, të rregullores së mëparëshme “Rregullore për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plote/të pjesëshëm dhe rinovimit të liçensave”, janë licensuar për një afat tridhjetë vjeçar.

Janë në proces licensimi për pajisjen me liçensë tregtimi tre subjekte të tjerë, ndërsa një subjekt është në proces për modifikimin e liçensës së tregtimit.

Të licensuarit në Aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike gjatë Vitit 2016 janë :

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
1	“Nishova Energy” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 7, datë 27.01.2016
2.	“Dragobia Energy” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 18, datë 16.02.2016
3.	“Përparimi SK” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 16, datë 16.02.2016
4.	“Ballenja Power Martanesh” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 39, datë 12.04.2016
5.	“Hec Lashkiza” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 42, datë 12.04.2016
6.	“Liria Energji” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 52, datë 29.04.2016
7.	“AE Distribution” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 62, datë 09.06.2016
8	“Nordic Invest Group” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 121, datë 11.07.2016
9	“Xhengo Energy” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 155, datë 06.10.2016
10	“Energy Market Albania” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 157, datë 06.10.2016
11	“DAAB Energy Group” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 163, datë 06.10.2016
12	“A-V Compas Power” sh.p.k	Tregtim	Në Proces
13	“MC Inerte Lumzi” sh.p.k	Tregtim	Në Proces
14	“Balkan Energy Trade” sh.p.k	Tregtim	Në Proces
15	“Komp Energy” sh.p.k	Tregtim (Modifikim)	Në Proces

3.1.4 Licensimet në Aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

Në këtë aktivitet janë licensuar 7 subjekte. Në zbatim të Nenit 5 Pika 1 gërma “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike”, këto subjekte janë licensuar me një afat 5 vjecar.

Subjektet e licensuar në Aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, gjatë Vitit 2016 janë :

Nr .	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TE BORDIT
1	“Albanian General Electricity” sh.a	Furnizim	Vendimi Nr. 11, datë 27.01.2016
2.	“Dragobia Energy” sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr. 19, datë 16.02.2016
3.	“Ballenja Power Martanesh ” sh.p.k	Furnzim	Vendimi Nr. 40, datë 12.04.2016
4.	“Liria Energy” sh.p.k	Furnzim	Vendimi Nr. 53, datë 29.04.2016
5	“Devoll Hydropower ” sh.a	Furnizim	Vendimi Nr. 81, datë 09.06.2016
6	“AE Distribution” sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr. 83, , datë 09.06.2016
7	“Xhengo Energy” sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr. 156. datë 06.10.2016

3.1.5 Licensimet në Sektorin e Gazit Natyror

Në sektorin e gazit natyror, gjatë vitit 2016 ka patur dy aplikime në aktivitetet e ndryshme të këtij sektori : një aplikim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror dhe një në aktivitetin e tregimit .

Për të dy aplikimet, Bordi i ERE-s , ka vendosur licensimin në aktivitetet përkatëse.

Subjektet e licensuar ne aktivitetet e Gazit natyror per vitin 2016			
Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	DATA E VENDIMIT TE BORDIT
1	“Phoenix Petroleum” sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr.8, datë 27.01.2016
2.	“Phoenix Petroleum” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr.44, datë 12.04.2016

Për të gjithë subjektet e licensuar nga ERE, mbahen dhe arkivohen regjistra të veçantë për secilin aktivitet, me të dhënat e nevojshme për subjektin dhe llojin e liçensës, të cilat pasqyrohen të përditesuara në Web-in e ERE-s dhe mund të konsultohen nga çdo palë e interesuar.

3.2 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

3.2.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike.

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 7, neni 20, gërma ç), d), f) dhe g), neni 22, neni 58, pika 9, neni 62, pika 4 si dhe neni 72, gërma dh); Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, neni 13; si dhe kushtet e licesave të lëshuara nga ERE, shërbimet e operatorëve të licensuar nga ERE janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

Monitorimet janë kryer bazuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.338, datë 19.03.2008, i ndryshuar; në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016, në Rregullat e Tregut, si dhe të rregullorëve përkatëse mbi bazën e të cilave veprojnë pjesëmarrësit e tregut.

Këto monitorime janë kryer bazuar në plane tematike paraprake dhe organizuar në mënyrë të tillë që të monitorohen në vazhdimësi rezultatet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike. Procesi i monitorimit është kryer duke ndjekur periodikisht hapat e mëposhtme.

- Mbledhja dhe përpunimi i rezultateve periodike (muajore) dhe informacioneve.
- Përpunimi i rezultateve dhe përcaktimi i vlerave të indikatorëve të performancës.
- Diskutimi i problematikave në mbledhjet periodike të Bordit të ERE.
- Identifikimi i çështjeve për monitorim në terren.
- Monitorim për zbatimin e rregulloreve
- Kryerja e monitorimeve në terren dhe analizimi i tyre.
- Propozimi i qëndrimit dhe rekomandimeve të ERE-s lidhur me konstatimet nga monitorimet

Në tabelën në vijim paraqiten të gjitha monitorimet tematike të kryera gjatë vitit 2016 nga ERE.

Monitorimet gjatë vitit 2016

<i>Urdhëri i Monitorimit</i>	<i>Objekti i Monitorimit</i>	<i>Kompania</i>
Urdhër Nr. 5, datë 10.02.16	Trajtimi dhe statusi i ankesave për periudhën Janar-Dhjetor 2015; Zbatimi i afateve dhe procedurave të ndjekura për ankesat e dërguara nga ERE, periudha Janar -Dhjetor 2015; Procedurat e ndjekura nga Qendra e Kujdesit ndaj Klientit, për trajtimin e ankesave të konsumatorëve; Zbatimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve të ERE-s, të dhënat në shkresën nr. 508, datë 14.07.2015 mbi "Konsumatorët e lidhur në TM për tarifën e shitjes me pakicë të energjisë elektrike"; Afatet dhe procedurat për trajtimin e kërkesave dhe ankesave për "Lidhjet e Reja" konform rregullores; Afatet dhe procedurat për pezullimin e kontratës së energjisë elektrike konform nenit 5 të "Kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë"; Zbatimi i afateve dhe procedurave për kërkesat për ndërprerjen dhe rilidhjen e energjisë elektrike, sipas nenit 11 të "Kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë"; Zbatimi i afateve dhe procedurave lidhur me lëshimin e faturës së korrigtuar dhe kompensimet përkatëse sipas nenit 12.5 të "Kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë"; Zbatimi i afateve dhe procedurave për faturime aforfe, sipas vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 146, datë 24.12.2013; Treguesit e cilësisë së shërbimit, konform rregullores "Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit dhe shitjes së energjisë elektrike" dhe nenit 15 të "Kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë".	OSHEE sh.a.
Urdhër Nr. 18, datë 14.04.16	Analizimi i rezultateve tekniko ekonomike për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016; Transaksionet e shkëmbimit të energjisë elektrike dhe procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për vitin 2015 dhe periudhën Janar - Mars 2016; Situata hidroenergjitike dhe menaxhimi i rezervave hidrike; Shërbimet ndihmëse; si dhe Analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për vitin 2015 dhe periudhën Janar - Mars 2016.	KESH sh.a.
Urdhër Nr. 19, datë 15.04.16	Analizimi i rezultateve tekniko ekonomike për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016; zbatimin e detyrimeve për lidhjet e reja në sistemin e transmetimit për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016; Disbalancat e energjisë elektrike, ankandet e kapaciteteve të energjisë elektrike dhe shërbimet ndihmëse për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016; Mbi ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për vitin 2015 dhe periudhën Janar - Mars 2016; si dhe analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016.	OST sh.a.
Urdhër Nr. 20, datë 15.04.2016	Analizimi i treguesve tekniko-ekonomik për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016; Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016; Procedurat e operimit të sistemit të faturimit; Ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016; Analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për vitin 2015 dhe për periudhën Janar - Mars 2016.	OSHEE sh.a.
Urdhër Nr. 67, datë 17.11.2016	Mbi ecurinë e punimeve të subjekteve të licensuara "Për ndërtim, instalim, shfrytëzim dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike"	"Biopower Green Energy" sh.p.k.; "ERS-08" sh.p.k.; "HERA" sh.p.k.; "E VENTO S.R.L. ALBANIA" sh.p.k.; "Albania Green Energy" sh.p.k.; "Alb Wind Energy" sh.p.k.
Urdhër Nr. 69, datë 24.11.2016	Respektimin e detyrimeve ligjore në zbatim të Kontratës së Konçesionit; Monitorimin e kushteve për licensimin dhe vënien në punë të "Impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane" në qytetin e Elbasanit, për prodhimin e energjisë elektrike.	"ALBTEK ENERGY" sh.p.k.
Urdhër Nr. 74, datë 27.12.2016	Analizimi i rezultateve tekniko ekonomike për periudhën Prill - Dhjetor 2016; Transaksionet e shkëmbimit të energjisë elektrike dhe procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për periudhën Prill - Dhjetor 2016; Situata hidroenergjitike dhe menaxhimi i rezervave hidrike; Shërbimet ndihmëse; si dhe Analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për periudhën Prill - Dhjetor 2016.	KESH sh.a.
Urdhër Nr. 75, datë 27.12.2016	Analizimi i rezultateve tekniko ekonomike për periudhën Prill - Dhjetor 2016; zbatimin e detyrimeve për lidhjet e reja në sistemin e transmetimit për periudhën Prill - Dhjetor 2016; Disbalancat e energjisë elektrike, ankandet e kapaciteteve të energjisë elektrike dhe shërbimet ndihmëse për periudhën Prill - Dhjetor 2016; Mbi ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për periudhën Prill - Dhjetor 2016; si dhe analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për periudhën Prill - Dhjetor 2016.	OST sh.a.
Urdhër Nr. 76, datë 27.12.2016	Analizimi i treguesve tekniko-ekonomik për periudhën Prill - Dhjetor 2016; Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për periudhën Prill - Dhjetor 2016; Procedurat e operimit të sistemit të faturimit; Ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për periudhën Prill - Dhjetor 2016; Analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow i kompanisë për periudhën Prill - Dhjetor 2016.	OSHEE sh.a.

Figure 48 Monitorime Tematike gjatë vitit 2016

3.2.2 Monitorimi i OSHEE sh.a

Gjatë vitit 2016 monitorimet tematike janë realizuar në zbatim të urdhërave të Kryetarit të ERE-s, ndërsa monitorimet periodike janë kryer në zbatim të planit vjetor.

Nga monitorimi i kryer lidhur me realizimin e procedurës së importit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes u konstatua se nuk ka pasur shkelje të rregullave në fuqi. Procedurat e prokurimit për energjinë elektrike janë kryer në përputhje me “Rregullat dhe Procedurat Standarde të Prokurimit të Energjisë Elektrike nga OSHEE sh.a.”, miratuar me Vendimin Nr. 42, datë 25.05.2009 nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

Parashikimi i parë i investimeve për vitin 2016, është miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i OSHEE sh.a. me Vendimin Nr 77, datë 21.12.2015. Vlera e investimeve sipas këtij parashikimi ka qënë 11,475,003,634 Lekë, nga të cilat 7,721,003,634 lekë janë investime me fondet e OSHEE sh.a. dhe pjesa tjetër me vlerë prej 3,754,000,000 lekë janë financim i Bankës Botërore.

Gjate periudhës Janar - Dhjetor 2016 plani i investimeve është rishikuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës, për shkak të prioriteteve të kompanisë dhe shtesës së të ardhurave.

Me anë të Vendimit Nr.5, datë 17.03.2016 miratohen ndryshimet në Planin fillestar të mësipërm me vlerë 9,004,516,850 Lekë (Financimi i kompanisë).

Me anë të Vendimit Nr.21, datë 10.05.2016 miratohet në vlerën 9,178,725,337 lekë.

Me anë të Vendimit Nr.28, datë 07.07.2016 miratohet vlerën 8,680,178,026 Lekë.

Me Vendimin Nr.43, datë 10.10.2016 miratohet në vlerën 12,213,256,345 Lekë.

Si pikë referimi për analizimin e realizimit të investimeve të vitit 2016 është marrë Plani i miratuar në Tetor 2016.

Në muajin shkurt 2017 nga ana e OSHEE sh.a u dërguan të dhëna operative lidhur me realizimin e fondeve për investime gjatë vitit 2016 të detajuara sipas investimeve dhe grup investimeve. Më poshtë paraqitet një tabelë përmbledhëse me rezultatet e investimeve sipas grupimeve.

PLAN / REALIZIMI I INVESTIMEVE NE OSHEE sha PËR VITIN 2016 (leke)				
Nr.	Emertimi i Grup-Investimeve	Planifikuar 2016	Realizuar 2016	% Realizimit
I	Ndertim/rikonstruksion elektrik per Nenstacionet	1,104,865,657	881,152,715	80
II	Ndertim/Rikonstruksion linjash te TL	1,052,250,242	554,059,537	53
III	Rikonstruksion ndertimor per N/stacione	30,000,000	-	0
IV	Blerje Paisje makineri per N/Stacione dhe likujdim avarish	505,000,000	191,700,000	38
V	Ndertim Rrjeti TM	20,000,000	-	0
VI	Ndertim/Rikonstruksion Rrjeti TM /TU	4,305,780,884	3,464,011,417	80
VII	Ndertim/Rikonstruksion kabinash elektrike	355,886,536	100,059,816	28
VIII	INVESTIMET PRIORITARE (Rrjet TU - ABC lines)	1,773,397,698	858,524,559	48
IX	Teknologji Monitorimi	562,059,217	208,510,000	37
X	INVESTIME NE MATJE	2,005,100,000	875,799,771	44
XI	Emergjencia	133,341,613	145,061,898	109
XII	Oponenc, Supervizion, Kolaudim	60,000,000	-	0
XIII	Investime ne Sisteme Informatike dhe Siguria ne Pune	10,000,000	-	0
XIV	Projektme N/Stacionesh	-	-	0
XV	Vlera 10% qe do te paguhet nga OSHEE per investimet Bankes Boterore	70,000,000	-	0
XVI	Studime me te trete per marrjen e lejeve te ndertimit	5,000,000	4,164,243	83
XVII	Kosto lokale per investimet e Bankes Boterore	80,574,500	-	0
XVIII	Konsulenca Teknike	140,000,000	-	0
XIX	Ndertim dhe Rikonstruksion Objekti Zyra Qendrorete OSHEE	541,666,667	150,730,966	28
XX	Blerje Automjetesh	-	49,708,500	
XXI	Tenologji Informacioni	648,680,000	634,173,094	98
	TOTALI	13,403,603,013	8,117,656,517	61

Në tabelë janë përfshirë vlerat e grup-investimeve të viteve 2015, 2016 të cilat janë planifikuar nga OSHEE sh.a për tu trajtuar gjatë vitit 2016.

Nga vlerat në përqindje të realizimeve kuptohet se duhet të punohet nga OSHEE sh.a më shumë në drejtim të planifikimit të saktë dhe arritjes së targeteve të planifikuara në realizim. Mbetet problematikë zbatimi i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve ashtu siç pershkruhen në Vendimin Nr. 62, datë 15.09.2009.

3.2.3 Monitorimi i OST sh.a.

Gjatë vitit 2016, ERE ka kryer monitorime për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kushtet e licenses dhe Rregullat e Tregut dhe akte të tjera ligjore në fuqi. Realizimi i investimeve ka qenë një nga objektet e monitorimit.

Gjatë vitit 2016 OST sh.a. realizoi investime të rëndësishme për zgjerimin, fuqizimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit të energjise elektrike. Investimet e programuara u fokusuan kryesisht në kryerjen e punimeve dhe blerjen e materialeve

të cilat kanë një ndikim të drejtepërdrejtë në rritjen e sigurisë së operimit të Sistemit të Trasmetimit të Energjisë Elektrike.

Investimet e përcaktuara për tu realizuar nga OST sh.a. për vitin 2016 janë miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i OST sh.a. si dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Investimet pasqyrohen në total në 36 zëra, me një vlerë totale prej 2,428,274,830 Lekë.

- Janë realizuar plotësisht 7 zëra me vlerë totale të programuar 486,512,062 Lekë.
- Në përqindje rezulton se 19.4% e totalit të numrit të zërave të programuar ose 20% e shumës së programuar janë realizuar plotësisht.
- Janë realizuar pjesërisht ose ka nisur realizimi i 24 zërave me vlerë totale të programuar 1,850,062,768 Lekë. Në përqindje rezulton se 66.7% e totalit të numrit të zërave të programuar ose 76% e shumës së programuar janë në proces realizimi.
- Nuk janë realizuar 5 zëra investimesh me vlerë totale 91,700,000 Lekë. Në përqindje rezulton se 13.9 % e totalit të numrit të zërave të programuar ose 3.9% e shumës së programuar nuk janë realizuar.

SITUATA E REALIZIMIT TE INVESTIMEVE TE OST sha ME FONDET E VETA PER VITIN 2016					
Nr.	Investimet gjate vitit 2016	Programi 2016	Realizimi deri ne 31.12.2016	Realizimi ne %	Statusi i investimit
1	Fuqizimi I N/Stacionit 110/154/ kV Bistrice	260,100,336	224,997,643	87%	Ne proces
2	Qendra Emergjente e Kontrollit	192,276,265		0%	Ne proces
3	Rehabilitimi I impiantit 110kV te nenstacionit Lac 1	189,000,000	37,660,295	20%	Ne proces
4	Blerje Set shtyllash per raste emergjente	187,402,400	182,343,006	97%	Ne proces
5	Furnizimi, instalimi dhe konfigurimi I 10(dhjetë) Sistemeve te monitorimit online te izolatoreve dhe shkarkimeve pjesore ne TR e fuqise se nenstacioneve	177,760,000	177,760,000	100%	Perfunduar
6	Demontimi dhe ndertimi i Linjes se Re 110 kV Skuraj-Lac 1	159,027,905	31,805,581	20%	Ne proces
7	Rehabilitimi I impiantit 110kV te nenstacionit Selenice	146,151,769	29,230,354	20%	Ne proces
8	Rehabilitimi i impiantit 110 kV te N/Stacionit Memaliaj,	135,000,000	26,805,735	20%	Ne proces
9	Blerje pajisje kembimi dhe materiale per mirembajtjen e nenstacioneve	117,434,700	32,636,700	28%	Ne proces
10	Monitorimi I linjave te transmetimit me percjelles tokezimi optik	87,900,000	87,900,000	100%	Perfunduar
11	Blerje materiale, vegla pune, pajisje dhe aparate matjeje e kontrolli per mirembajtjen e linjave te transmetimit per vitin 2016	70,900,000	70,900,000	100%	Perfunduar
12	Pajisja e qendres se kontrollit me Video-Wall	67,702,000	67,702,000	100%	Perfunduar
13	Punimet primare dhe sekondare ne nenstacionin 220 kV Fierze, demontimi i celsave te demtuar 1C2 dhe 2C2, furnizimi dhe vendosja e dy celsave te rinj 245 kV me gas SF6, integrimi i plote i tyre me sistemin, si dhe furnizimi i pjeseve reserve per celsat 245 kV 3C2 dhe 4C2	67,185,000		0%	Ne proces
14	Blerje aparate dhe pajisje per kontrollin dhe mirembajtjen e pajisjeve te Nenstacioneve	66,690,000	66,690,000	100%	Perfunduar
15	Rikonstruksioni I segmenteve te linjave 110kV Selenice - Drenove dhe Selenice - Fier	61,498,515	59,054,915	96%	Ne proces
16	Blerje pjese kembimi dhe materiale per mirembajtjen e pajisjeve sekondare te nenstacioneve,	50,000,000		0%	Ne proces
17	Instalimi I linjes kablore 110 kV Selite - Yzberisht	50,000,000		0%	Nuk eshte krver
18	Blerje autobus me kapacitete 45 vende	45,400,000		0%	Ne proces
19	Blerje Licensa per Programet e Microsoft (per 3 vjet)	37,377,428	37,377,428	100%	Ne proces
20	Blerje dhe instalimi I 2(dy) seteve te monitorimit te izolatoreve kalimtare te Autotransformatoreve AT-2 100 MVA 220 MVA 220/110/20 kV, ne nenstacionin Rrashbull dhe AT-2 100 MVA 220/110/20 kV ne N/St. Elbasan	35,500,000		0%	Ne proces
21	Blerje pjesë këmbimi dhe materiale për mirëmbajtjen e pajisjeve sekondare të N/st (aparate dhe pajisje për kontrollin dhe mirëmbajtjen e sistemit të mbrojtjes rele	30,000,000		0%	Ne proces
22	Punime civile ne nenstacionin Fier-Babice	25,366,739		0%	Ne proces
23	Ndertim magazine me kontruksion metalik ne Nenstacionin Elbasan1	21,000,000		0%	Ne proces
24	Krijimi I nje dhome Backup I TE PER Serverat e IT dhe permiresimi I dhomave aktuale te serverave IT,TLC, SCADA,	20,000,000		0%	Ne proces
25	Krijimi I salles se konferencave dhe pajisja e salles kryesore te mblledhjeve me sistem nderlidhje	18,330,167		0%	Ne proces
26	Ndertim i zvrave te NJO Burrel.	17,029,581		0%	Ne proces
27	Perfshirja e Centralit te Komanit nen kontrollin LFC	15,000,000		0%	Ne proces
28	Blerja e 2 (dy) licensave te reja (çelesa USB) te programit PSS/E dhe trajnimi i specialisteve per perdorimin e ketij softi.	12,000,000		0%	Nuk eshte kryer
29	Blerje Autovetura	11,760,000	11,760,000	100%	Perfunduar
30	Upgrade i workstationave te QDS dhe sistemeve te kontrollit te njesive	10,700,000		0%	Nuk eshte krver
31	Blerje pjesë këmbimi për impiantit 10 kV në N/st Burrel	10,000,000		0%	Ne proces
32	Blerje e pajisjeve IT dhe MFP per Zvrat e reja te OST	10,000,000		0%	Nuk eshte krver
33	Ngritje e rrjetit kompjuterik sipas standardeve te IT per Niesite Operative te OST	9,000,000		0%	Nuk eshte krver
34	Rikonstruksioni I linjes 110 kV Kalimash-Tunel	5,981,963		0%	Ne proces
35	Blerje dhe instalimi i tre analizatoreve te protokollit mbi lidhjen SCADA	4,000,000		0%	Ne proces
36	Ndertim muri mbrojtjes,shtylla TL 110 kV nr.7.Ulez-Burrel	3,800,062	3,800,062	100%	Perfunduar
		2,428,274,830	1,148,693,719	47%	

Investime të mbartura nga vitet 2014 dhe 2015.

Investime te mbartura per kontrata te lidhura ne vitin 2015					
37	Blerje dhe instalim I dy autotransformatorve ne Komsj Burrel	263,106,115	263,106,115	100%	Perfunduar
38	Ndertimi i linjes se re 110 kV me 2 qarqe Rrashbull-Golem-Kavaje	197,041,492	197,041,492	100%	Perfunduar
39	Furnizimi & Instalim I platformes elektronike per menaxhimin e tregut dhe operimin e sistemit	190,596,057	133,417,240	70%	Ne proces
40	Zgjerimi i Rrejtit te Telekomunikacionit	82,000,000	82,000,000	100%	Perfunduar
41	Ndertimi I Linjes 110 kV me dy qarqe Ulez-Shkopet-Skuraj	138,175,799	60,797,352	44%	Ne proces
42	Monitorimi i fuqise aktive ne Linjat e interkonjeksionit	49,450,000	49,450,000	100%	Perfunduar
43	Ndertim magazine ne n/Stacionin Rrashbull	15,865,285	15,865,285	100%	Perfunduar
44	Blerje automjeti tip fuoristrade per nevojat e NJOB	1,986,000	1,986,000	100%	Perfunduar
45	Rikonstruksion Magazine NJMT	1,551,050	1,551,050	100%	Perfunduar
46	Zhvendosje e shtylles Nr.17,te linjes 110 Kv Vau I Dejes-Shkodra 1	1,520,995	1,520,995	100%	Perfunduar
		941,292,793	806,735,529	86%	
Investime te mbartura per kontrata te lidhura ne vitin 2014					
47	Ndertim-montim linje 110 kV Peshkopi - Lapaj se bashku me dy daljet perkatese 110 kV te N/st Peshkopi dhe N/st. Lapaj	55,260,551	55,260,551	100%	Perfunduar

Të dhënat e mësipërme janë operative dhe do të saktësohen me mbylljen e Bilancit të Kompanisë.

Të dhëna mbi disa nga Investimet e Rëndësishme të Vitit 2016

Monitorimi në kohë reale i izolatoreve kalimtarë (BMT) të Autotransformatorëve në Nënstacionet e OST sh.a

OST sh.a. nëpërmjet investimeve të bëra me fondet e veta, gjatë vitit 2016 ka realizuar monitorimin në kohë- reale të gazrave dhe lagështisë së vajit në disa (kryesisht të nivelit 400 kV) nga autotransformatorët e instaluar në N/st e saj.

Monitorimi i prezencës së këtyre gazërave siguron avantazhin e madh të marrjes në kohë të indikacioneve të nevojshme.

Është realizuar me fondet e veta nga OST sh.a. blerja dhe instalimi i 10 seteve gjithsej për monitorimin e izolatoreve kalimtarë. Konkretisht është realizuar monitorimi online i autotransformatorëve 400/220 kV në nënstationet Tirana2, Elbasan2 dhe 400/110 kV në nënstation Zemplak (gjashtë sete). Gjithashtu nisur nga rëndësia që kanë është planifikuar dhe monitorimi i autotransformatorëve 220/110 kV në nënstationin Tirana2 dhe Rrashbull (katër sete).

Ky investim është realizuar 100% deri në 31.12.2016, me vlerë 177,760,000 Lekë.

Sistemi i monitorimit të linjave me fibra optike të OST sh.a.

Për të bërë të mundur monitorimin në kohë reale të rrjetit me fibra optike të OST sh.a., në kuadër të investimeve të OST për vitin 2016, ka realizuar instalimin e sistemit: ONMS - Optical Network Management System.

Avantazhet e sistemit ONMS janë të shumta, si psh. Monitorim në kohë reale i gjendjes dhe performancës së linjave optike, gjenerim i raporteve mbi gjendjen dhe defektet, parandalimi i avarive të mundshme, reduktim i kostove duke qenë se do të mund të parandalohen avari dhe dëme të mundshme të cilat rriten në rast të mos ndërhyrjeve në kohë, mirëmbajtje dhe kontroll i aseteve në linjat me fibra optike, etj.

Ky investim është realizuar 100% deri në 31.12.2016, me vlerë 95,300,000 Lekë.

Pajisja e Qendrës Kombëtare të Kontrollit me Video Wall

Bazuar në standartet dhe në kërkesat nga ENTSO-E, OST sh.a. aktualisht ka të implementuar sistemin e kontroll monitorimit SCADA (Supervisory Control and Data Acquisition). Për të siguruar operimin e sistemit sipas standarteve të ENTSO-E, OST ka realizuar pajisjen e Qendrës Kombëtare të Kontrollit me Video Wall.

Ky investim me vlerë 67, 702, 000 Lekë është realizuar 100% deri në 31.12.2016.

Furnizimi dhe vendosja e dy çelsave 220 kV (çelsat 1C2 dhe 2C2) në nënstation Fierzë

Eksperiencia e viteve të fundit ka nxjerrë në dukje faktin që gjatë operimit (gjatë komutimeve) çelsat kanë shfaqur problem lidhur me kalimin e mekanizmit të tyre në gjendje të ndërmjetme, problemi bëhet edhe më i mprehtë në rastin e nënstationit Fierzë, specifikisht për çelsat 1C2 dhe 2C2.

Zëvendësimi i këtyre çelsave me dy çelsa të rinj ndikon në rritjen e sigurisë së operimit të Sistemit elektroenergjitik për shkak të rëndësisë që ka Nënstationi i Fierzës.

Ky investim është parashikuar me vlerë 67,185,000 Lekë dhe është në proces realizimi.

Rikonstruksioni i segmentit të linjës 110 kV Selenicë – Drenovë dhe segmentit të linjës 110 kV Selenicë – Fier

Referuar gjendjes shumë të amortizuar të shtyllave prej betoni të linjave 220 dhe 110 kV të rajonit të Fierit të cilat kanë shkaktuar probleme lidhur me sigurinë e operimit (qendrueshmërinë e shtyllave) të linjave të tensionit të lartë, në këtë rajon për shkak të erozionit të shkaktuar nga ujrat e lumit Vjosë, ishte e domosdoshme ndërhyrja për rehabilitimin e segmenteve që kërcënohen nga erozioni i shpejtë.

Bazuar sa më sipër si për linjën 110 kV Selenicë –Drenove ashtu edhe për linjën 110 kV Selenicë – Fier ishte e nevojshme rikonstruksioni i këtyre dy linjave.

Ky investim është parashikuar me vlerë 59,054,915 Lekë dhe është në proces realizimi deri në datën 31.12.2016; është realizuar 96% e investimit.

Fuqizimi i N/ST 154/110 kV Bistricë

Investimet e bëra, në linjat e reja 110 kV Babicë –Sarandë dhe mbyllja e “unazës” 110 kV Përmet - Ersekë kanë fuqizuar ndjeshem aftësinë transmetuese të kësaj linje të interkonjeksionit 154 kV Bistricë – Myrtos. Në këto kushte është e pamjaftueshme fuqia 40 MVA e autotransformatorit 154/110 kV.

Zëvendësimi i autotransformatorit, rritja e fuqisë së tij në 80 MVA dhe përmirësimet e ndjeshme në skemën 110 kV të rajonit të jugut, kanë sjellë avantazh në krijimin e kushteve që kjo linjë interkonjeksioni të punojë sinkron me pjesën tjetër të sistemit.

Ky investim është parashikuar me vlerë 117,434,700 Leke dhe është në proces realizimi.

Blerje pjesë këmbimi dhe materiale për mirëmbajtjen e linjave të transmetimit.

Me qëllim mirëmbajtjen e linjave të transmetimit, (kryerjen e përvitshme të remonteve) OST sh.a. ka realizuar blerjen e materialeve perkatëse të nevojshme për një operim të sigurtë të elementeve të sistemit të transmetimit.

Ky investim është realizuar me vlerë 70,900,000 Leke.

Blerje pjesë këmbimi dhe pajisje per mirëmbajtjen e N/st

Me qëllim mirëmbajtjen dhe kryerjen e remonteve të përvitëshme në elementet e nënstacioneve të cilat zotërohen dhe operohen nga OST sh.a., është duke u realizuar blerja e materialeve përkatëse.

Ky investim është parashikuar me vlerë 224,997,643 Lekë dhe është në proces realizimi deri në datën 31.12.2016; është realizuar 87 % e investimit.

Blerje pjesë këmbimi dhe materiale për mirëmbajtjen e paisjeve sekondare të N/st.

Nisur nga gjendja tejet e amortizuar dhe e pa mirëmbajtur e pajisjeve të mbrojtjeve të linjave si dhe të seksionuesve të zbarave 110 kV të cilat, në pjesën më të madhe të tyre janë jashtë pune dhe nuk komandohen nga sallat e komandës gjatë operimit të rrjetit, shpesh herë stakohen (rrëzohen) unaza të tëra 110 kV për shkak të një defekti në njërin nga linjat 110 kV, kjo bën që stakimet të mos jenë selektive duke ndërprerë furnizimin e rajoneve të tëra dhe duke bërë të vështirë selektimin e segmentit të linjës së dëmtuar.

Për këtë arsye është duke u realizuar blerja e pjesëve të këmbimit për mirëmbajtjen e pajisjeve sekondare të nënstacioneve.

Ky investim është parashikuar me vlerë 50,000,000 Lekë dhe është në proces realizimi.

Rehabilitimi i linjës 110 kV Kalimash-Tunel

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka objekti që furnizon kjo linjë si dhe duke rivlerësuar kushtet atmosferike për të rritur sigurinë e furnizimit është duke u realizuar ndërhyrje në këtë segment duke shtuar një shtyllë ndërmjet kampatave 2-3 dhe ndërrimin e përcjellësit për segmentin e disa kampatave me një përcjellës me qendrueshmëri më të madhe mekanike.

Ky investim është parashikuar me vlerë 5,981,963 Lekë dhe është në proces realizimi.

Krijimi i sallës së konferencave dhe pajisja e sallës kryesore të mbledhjeve me sistem video-konferencë

Duke qenë se sallat ekzistuese të mbledhjeve janë të përshtatura dhe me kapacitet për zhvillimin e mbledhjeve për jo më shumë se 15 persona, bëhet e nevojshme krijimi i një ambjenti që bën të mundur zhvillimin e konferencave dhe prezantimeve për një kapacitet pjesëmarrësish prej 50 personash.

Ky investim është parashikuar me vlerë 18,330,167 Lekë dhe është në proces realizimi.

Implementimi i rregullimit fuqi-frekuencë nëpërmjet protokollit 104 për HEC Koman

Për zgjerimin e protokollit 104 do të jetë e nevojshme të ndërhyhet në sistemin SCADA të OST sh.a. si dhe në pajisjen ndërmjet sistemit SCADA dhe centralit të Komanit (RTU) për të mundësuar përfshirjen e Centralit të Komanit në kontrollin e LFC.

Ky investim është parashikuar me vlerë 12,000,000 Lekë dhe nuk është kryer.

Krijimi i një dhome Backup Site për Serverat e IT dhe përmirësimi i Dhomave aktuale te serverave IT, TLC, SCADA

Ky investim është i rëndësishëm pasi Sistemet Informatike të OST sh.a. janë të një rëndësie të veçantë për menaxhimin e sistemeve të ndryshme jetësore që përbëjnë objektin kryesor të veprimtarisë së shoqërisë.

Këto sisteme janë të vendosur në tre dhoma Server-ash në zyrat e Administratës. Këto dhoma teknologjike janë të pajisur me sisteme të cilat garantojnë vazhdueshmërinë e punës së pajisjeve Informatike si Kondicionim, UPS (qëndror për ndërtesën) si dhe shuarës zjarri (bombola me përdorim manual).

Ky investim është parashikuar me vlerë 20,000,000 Lekë dhe është në proces realizimi.

Monitorimi në kohë reale i izolatorëve kalimtarë dhe shkarkimeve parciale në AT-2 Rrashbull dhe AT-2 Elbasan2

Këto sisteme monitorimi bëjnë të mundur monitorimin online të izolatoreve kalimtare dhe shkarkimeve parciale të transformatorëve duke dhënë në kohë reale parametra shumë të rëndësishëm.

OST sh.a. ka vlerësuar shtimin e dy sistemeve të monitorimit online të izolatorëve dhe shkarkimeve pjesore në TR e fuqisë, dhe konkretisht për AT-2 100 MVA 220/110/20 kV në N/St Rrazhbull si dhe AT-2 120 MVA 220/110/35 kV në N/St Elbasan.

Ky investim është parashikuar me vlerë 35,500,000 Lekë dhe është në proces realizimi.

Punime civile në nënstacionin Babicë dhe Fier

Nisur nga shqetësimet e krijuara me rrëshqitjen e dheut për shkak të rreshjeve në territorin e N/St 220/110/35 kV Babicë, të cilat kanë sjellë bllokimin e rrugëve brenda nënstacionit dhe rrezikojnë shembjen e murit rrethues është e nevojshme të kryhen punime civile në territorin e këtij nënstacioni të cilat do të shmangnin shqetësimet lidhur me këtë problem.

OST sh.a e vlerëson të nevojshme të kryhen punime civile për sistemimin e këtij sheshi si dhe një segmenti rruge në hyrje të kësaj njesie operative.

Ky investim është parashikuar me vlerë 25,366,739 Lekë dhe është në proces realizimi.

Alokimi i kapaciteteve ne interkonjeksione

Për alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, gjatë vitit 2016 janë ndjekur procedurat sipas rregullave të miratuara nga ERE me Vendim Nr. 140 datë 22.11.2013 “Rregullore mbi alokimin e kapacitetit ne interkonjeksione” për kufirin Shqipëri - Kosovë dhe “Rregullores të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO)” versioni 1.3, miratuar me Vendimin Nr. 135, datë 13.11.2015 për kufinj të Shqipëri-Mal i Zi dhe Shqipëri-Greqi.

Në përputhje me vendimet e ERE-s, janë zhvilluar ankandet Vjetor, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2016 për kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë si dhe ankandet Mujore dhe Ditore për kufirin me Malin e Zi, Kosovën dhe Greqinë.

Në Figurën 49 janë përmbledhur të dhënat e ankandit Mujor, për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2016, organizuar nga OST sh.a (Per kufirin Shqipëri – Kosovë):

OST	Interkonjeksioni Shqipëri - Kosovë (AL - RS) _ Alokim Mujor _ 2016												
	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Nr subjekteve pjesmarrese	nr	7	6	7	9	7	8	5	9	6	7	5	9
Nr Ofertave te pjesmarresve	nr	53	50	55	173	106	70	36	66	72	97	47	61
Cmimi ankandit Euro / MWh	Eksp Imp	0.01 3.03	0.02 0.51	0.19 0.03	0.19 0.15	0.12 0.16	0.15 0.25	0.01 0.13	0.05 1.25	0.05 0.38	0.08 1.09	0.20 0.08	0.59 0.06

Figure 49 Ankandi Mujor, për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor te vitit 2016 i nterkonjeksionit Shqipëri – Kosovë.

Në Figurën 50 janë përmbledhur të dhënat e Ankandit Vjetor, për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2016, të organizuar, për llogari të OST sh.a., nga zyra rajonale SEE CAO, për interkonjeksionin me Malin e Zi dhe me Greqinë:

SEE CAO	Ankand Vjetor (1 Janar -31 Dhjetor) 2016									
	Kufiri	AL-ME		AL-RS		AL-GR		TOTAL OST		
	Drejtimi	imp	Exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp + exp
nr subjekteve pjesmarrese	Nr	12	11	-	-	14	15	26	26	52
Nr Ofertave te pjesmarresve	Nr	83	42	-	-	85	85	168	127	295
Cmimi ankandit (mesatar për OST)	Euro/MWh	2.07	0.07	-	-	0.19	7.52	<u>1.13</u>	<u>3.80</u>	<u>2.46</u>

Figure 50 Ankandet Vjetore, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2016.

Në Figurën 51 janë përmbledhur të dhënat e Ankandit Mujor, të organizuar për llogari të OST sh.a., nga zyra rajonale SEE CAO, për interkonjeksionin me Malin e Zi:

SEE CAO	Interkonjeksioni Shqiperi - Mali I Zi (AL - ME) _ Ankandi Mujor _ 2016												
	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
nr subjekteve pjesmarrese	nr	10	11	12	12	11	10	11	12	13	10	11	14
Nr Ofertave te pjesmarresve	nr	44	52	39	46	35	41	37	42	48	37	39	63
Cmimi ankandit Euro / MWh	Exp Imp	0.01 1.73	0.03 0.68	0.16 0.15	0.18 0.17	0.06 0.15	0.05 0.11	0.06 0.17	0.03 1.11	0.04 0.69	0.03 0.67	0.12 0.33	0.75 0.13

Figure 51 Ankandi mujor, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2016.

Në Figurën 52 janë përmbledhur të dhënat e Ankandit Mujor, të organizuar për llogari të OST sh.a., nga zyra rajonale SEE CAO, për interkonjeksionin me Greqinë:

SEE CAO	Interkonjeksioni Shqiperi - Greqi (AL - GR) _ Ankand Mujor _ 2016												
	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
nr subjekteve pjesmarrese	nr	14	14	14	15	13	13	14	14	13	12	14	16
Nr Ofertave te pjesmarresve	nr	55	57	68	67	53	55	62	51	58	53	53	58
Cmimi ankandit Euro / MWh	Exp Imp	7.37 0.08	4.21 0.12	11.83 0.04	11.11 0.03	7.67 0.01	6.15 0.00	5.61 0.09	4.05 0.02	3.37 0.03	2.61 0.03	2.82 0.12	2.57 0.75

Figure 52 Ankandi mujor, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2016.

- Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar në perputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, në rregulloret apo vendimet perkatëse të ERE-s.
- Çmimi minimal i ofertave të paraqitura është 0.01 Euro/MWh (sa lejojnë rregullat perkatëse të alokimit), çmimi minimal i ankandit ka rezultuar 0.00 Euro/MWh (kur nuk rezulton konxhestion në ankand).
- Vlen të theksojmë në këtë kontekst se nuk ka pasur asnjë ankimim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.
- Duke vlerësuar se implementimi i Tregut të energjisë është edhe një proces bashkëpunimi dhe i vlerësimit të ndërsjelltë ndërmjet OT dhe Pjesëmarrësve të Tregut, sipas rolit perkatës të tyre në tregun e energjisë, OT vijon kontaktet, takimet dhe konsultimet e herë pas herëshme me Pjesëmarrësit e Tregut.
- Në përputhje me vendimin Nr. 61, datë 07.07.2014 të Bordit të ERE-s, janë hedhur nga OT në ankand ditor kapacitetet e pa alokuara në ankandin vjetor, kapaciteti i pa alokuara në ankandin mujor të rradhës si edhe kapacitetet “e lira”, të cilat nuk janë nominuar në (D-2) nga palët e tregut.

- Vlera totale e ankandëve të ATC të alokuara në ankandet Ditore nga SEE CAO, për kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë, përfshirë zbatimin e principit “use it – or sell it” nga pjesëmarrësit e tregut, është -19’330 Euro.


Disbalancat

Në zbatim të Rregullave të Tregut për sa i përket trajtimit të çështjes së tregut balancues, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjeve i OST-së, janë bërë llogaritjet e disbalancave për secilin pjesëmarrës tregu të cilët janë përgjegjës për disbalancimin, në bazë orare. Çdo 10 ditë janë informuar nga OST sh.a Pjesëmarrësit e Tregut për disbalancat e kryera në mënyrë që të planifikojnë kompensimet përkatëse. Janë vlerësuar disbalancat e palëve në bazë mujore, të cilat më pas u janë faturuar pjesëmarrësve të tregut.

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje në total e volumeve të devijimeve brenda intervalit $\pm 1\%$ të pjesëmarrësve të tregut, për periudhën Janar – Qershor 2016. Disbalancat në këto kufi nuk penalizohen në vlera monetare, por kompensohen në energji nga pjesëmarrësit e tregut.



Penalizimet për devijimet gjatë vitit 2016 që kanë shkaktuar Pjesëmarrësit e Tregut të cilët janë përgjegjës për disbalancimin, jashtë intervalit në MWh, përlllogariten dhe faturohen sipas Rregullave të Tregut të miratuara me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s.

DISBALANCAT			
VITI 2016		DIS POZ	DIS NEG
		MWh	MWh
		Janar	100
Shkurt	109	101	
Mars	157	186	
Prill	256	149	
Maj	182	95	
Qershor	107	113	
SHUMA		910	695



DISBALANCAT			
VITI 2016		DIS NEGATIVE	DIS POZITIVE
		mbi 1%	mbi 1%
		MWh	MWh
Janar		1,400	2,573
Shkurt		404	2,701
Mars		306	1,545
Prill		391	447
Maj		752	1,580
Qershor		159	837
SHUMA		3,411	9,684

DISBALANCAT			
VITI 2016		DIS NEGATIVE	DIS POZITIVE
		MWh	MWh
		Korrik	7,111
Gusht	4,037	9,824	
Shtator	4,314	14,885	
Tetor	4,937	19,196	
Nentor	8,096	17,841	
Dhjetor	8,251	9,431	
SHUMA		36,745	84,420



*Shënim: *Kufiri i tolerances per devijimet per muajt Janar 2016 deri Qershor 2016 është ± 1% ndërsa nga muaji Korrik 2016 deri në muajin Dhjetor 2016 është 0%*

Figure 53 Disbalancat brenda dhe jashtë zonës.

Regjistri Pjesmarresve te Tregut 2016

						PRODHUES	P
						TREGTUES	T
						FURNIZUS I KUALIFIKUAR	FK
						FURNIZUES PUBLIK ME SHUMICE	FPSH
						FURNIZUES PUBLIK ME PAKICE	FPP
						SHPERNDARJE	SH
Nr	Emri i Subjektit	EIC Code	nr MPT	data e regjistrimit	Roli ne TEE		
1	A&A Group	23X-150311-A-A2	54	10-03-15	T; FK		
2	Albanian Energy Supplier	54X-AEG-02-1603G	58	26-05-15	T; FK		
3	Albanian General Electricity	23X-150420-AGE8	45	30-10-14	T; FK		
4	ALPIQ Energy Albania	23X-141204AEA-T	11	29-04-11	T; FK		
5	AXPO Albania	23X-150330-AA-K	3	20-01-11	T; FK		
6	Ayen AS Energji	23X-150416-A-N	47	17-12-14	P; T; FK		
7	Ayen Energy Trading	23X-140426-AY-W	40	07-05-14	T; FK		
8	Danske Commodities Albania	23X-121120DCALG	21	31-10-12	T; FK		
9	Devoll Hydropower	23X-150409-DHP5	62	11-06-15	T; FK		
10	EFT Albania	23X-150302-EAL6	18	27-05-11	T; FK		
11	EMIKEL	54X-E-SHPK-16044	56	16-04-15	T		
12	Energija doo Veternik	54X-EDOOV-15-020	68	30-12-15	T; FK		
13	Energji Ashta	54X-HECASHTA-059	20	25-05-12	P		
14	Energy Supply-AL	34X-0000000017-C	24	15-05-13	T; FK		
15	Erdat Lura	54X-HEC-LURA-069	32	17-09-13	P		
16	Future Energy AL	23X-150301-FE-3	50	06-03-15	T; FK		
17	GEN-I Tirana	23X-120709GEN0	4	31-01-11	T; FK		
18	Gjo-Spa Power	54X-HEC-LAPAJ075	33	17-09-13	P		
19	Green Energy Trading Albania	23X-150702GE-3	65	01-07-15	T		
20	Grupi Sistemeve Automatike	22XGSA-----N	16	09-05-11	T; FK		
21	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	23X-130918APC-M	12	25-04-11	P; T; FPSH		
22	KURUM International	23X-131115KI-1	35	17-12-13	P; T; FK		
23	Le Trading Albania	23X-150309-LT-Y	49	16-02-15	T		
24	NOA Energy Trade	23X-150630-NE-6	52	10-03-15	T; FK		
25	Operatori Shperndarjes Energjise Elektrike	23X-130503-CS-2	7	25-04-11	SH; FPP		
26	Stravaj Energy	54X-STRAVAJ-E086	38	25-05-14	P; T		
27	WENERG		64	10-06-15	P		
28	YLLIAD	29XYLLIAD-AL-W	6	03-03-11	T; FK		

Figure 54 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2016.

3.2.4 Monitorimi i KESH sh.a.

Gjatë vitit 2016, ERE ka kryer monitorime kryesisht lidhur me import/eksportin dhe shkëmbimet e energjisë elektrike, realizimin e investimeve, analizimin e rezultateve të shoqërisë KESH sh.a, shërbimet ndihmëse si dhe analizimin e shpenzimeve dhe Cash Flow.

Nga monitorimet e transaksioneve të parashikuara ne Ligjin Nr. 43/2015, që kanë të bëjnë me import/eksportin dhe shkëmbimet e energjisë elektrike është vënë re se blerja dhe shitja energjisë elektrike janë bërë në përputhje me “Rregullat dhe Procedurat e Blerjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me Vendimin e Nr. 30, datë 23.03.2011, me “Rregullat dhe Procedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2011, si dhe me “Rregullat dhe Procedurat e Shkëmbimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin Nr. 100, datë 27.12.2006, i ndryshuar. ERE pas monitorimit të transaksioneve të energjisë nga KESH sh.a. u shpreh me Vendimin të Bordit Nr.131 datë 15.08.2016 me qëllim orientimin e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik në zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Në muajin Shkurt 2017, nga ana e KESH sh.a. u dërguan të dhënat operative lidhur me realizimin e investimeve për vitin 2016.

Te dhena lidhur me realizimin e investimeve me fondet e veta per vitin 2016 .						
Rezultate operative te Investimeve per vitin 2016 <small>(Deklaruar nga KESH Janar 2016) 000/Leke</small>				PROJEKTET		
Nr	EMERTIMI I GRUPIMEVE TE INVESTIMEVE	Plani 2016 KESH (KOSTO LOKALE)	Kontraktuar per zbatim 2016	Numri Projekteve	Projekte te kontraktuara	Projekte te pa realizuara
	HEC Fierz	868,970	478,171	31	15	16
	HEC Koman	916,153	736,070	10	7	3
	HEC Vau i Dej s	847,500	483,415	18	8	10
	KESH Qendër	1,036,276	659,438	19	12	7
		3,668,898	2,357,094	78	43	35
		100	64	100%	55	45
<i>Keto te dhena konsiderohen operative nga ERE, deri ne raportimin sipas rregullores se miratuar nga ERE dhe miratimin e bilancit te KESH sha per vitin 2016</i>						
TE DHENA LIDHUR ME DISBURSIMET NGA KREDITE E AKTIVIZUARA PER SIGURINE E DIGAVE DERI 31.12.2016						
	Shuma Totale e Kontratave (Euro)	Shuma e disbursuar deri me 31.12.2016	% Disbursimit (deri me 31.12.2016)			
Kredia IDA 4480	27,606,132	3,560,177.72	87.10%			
Kredia IBRD 81110 4480	15,213,669	14,434,219.18	5.10%			
Kredia e EBRD	6,450,533	-	100.00%			
Fonde te kursyera nga shuma e kredise EBRD	6,249,467					
Grant i KFW	320,000	230,671.30	27.92%			
Kredia e KFW	20,000,000	20,000,000.00	-			

Të dhënat e mësipërme janë operative dhe do të saktësohen me mbylljen e bilancit të Kompanisë. Vihet re se realizimi i investimeve nuk është ai i parashikuar nga kompania dhe miratuar nga ERE.

3.3 Çmimet dhe Tarifat e Energjisë, Aktiviteti i ERE-s në fushën e rregullimit të Çmimeve dhe Tarifave të Energjisë Elektrike.

Bazuar në ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” përkatësisht në nenet 19, 20, 79 dhe 83, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara që realizohen në sektorin e energjisë, bazuar në metodologjitë e aprovuara.

Gjate vitit 2016 veprimtaria e ERE-s në këtë aspekt konsistoi në vendimarrjet e mëposhtme:

3.3.1 Për periudhën 1 Janar deri 30 Qershor 2016 janë aplikuar tarifat dhe çmimet me pakicë të energjisë elektrike në zbatim të vendimeve të Bordit të ERE-s Nr.156 datë 24.12.2015 të cilët kishin lënë në fuqi tarifat dhe çmimet aktuale të miratuara me vendimet e mëparshme të Bordit Nr.139, Nr.141, Nr.145, Nr.146, Nr.147, Nr.148, datë 26.12.2014.

3.3.2 Për periudhën 1 Korrik 2016-31 Dhjetor 2016 me vendimet e Bordit të ERE-s, Nr. 111 datë 01.07.2016 u lanë sërish në fuqi vendimet Nr.139, Nr.141, Nr.145, Nr.146, Nr.147, Nr.148, datë 26.12.2014 pasi u paraqitën dhe analizuan aplikimet e shoqërive si më poshtë:

- KESH sh.a. kërkoi me shkresën Nr. 4218/3 Prot. datë 16.05.2016 që tarifa e prodhimit me shumicë të energjisë elektrike për periudhën 1 Korrik 2016-31 Dhjetor të jetë 2.91 lekë /kWh.
- OST sh.a. aplikoi me shkresën Nr. 3209 Prot datë 26.05.2016 për një tarifë të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016 prej 0.79 lek/kWh nga 0.65 leke /kWh ajo ekzistuese.
- OSHEE sh.a., me shkresën Nr. 10657 Prot., datë 20.05.2016 kërkoi një çmim mesatar të shitjes së energjisë elektrike tek klientët fundorë prej 11.31 lekë /kWh nga 10.7 lekë /kWh ekzistuese dhe ndërkohë kërkoi lënien në fuqi të tarifave të shërbimit të shpërndarjes çmimet e shitjes me pakicë përkatësisht sipas vendimeve të ERE Nr.147 dhe Nr.148 datë 25.12.2014.

Bazuar në Ligjin 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe VKM 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e Kushteve për Vendorsjen e Detyrimit të Shërbimit publik që do të Zbatohen ndaj të Liçensuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike, të cilët "Ushtrojnë Aktivitetin e Prodhimit, Transmetimit, Shpërndarjes dhe Furnizimit me

Energji Elektrike” ERE me vendimin Nr.111 datë 1.07.2016 la në fuqi për periudhën 1 Korrik 2016-31 Dhjetor 2016 tarifat ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike për shërbimet ndihmëse, shërbimit të transmetimit, të shpërndarjes së energjisë elektrike për nivelin e tensionit 35 kV, tarifës mesatare të shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të miratuara përkatësisht me vendimet Nr. 139, 141, 145, 146, 147, dhe 148 datë 26.12.2014.

Marrja e vendimit Nr.111 date 01.07.2016 u kushtëzua nga:

- Hartimi i akteve nënligjore dhe rregullatore përkatëse në përputhje me Ligjin 43/2015 nuk kishte përfunduar.
- Mbyllja e detyrimeve të ndërsjellta midis tre operatorëve (që është një ndër shkaqet kryesore të mosaxhustimit të të ardhurave të periudhave të mëparshme : 2012-2014, 2015) ende ishte në proces dhe nuk ka përfunduar.
- Aplikimi i OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. konsistonte në llogaritje të të ardhurave të kërkuara për periudhë një vjeçare pavarësisht se kërkonin tarifa për periudhë 6-mujore.
- Mungesa e ndarjes së llogarive për aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit, dhe e alokimit të kostove reale në nivel tensioni si pasojë e vështirësive që paraqet mbajtja e llogarive në kompani. OSHEE sh.a. parashikon që ky proces të perfundojë në fund të vitit 2017.
- Nuk reflektoheshin tek aktiviteti i furnizimit të shërbimit universal kostot e aktivitetit të furnizuesit publik me shumicë të transferuar me ligj me datë 1 Korrik 2016.
- Të ardhurat e kërkuara për aktivitetin e gjenerimit përfshinin edhe elemente të aktivitetit të furnizimit me shumicë të energjisë elektrike.
- Përmirësimi i situatës financiare dhe likuiditeteve për të tre kompanitë vijoi edhe përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2016. Ky fakt shërbeu si indikator i mjaftueshëm për të mbajtur tarifa të njëjta edhe për pjesën e dytë të vitit 2016.

3.3.3 Çmimi i shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU për periudhën 1 Korrik -31 Dhjetor 2016

OSHEE sh.a. me shkresën Nr. 10657 Prot. datë 20.05.2016 ndër të tjera, kërkoi tarifa për klientë të lidhur në TM por me matje në TU. Kjo kategori klientësh nuk ishte evidentuar në strukturën ekzistuese të tarifave. Këta klientë kanë pikën e lidhjes në

tension të mesëm ndërsa matësin e energjisë të vendosur pas pajisjeve transformuese të cilat janë në pronësi të tyre, në tension të ulët.

Kjo mënyrë lidhjeje dhe matje në rrjet shkakton humbje të shtuar të energjisë elektrike në këto pajisje e për rrjedhojë edhe kosto shtesë.

Nisur nga analiza e argumentave dhe studimit të paraqitur nga OSHEE sh.a. për humbjet e energjisë elektrike të shkaktuara nga këta klientë ERE, me Vendimin Nr.128 datë 29.07.2016, miratoi çmimin 12.4 lekë/kWh për shitjen me pakicë të energjisë elektrike aktive (jo pik) për periudhën 1 Korrik -31 Dhjetor 2016 për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU.

3.3.4 Lënia në fuqi nga 1 Janari 2017 deri në 31 Mars 2017 të tarifave dhe çmimeve ekzistuese të miratuara me vendimet Nr. 139, Nr. 145, Nr.146, Nr. 147, Nr. 148 datë 26.12.2014, Nr. 13 datë 16.02.2016, Nr.128 datë 29.07.2016 të Bordit të ERE-s .

Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 190 datë 22.12.2016 la në fuqi edhe për një periudhë tjetër tremujore tarifat e prodhimit, tarifën fikse të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, shërbimeve të transmetimit dhe shpërndarjes si edhe çmimet aktuale të shitjes me pakicë tek klientët fundorë të energjisë elektrike.

Operatorët kryesorë të sektorit të energjisë elektrike; KESHsh.a., OSTsh.a. dhe OSHEE sh.a. nuk respektuan afatet e aplikimit për tarifat e reja të vitit 2017. Për më tepër KESH sh.a. nuk paraqiti aplikim me argumentin e mosplotësimin të kushteve dhe akteve përkatëse në përputhje me kërkesat e ligjit 43/2015.

Në këto kushte ERE bazuar në informacionin e saj të siguruar nga raportimet e kompanive mbi realizimin e treguesve teknik (bilanceve energjetike), ekonomike e financiare, vlerësoi se të ardhurat e këtyre shoqërive ishin të mjaftueshme dhe garantonin zhvillimin normal të aktivitetit të tyre në shërbim të klientëve fundorë me tarifat ekzistuese.

Çmimi i energjisë në tregun rajonal rezultoi me tendencë në ulje duke krijuar një rezervë dhe siguri më të madhe për parashikimet e bëra nga ERE lidhur me të ardhurat që ajo i ka njohur këtyre shoqërive për komponentet që lidhen me blerjet e energjisë elektrike në tregun e lirë sipas legjislacionit në fuqi.

Tabela në vijim jep një pasqyrë të përmbledhur të të ardhurave të kërkuara totale të realizuara nga këto shoqëri nga aktiviteti i tyre për vitin 2015 dhe 2016 kundrejt atyre të miratuara nga ERE për vitin 2015 si viti më i fundit kur janë shqyrtuar dhe miratuar tarifatat dhe çmimet në fuqi të klientëve fundorë.

TE ARDHURAT			
Te ardhura te kerkuara/realizuara per vitin 2015 per shoqerite KESH sh.a., OST sh.a., OSHEE sh.a.	Miratuar nga ERE per vitin 2015	Realizuar per vitin 2015 Pasqyrat financiare Viti 2015	Realizuar per vitin 2016 Pasqyrat financiare paraprake Viti 2016
<i>KESH sh.a</i>	13,573	19,661	16,247
<i>OST sh.a.</i>	4,094	6,350	5,620
<i>OSHEE sh.a.</i>	48,641	58,585	53,017

Vendimin e ERE-s për lënien në fuqi edhe për tre muajt e parë të vitit 2017 të tarifave aktuale u kushtëzua serish nga prezenca e faktorëve dhe problematikave që ndikuan në vendimmarrjet e mëparshme të ERE-s për mosrishikim të tarifave dhe lënien në fuqi të tyre.

Krahas vendimarrjes si më sipër ERE ka filluar procedurat për shqyrtimin e aplikimeve për tarifa të reja të shërbimit të transmetimit dhe ato të shpërndarjes për çdo nivel tensioni për periudhën 1 Prill-31 Djetor 2017. Përgjatë këtij procesi do të kryhet edhe vlerësimi dhe axhustimi i të ardhurave të kërkuara të këtyre shoqërive për periudhat e mëparshme mbi bazën e treguesve që rezultojnë nga pasqyrat financiare si dhe reflektimin e tyre në llogaritjet për tarifatat dhe çmimet për periudhën 1 Prill-31 Djetor 2017 në zbatim të metodologjive përkatëse të llogaritjes së tarifave.

Në vijim paraqiten çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike të miratuara për periudhën 1Janar - 31Mars 2017:

Tarifat e çmimeve te shitjes me pakicë te energjisë elektrike për periudhën 1 Janar-31 Mars 2017		
Niveli I tensionit	Cmimi (leke/kWh)	Cmimi pik(leke/kWh)
Klientë në 10/6 kV	11	12.65
Klientë në TM matja në TU	12.4	14.3
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e perbashkëta (ndriçim shkalle, pompë, ashensor)	9.5	
Tarife fikse e shërbimit për leximin "zero" (leke/muaj)	200	
<p>Çmimi i energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive</p> <p>Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është</p> <p style="padding-left: 20px;">Për periudhën 1 Nentor-31 Mars nga ora 18:00 deri 22:00</p> <p style="padding-left: 20px;">Per periudhen 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri 23:00</p>		

(Burimi: ERE)

3.3.5 Prodhuesit me përparësi te energjisë elektrike dhe impakti i tyre.

Përgjatë vitit 2016 vijoi trendi i rritjes së prodhimit nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (HEC –et me fuqi deri ne 15 MW) si rezultat i ndikimit faktoreve te tille si: prurje te larta hidrike dhe hyrja ne prodhim e centraleve te reja. Gjate vitit 2016 kanë hyrë në operim gjithsej 16 centrale me fuqi totale të impianteve gjeneruese prej 123,4 MW. Prodhimi energjisë elektrike i realizuar nga këto shoqëri gjatë 2016 ishte rreth 124 GWh.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e energjisë së prodhuar dhe të ardhurat e realizuara në vite nga shitja e energjisë elektrike për PVE-të dhe HEC Ashta.



Figure 55 Ecuria e Prodhimit nga prodhuesit me përparësi (Burimi KESH sh.a.).

E njëjta tendencë vërehet edhe në ecurinë e të ardhurave të realizuara nga prodhuesit me përparësi sikurse vërehet në grafikun në vijim:





Figure 56 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi KESH sh.a.).

Rritja e të ardhurave nuk ndjek të njëjtin ritëm me rritjen e prodhimit për shkak të një çmimi të miratuar të shitjes së energjisë elektrike paksa më të ulët nga viti paraardhës si pasojë e luhatjes së çmimit të energjisë në Bursën Hungareze (HUPEX) si element kryesor i formulës së llogaritjes së çmimit për këtë kategori prodhuesish. Si rezultat nëse sasia e energjisë elektrike të prodhuar nga këta prodhues është rritur rreth 39.5% të ardhurat nga shitja e kësaj energjie janë rritur në masën 31.6%.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve të miratura për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për periudhën 2004-2016:



Pesha specifike e prodhuesve me përparësi ndaj konsumit total të energjisë elektrike është rritur ndjeshëm duke ndikuar gjithashtu edhe në koston për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. sikurse tregohet në grafikët në vijim:




Figure 57 Pesha specifike e prodhimit të prodhuesve me përparësi nga konsumit total (Burimi KESH sh.a. OSHEE sh.a.ERE).




Figure 58 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. (Burimi KESH sh.a. OSHEE sh.a.ERE).

3.3.6 Ecuria e tarifave dhe çmimeve të rregulluara.

Në grafikun e figurës në vijim është paraqitur ecuria e çmimeve të energjisë elektrike të miratuara nga ERE gjatë periudhës 2008-3M 2017:




Figure 59 Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-3M 2017.

Grafiku pasqyron ndryshimet e ndodhura në tarifatat e miratuara nga ERE për shkak të reflektimit të ndryshimeve që solli Ligji Nr. 43/2015 në strukturën e tregut shqiptar të energjisë elektrike. Që nga viti 2015 është miratuar tarifa e shërbimit të shpërndarjes për nivelin e tensionit 35 kV ndërsa për periudhën 1 Janar - 31 Mars 2017 u miratua tarifa e shërbimit të shpërndarjes për nivelin e tensionit 20 kV prej 3,9 lekë/kWh. Grafiku i tarifës së shitjes me shumicë të energjisë elektrike nga KESH /FPSH ndërpritet në vitin 2016 për shkak se ky funksion i kaloi furnizuesit të shërbimit universal.

Çmimi mesatar për klientët fundorë për vitin 2016 rezultoi 11,19 lekë/kWh kundrejt atij të rezultuar për vitin 2015 prej 11,22 lekë/kWh, për shkak të realizimit të një strukture të ndryshme nga ai i parashikuar. Sqarojmë se çdo e ardhur e tepërt apo e munguar për vitet 2015, 2016 kundrejt atyre të lejuara dhe miratuara nga ERE do të korrigjohen në periudhën aktuale, vitin 2017.

3.3.7 Tarifatat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, për vitin 2016

Baza e të dhënave e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për tarifatat e energjisë është burimi kryesor i të dhënave zyrtare të energjisë elektrike në vendet e Evropës Qendrore / Lindore.

Në grafikun e figurës janë paraqitur tarifatat e energjisë elektrike para taksimit (TVSH-së) për konsumatorët jo familjarë, për vendet e ERRA-s, në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët jofamiljarë për vendet e rajonit është 12,58 lekë/kWh.



Figure 60 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo familjarë në vendet e rajonit për vitin 2016

(Burimi: ERRA).




Figure 61 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjarë në vëndet e rajonit.

Në grafikun e Figurës 61 janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, për të gjitha vëndet e ERRA-s në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për vëndet e rajonit është 12,32 lekë/kWh.

3.4 Aktiviteti i ERE-s në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar, ndryshimet e tjera Ligjore të ndodhura gjatë vitit 2016 dhe proceset gjyqësore të ndjekura nga ERE.

Puna e Sektorit të Legjislacionit në lidhje me miratimet e vendimeve për dhënien e licensave gjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2016 Sektori i Legjislacionit ka dhënë kontributin e tij në përpunimin e disa praktikave të licencimit të subjekteve të ndryshme në aktivitete të sektorit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror.

Këto vendimmarrje janë shqyrtuar në bazë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe Rregullores së procedurave të licencimit, rinovimit, transferimit dhe modifikimit të licensave. Miratimi ose jo i tyre ka ardhur pas fillimit të procedurave nga Bordi i ERE-s për secilën praktikë. Disa, kanë qënë edhe rastet e shqyrtimit të praktikave me qëllim marrjen e miratimit të ERE për transferimin e aseteve të të licencuarve në një veprimtaritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike.

3.4.1 Aktiviteti i ERE-s në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe Ndryshimet e Tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2016.

Një pjesë e veprimtarisë së ERE-s është edhe hartimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në Sektorin e Energjisë Elektrike. Ky kuadër është plotësuar nga ERE në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht janë ende në proces përpunimi nga ERE disa akte me rëndësi në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore nga ana e ERE-s, është bërë në çdo rast duke konsultuar gjerësisht palët e treta që kanë patur interes të drejtëpërdrejtë mbi këto vendimmarrje. Vlen të përmendim faktin që në çdo rast fillimi i procedurave për shqyrtimin e një akti nënligjor nga ana e ERE është njoftuar në median e shkruar për ti dhënë mundësi njohjeje publikut me të por edhe përcjellë komente apo sugjerime mbi përmbajtjen. Zhvillimi i seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentat në proces përpunimi nga ERE-s, të cilat në çdo rast janë bërë publike për palët përmes publikimit të tyre në faqen elektronike të ERE-s, është një fazë e procesit të miratimit të akteve që është

respektuar me seriozitet e në shumë raste janë organizuar disa seanca dëgjimore me qëllim ballafaqimin e propozimeve të ndryshme mbi këto akte nga palët e interesuara. Po ashtu edhe finalizimi i procesit të miratimit të një akti, garanton transparencën e vendimmarrjeve të ERE-s përmes mbledhjeve vendimmarrëse të cilat janë të hapura për publikun. Në çdo rast aktet e miratuara nga ERE janë konsultuar me Autoritetin e Konkurrencës, Ministrinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë. Në miratimin e këtyre akteve është mbajtur në konsideratë opinioni i palëve si më sipër, si një garanci më shumë në plotësimin dhe mbrojtjen shumëplanëshe të interesave të aktorëve të tregut të energjisë elektrike por mbi të gjitha interesave të konsumatorëve.

3.4.2 Legjislacioni Sekondar i Miratuar përgjatë Vitit 2016

Gjatë vitit 2016, ERE shënon 20 vendimmarrje në lidhje me shqyrtimin e akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike apo gazit natyror, në kuadër të përshtatjes së tyre me Ligjin e ri Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” apo atë 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Përgjatë vitit 2016 ERE ka plotësuar kuadrin rregullator sekondar me vendimmarrjet e mëposhtme.

1. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 27 Datë 09.03.2016 Per miratimin e marreveshjes per furnizimin me energji elektrike midis KESH sh.a./FPSH dhe OSHEE sh.a./FPP

Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", u hodhën bazat për krijimin e një modeli të ri të tregut të energjisë elektrike dhe saktësimin e marrëdhënieve që do të vendosen midis pjesëmarrësve në këtë treg dhe në sektorin elektroenergjetik. Ky ligj parashikoi një sërë aktesh nënligjore dhe rregullore që duhet të miratoheshin (përcaktim i nenit 108) brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, për të siguruar zbatimin e plotë të tij. Po ashtu në kuptim të nenit 109 pika 5, detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut do të vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji. Në këtë frymë u miratua edhe kjo marrëveshje.

2. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 78 Datë 07.06.2016 Mbi miratimin e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.”.

Sipas parashikimeve të Kapitullit “V”, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 68, datë

23.06.2008, të ndryshuar, marrëdhënia midis KESH sh.a. dhe OST sh.a, rezulton të jetë marrëdhënie e rregulluar. Që nga momenti i hyrjes në fuqi të VKM Nr. 244, datë 30.03.2016, *“Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*, përcaktimet e Modelit të Tregut të Energjisë të miratuar me VKM Nr. 338 datë 19.03.2008, i ndryshuar, nuk zbatoheshin më, duke vendosur kështu detyrimin për të miratuar këtë kontratë sipas VKM Nr. 244, datë 30.03.2016. Në këto kushte nga Bordi i ERE-s, u miratua *“Kontrata për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit”* e cila rregulloi periudhën 01.01.2016 - 30.06.2016.

3. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 79 Datë 07.06.2016 Mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro-energjetik, për periudhën kohore 01.01.2016–30.06.2016” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.

“Kontrata për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro-energjetik midis OST sh.a. dhe KESH sh.a” rregullon periudhën 01.01.2016 - 30.06.2016. Vlen të sqarohet se baza ligjore në të cilën ajo gjen mbështetje për këtë periudhë, janë nenet 51, gërmat “b” dhe “d”; 56 gërma “f” të Ligjit Nr 43/2015 *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*; parashikimet e Modelit të Tregut të Energjisë miratuar me VKM Nr. 338 datë 19.03.2008, i ndryshuar dhe Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar. VKM Nr. 244, datë 30.03.2016, *“Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*, nuk ka fuqi prapavepruese dhe si e tillë nuk mund të rregullonte të gjithë periudhën e shkuar në të cilën ka shtrirë efektet kontrata për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit. Efektet fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je. Në të tilla rrethana Bordi i ERE-s me këtë vendim garantoj sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të OST sh.a. nga KESH sh.a. për periudhën 01.01.2016–30.06.2016.

4. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 96 Datë 17.06.2016 Mbi miratimin e rregullore “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Qëllimi i kësaj rregulloreje, është të sigurojë procedura transparente në ushtrimin e funksioneve të ERE-s, duke garantuar një trajtim të barabartë në dhënien e licensave dhe certifikimeve në sektorin e energjisë elektrike, vendosjen e tarifave dhe

çmimeve të të licensuarve në aktivitetet e rregulluara, zgjidhjes së konflikteve midis të licensuarve dhe midis të licensuarve dhe Klientëve, hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi.

5. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 97 Datë 17.06.2016 Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.

ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas Pjesës së Pestë të ligjit Nr. 43,/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, që lëshon dhe deklaron hyrjen në fuqi të Licencës së tregëtimit. Ky draft u hartua, diskutua me palët e interesit dhe u miratua në përmbushje të parashikimeve të ligjit për sektorin e energjisë elektrike nr 43/2015.

6. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 98 Datë 17.06.2016 Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Ky draft i miratuar nga Bordi i ERE-s bazuar në autoritetin që i është dhënë në seksionin e dytë të Pjesës së Pestë të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjië Elektrike”, shënon kushtet dhe të drejtat e detyrimit për të licencuarit për të kryer veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (FEE),dhe/ose të Furnizuesit të mundësisë së fundit ose/dhe për të përmbushur detyrimin e shërbimit publik/universal.

7. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 99 Datë 17.06.2016 Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në Pjesën e Pestë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ERE draftoi, përpunoi me sugjerimet e palëve të interesit këtë Licensë Prodhimi e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e të licencuarve për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (PEE) ose/dhe për të përmbushur detyrimin e shërbimit publik/universal.

8. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 103 Datë 23.06.2016 Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.

ERE konsultoi me palët e interesit dhe me ENC këtë draft të Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike. Traktati i Komunitetit të Energjisë Elektrike miratuar me Ligjin Nr. 9501, vendos ERE-n përpara detyrimit për të përmbushur angazhimet e tij. Drafti i propozuar për miratim nga ENC i Rregullores

për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, paraqiste vështirësi për implementimin e menjëhershëm të këtyre rregullave. Për këtë qëllim ERE miratoi këtë rregullore duke vendosur kushtin e hyrjes në fuqi të saj, 4 muaj pas marrjes së këtij vendimi me qëllim që t'u jepte palëve kohën e duhur për implementimin e saj.

9. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 109 Datë 29.06.2016 Mbi miratimin e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

Kjo rregullore u hartua në zbatim të neneve 20 dhe 39 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe në përputhje me Rregullat e Organizimit, Funkcionimit dhe Proedurave të ERE-s. Ajo përcakton procedurat e licensimit për ushtrimin e aktiviteteve të parashikuara në ligjin Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", duke specifikuar rregullat dhe kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin e licensave në sektorin e energjisë elektrike.

10. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 113 Datë 08.07.2016 Mbi miratimin e "Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike".

Kjo rregullore e ndryshimit të furnizuesit përcakton kushtet, të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve dhe klienteve të energjisë elektrike.

11. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 114 Datë 08.07.2016 Për miratimin e "Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror".

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe procedurat, për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin mes të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror dhe trajtimin e ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

12. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 119 Datë 21.07.2016 Për miratimin e "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit".

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurën dhe dokumentat e nevojshme për miratimin e kërkesave të të licensuarve, të cilët paraqesin në ERE kërkesën për shitje, dhënie me qera, transferim, hipotekim, barre ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licensuarit, të përdorura për

kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike, apo shitje, dhënie me qera, transferimi, hipotekim, barre ose cfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licensuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes dhe operimit të GNL ose depozitave të gazit natyror.

13. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 123 Datë 21.07.2016 Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.

ERE ka të drejtën ekskluzive për të hartuar dhe ndryshuar këtë licensë, për të përmbushur dispozitat e Rregullave të Tregut, Kodit të Rrjeti, Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Matjes, të miratuara nga ERE sipas legjislacionit në fuqi. Në Republikën e Shqipërisë, jepet vetëm një Licensë për Aktivitetin e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike.

14. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 124 Datë 21.07.2016 Mbi miratimin e “Rregullave të menaxhimit të kapacitetit të kufizuar”.

Kjo Rregullore është hartuar dhe miratuar në zbatim të nenit 67, pika 1 e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe në zbatim të Kodit të Transmetimit dhe Kodeve të Rrjetit të ENTSO-I për shkëmbimet ndërkufitare, bazuar në Rregulloren (EC) 714/2009 të Parlamentit Europian.

15. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 125 Datë 29.07.2016 Mbi miratimin e rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.

Qëllimi i kësaj rregullore është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë të Licensuarit në sektorin e energjisë elektrike për të cilët ERE nis procedurën për vendosjen e gjobave për shkeljet e konstatuara sipas parashikimeve të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

16. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 139 Datë 15.08.2016 Mbi miratimin e “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”.

Në nenin 98 të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, parashikohet se Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të cilat duhet të jenë në harmoni me Modelin e Tregut, miratohen nga ERE pas propozimit të OST sh.a.. Me VKM Nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” u miratua modeli i përkohshëm i Tregut. Si rrjedhojë erdhi kjo vendimmarrje e ERE në zbatim të parashikimeve ligjore si më sipër e pas propozimit të OST sh.a.

17. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 144 Datë 25.08.2016 Mbi miratimin e “Kontratës Tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal OSHEE sh.a., për periudhën 1.7.2016–31.12.2016”.

Në nenin 5 të VKM Nr. 244 datë 30.03.2016 parashikohet se :Furnizuesit e Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal I Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit Nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit. Në të tilla kushte erdhi kjo vendimmarrje e ERE për miratimin e kontratës TIP si më sipër.

18. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 164 Datë 06.10.2016 Mbi Miratimin e “Kontratës Tip për Verifikimin dhe Vulosjen e Matësave Elektrikë”.

ERE në bazë të nenit 77 pika 10 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ka detyrimin të miratojë kontratën Tip për verifikimin dhe vulosjen e matësave elektrikë. Kjo vendimmarrje erdhi pas propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) dhe konsultimit të gjerë me të gjitha palët e interesit.

19. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 166 Datë 10.10.2016 për Miratimin e “Rregullore për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. dhe Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes, të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, të përcaktojë procedurat, afatet dhe tarifatat për kryerjen e këtij shërbimi nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe të realizojë një unifikim të cilësisë së punimeve, standardeve dhe karakteristikave teknike të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

20. Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 167 Datë 18.10.2016 Për miratimin e “Rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Evropën Juglindore (SEE CAO)” versioni 1.4.

Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) dhe mbledhja 11-të e EECBR-së mbajtur më datë 09.07.2009, rekomandon që rregullatorët Kombëtarë të miratojnë rregulloret e aprovuara nga SEE CAO. Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian. Kjo Rregullore Ankandi përcakton termat dhe kushtet që rregullojnë shpërndarjen e kapacitetit ndërkufitar nëpërmjet Proceseve të Ankandit në të dyja drejtimet ndërmjet Zonave të Kontrollit të OST-ve pjesëmarrëse.

Këto akte janë miratuar në zbatim të ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" si dhe VKM Nr. 244, datë 30.03.2016, *“Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*

3.4.3 Vendime të Rishikuara të ERE-s përgjatë vitit 2016.

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2016, krahas akteve të nxjerra në kuadër të legjislacionit sekondar, ka nxjerrë dhe akte për të ndryshuar apo modifikuar akte të nxjerra më parë. Akte të tilla janë:

1. Vendimi Nr.10 datë 27.01.2016 “Mbi një ndryshim në vendimin Nr.157 datë 28.12.2015 të Bordit të ERE-s “ Për miratimin e një ndryshimi në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike.”

Ky ndryshim në vendimin Nr.10 është marrë pas propozimit nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a për shtyrjen e afatit të implementimit të rregullave të tregut, që siç parashikohej në vendimin Nr.157 datë 28.12.2015 duhet të ishte filluar nga data 01.01.2016. Si rrjedhojë, me Vendimin Nr. 10 datë 27.01.2016 është përcaktuar se implementimi i Rregullave të Tregut nga ana e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike do të bëhet pas miratimit të Modelit të Tregut nga ana e Këshillit të Ministrave, bazuar në përcaktimet e ligjit nr 43/2015 *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*.

2. Vendimi Nr. 22 datë 16.02.2016 “Për miratimin e amendimit të nenit 5 të Marrëveshjes së Shërbimit të Transmetimit miratuar me Vendimin e ERE-s Nr.10 datë 04.02.2015”.

Ky ndryshim është marrë pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga OST sh.a për shtyrjen e afatit të Marrëveshjes së Shërbimit të Transmetimit lidhur ndërmjet OST sh.a dhe OSHEE sh.a. Palët kanë nënshkruar bashkërisht amendimin e nenit 15 të marrëveshjes, për shtyrjen e afatit të saj deri në 30.06.2016, siç parashikohet në marrëveshje, përpara përfundimit të afatit të saj, në datë 30.12.2015. Ndryshimi i bërë parashikon shtyrjen e afatit të kësaj Marrëveshjeje deri në datë 30.06.2016.

3. Vendimi Nr.101 datë 23.06.2016 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me Vendimin Nr. 80 datë 23.10.2009, të ndryshuar”.

Ky ndryshim në vendim është bërë në zbatim të VKM Nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i cili parashikon që ERE brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë VKM. Pas konsultimit me palët e interesit të ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, Bordi me Vendimin Nr. 101 ka miratuar ndryshimet përkatëse që janë reflektuar në kontratën e sipërpërmendur. Në vijim kjo vendimmarrje e ERE-s pas propozimeve e ankimeve administrative nga palë të interesuara ka pësuar disa ndryshime të reflektuara në vendimmarrjen e Bordit të ERE-s Nr. 132, datë 15.08.2016, “Mbi shqyrtimin e propozimeve për disa shtesa dhe ndryshime në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë midis OSHEE sh.a dhe PPE të miratuar me vendimin Nr. 101, datë 23.06.2016”. Së fundmi me vendimin Nr. 147, Datë 30.09.2016, “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis OSHEE sh.a dhe PPE të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 101, datë 23.06.2016” kjo kontratë ka reflektuar ndryshimet e propozuara nga disa të licencuar në sektorin e energjisë elektrike, shoqatës AREA si dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

4. Vendimi Nr.177 datë 08.11.2016 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve, të propozuara nga shoqëria OSHEE sh.a, në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, të miratuar me vendimin Nr. 166 të bordit të ERE-s, datë 10.10.2016”.

Ky ndryshim në Vendimin Nr. 166 është marrë pas propozimit nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a të disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”. OSHEE sh.a. për të paraqitur këtë propozim të miratuar nga ERE ka arsyetuar dhe argumentuar se është në fillimet e zbatimit të projektit të Datacleaning në BS /OSHEE sh.a..Projektit GIS për rrjetet shpërndarëse të energjisë elektrike është në masën rreth 80% të implementimit për nivelet e tensionit TL dhe TM. Akoma nuk ka filluar zbatimi i projektit GIS në nivel konsumatori fundor. Sapo ka nisur procesi i projektit të "Adresarit të popullatës" për popullimin e plotë të të dhënave në territor. Ka pasaktësi të koordinatave në terren, të cilat mund të atakojnë shtresat e ndryshme me probleme sociale dhe ekonomike.Synohet eliminimi i çdo elementi diskriminues në aplikimin e tarifave.

5. Vendimi Nr.181 datë 23.11.2016 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.104 datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s Nr.49, datë 21.10.2004 dhe Nr. 146 datë 24.12.2013”.

Ky ndryshim në Vendimin Nr.181 është marrë nisur nga konstatimi i një sërë problematikash të paraqitura nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a lidhur me zbatueshmërinë e Vendimit Nr.104 të Bordit të ERE-s, datë 23.06.2016, Mbi Përcaktimin e Metodologjisë së Vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme si dhe mbi shfuqizimin e Vendimeve të ERE-s Nr.49, datë 21.10.2004, dhe Nr. 146, datë 24.12.2013”. Ndryshimet e bëra janë reflektuar në pikën 2 të Vendimit Nr.104 datë 23.06.2016. ERE konstatoi një sërë ankesash të ardhura nga klientë të energjisë elektrike, të cilët ankimonin faturat e vendosura nën zërin “faturim me vlerë referuese”. Për të shmangur këtë problematikë, u propozua që për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të viteve të mëparshme të konsumit me matje të energjisë elektrike (pra për klientët e rinj të energjisë elektrike), faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të rregjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit. Gjithashtu, për të patur një përlllogaritje sa më të saktë të vlerave referuese të faturimit të energjisë elektrike, faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese të bëhet bazuar në mesataren e

faturimit me matje të energjisë elektrike, për muajin respektiv i cili do të faturohet, gjatë 3 viteve të mëparshme. Ky vendim i ERE-s i dha zgjidhje njëherë e mirë problematikave të hasura nga Konsumatorët por edhe nga OSHEE sh.a. në kuptim të pasaktë apo të paqartë të parashikimeve të ligjit.

3.4.4 Kontrata/Marrëveshje TIP të Miratuara përgjatë 2016.

Në zbatim të parashikimeve të ligjit Nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", për shkak të detyrimit me të cilin e ngarkon ky ligj ERE-n në cilësinë e rregullatorit të sektorit, janë miratuar një sërë kontratash apo marrëveshjesh TIP të cilat gjenerojnë detyrime për palët nënshkruese brenda kornizave të parashikimeve të ligjit. Më poshtë listojmë kontratat TIP apo marrëveshjet e miratuara nga ERE si detyrim i parashikimeve të ligjit 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*".

- **Vendimi i Bordit të ERE-s** Nr. 27 Datë 09.03.2016 Për miratimin e marrëveshjes për furnizimin me energji elektrike midis KESH sh.a./FPPSH dhe OSHEE sh.a./FPP.
- **Vendimi i Bordit të ERE-s** Nr. 78 Datë 07.06.2016 Mbi miratimin e kontratës "Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a..
- **Vendimi i Bordit të ERE-s** Nr. 79 Datë 07.06.2016 Mbi miratimin e "Kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro-energjetik, për periudhën kohore 1.1.2016–30.6.2016" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a..
- **Vendimi i Bordit të ERE-s** Nr. 164 Datë 06.10.2016 Mbi Miratimin e Kontratës Tip për Verifikimin dhe Vulosjen e Matësave Elektrikë.
- **Vendimi i Bordit të ERE-s** Nr. 174 Datë 07.11.2016 Mbi miratimin e kontratës/marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.7.2016–31.12.2016.

3.4.5 Vendimarrje të tjera të ERE-s përgjatë vitit 2016.

Të tjera vendimarrje të rëndësishme të Bordit të ERE-s përgjatë vitit 2016 kanë qënë ato të renditura si më poshtë :

- **Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 36 Datë 31.03.2016 Për miratimin e certifikimit përfundimtar të TAP AG, si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror.**

Ky vendim është marrë bazuar në nenet 13, 37 dhe 38 të Ligjit Nr.102/2016 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; 11, të “Rregullave për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror” të miratuar me Vendimin Nr. 100, Datë 05.08.2015 të Bordit të ERE-s, të ndryshuar; të pikës 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (Final Joint Opinion), miratuar me Vendimin Nr.64, date 13.06.2013 të Bordit të ERE-s; Traktatit të Komunitetit të Energjisë të ratifikuar me Ligjin Nr.9501, datë 03.04.2006; Vendimit të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë Nr.2011/02/MC-EnC; si dhe në përputhje me nenin 10-të të Direktivës 2009/73/EC dhe nenin 3 të Rregullores EC, Nr.715/2009 ashtu si janë adoptuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë Nr. 2011/02/MC-EnC ; Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.130 datë 31.10.2015, “Për miratimin paraprak të certifikimit të TAP AG për aplikimin e bërë nga ana e kompanisë TAP AG, në lidhje me certifikimin si Operator i Pavarur i Transmetimit të Gazit Natyror” dhe në Opinionin 1/16 të Komunitetit të Energjisë mbi Certifikimin e TAP AG të datës 03.02.2016, Nr. Prot. 37/2 datë 12.02.2016. Ky vendim i Bordit të ERE-s vendosi miratimin Përfundimtar të Certifikimit të Shoqërisë TAP AG si Operator i Pavarur i Transmetimit (ITO) të Gazit Natyror, në përputhje me nenin 10 të Direktivës 2009/73/CE dhe të paragrafit 4.5.2 të Final Joint Opinion. Certifikimi i TAP AG do të jetë subjekt i kushteve të përcaktuara në “Vendimin Përfundimtar të Certifikimit të TAP AG të Rregullatorëve të Energjisë”

- **Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 112 Datë 08.07.2016 Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal.**

Kjo vendimarrje erdhi në kushtet kur Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” përcaktoi në nenet 2 dhe 4 se “Detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE.

- **Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 115 Datë 08.07.2016 Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike.**

Kjo vendimmarrje e Bordit të ERE-s erdhi në zbatim të parashikimeve të pjesës III, të VKM Nr. 449, datë 15.06.2016, “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”. Në këtë VKM parashikohet se : Deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij Vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e Furnizuesit të mundësisë së fundit. Në të tilla kushte Bordi i ERE-s me vendimin sa më sipër vendosi që të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, nga data 01.07.2016, deri në 31.12.2016. Me afrimin e përfundimit të këtij afati, Bordi i ERE-s rishikoi Vendimin Nr.115, datë 07.08.2016 dhe me Vendimin Nr. 195 datë 30.12.2016 vendosi për shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s Nr.115, datë 07.08.2016, mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike deri në 30 qershor 2017.

- **Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 128, datë 29.07.2016, Mbi tarifën e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU, për periudhën 1 korrik – 31 dhjetor 2016.**

Kjo vendimmarrje e Bordit të ERE erdhi pasi u konstatua se OSHEE sh.a. aplikoi për tarifa për një kategori të re konsumatorësh, e cila nuk ka qënë e përfshirë në strukturën ekzistuese të tarifave, konkretisht për konsumatorët e lidhur në TM por me matje në TU. OSHEE sh.a. deklaroi se një pjesë e klientëve kishin kontrata të pikëlidhjes në TM por matësa të energjisë në pjesën pas paisjeve transformuese dhe transmetuese të cilat janë në pronësi të tyre. ERE më herët ka orientuar OSHEE sh.a. për zgjidhjen për këtë problematikë duke kërkuar që në lidhje me grupin e konsumatorëve për të cilët nuk ka mundësi të zhvendoset pika e matjes (për shkak se janë të lidhur në kabina nga të cilat furnizohen edhe klientë të tjerë, kanë konsum të ulët dhe nuk plotësojnë kushtet teknike) të vazhdohet faturimi me çmimin e TU. Për të dhënë zgjidhje problematikave të hasura por edhe në përgjigje të aplikimit të bërë nga OSHEE sh.a. për këtë tarifë ERE me vendimin sipërcituar vendosi që për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU, të miratojë tarifën 12.4 lekë/kWh për shitjen me pakicë të energjisë aktive (jo pik) për periudhën 1 Korrik - 31 Dhjetor 2016 nga furnizuesi universal.

- **Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 131, Datë 15.08.2016 “Ndërprerjen e Procedurës së Shpallur nga Shoqëria KESH sh.a “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike.**

ERE pas marrjes dijeni të publikimit nga KESH sh.a të ftesës për shprehje interesi për “Marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”, konstatimit të zbatimit të pasaktë të legjislacioni në fuqi që ky i fundit ka kryer në statusin e personit juridik të pajisur me licencë në aktivitetin e Prodhimit të energjisë elektrike, si dhe në zbatim të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, përfshirë dhe detyrimet e shërbimit publik, vendosi që KESH sh.a të ndërpresë menjëherë çdo veprim të mëtejshëm për finalizimin e procedurës së shpallur “Ftesë për shprehje interesi për Marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”. ERE orientoi të ngarkuarin me detyrimin e shërbimit public që në konsulte me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë të propozojë në ERE miratimin e legjislacionit sekondar në mbështetje të kësaj marrëveshje.

- **Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 165, Datë 06.10.2016 Mbi Certifikimin Paraprak të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a.**

Kjo vendimmarje erdhi në kushtet kur Ligji Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” është përafuar plotësisht me direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009, Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, përfshirë kërkesat e parashikuara për certifikimin e operatoreve të sistemit të transmetimit. Ajo bazohet në nenin 54 pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ku parashikohet se Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu në nenin 58 të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” përcaktohet se para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar. ERE përcakton kërkesat për aplikim për certifikim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

- **Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 185 Datë 23.11.2016 Mbi kërkesën e TAP AG për aprovimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore /Regulatory Compliance Programme” të rishikuar, paraqitur në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar /Final Joint Opinion, miratuar me vendimin Nr. 12, datë 14.2.2014.**

ERE me Vendimin Nr. 12, datë 14.02.2014, ka miratuar Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përjashtimit të gazsjellësit TAP. TAP AG ka dërguar në ERE për miratim “Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme të rishikuar, si detyrim i seksioneve 4.5.1 dhe 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion (FJO). Drafti i rishikuar, i dorëzuar nga shoqëria TAP AG është diskutuar mes të tre rregullatorëve, AEEGSI, ERE dhe RAE, të cilët kanë rënë dakort për draftin final të Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme. Në këto kushte ERE mori vendimin sa më sipër në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (Direktiva 73/09); Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009; Ligjit Nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; Vendimit të Komisionit Europian C (2013) 2949 të datës 16 Maj 2013; “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtimin (Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin Itali (AEEGSI), Enti Rregullator i Energjisë Shqipëri (ERE) dhe Autoriteti Rregullator Greqi (RAE), në vijim Final Joint Opinion; Vendimit të Bordit Nr.12, datë 14.02.2014 “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përjashtimit të gazsjellësit TAP;

3.5 Proceset Gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë gjatë vitit 2016.

3.5.1 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë

ERE është thirrur në cilësinë e personit të tretë si palë me të cilin palët paditëse kanë të përbashkët çështjen që kanë paraqitur në gjykatë. Janë 34 proceset gjyqësore në të cilat ERE është thirrur për të ndihmuar palët ndërgjygjëse dhe gjykatën në zgjidhjen e konflikteve të cilat në të gjitha rastet janë shqyrtuar më herët administrativisht pranë sektorit për mbrojtjen e konsumatorit në ERE. Kjo konform Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i cili në nenet 2, gërma “ç” i cili përcakton se: “objektivi i ligjit ndër të tjera është dhe rregullimi veprimtarisë në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e konsumatorëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike”, dhe neni 18, pika 1, gërma “e” që përcakton si detyrim të ERE-s “garantimin e standardeve në përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike, mbrojtja e klientëve në nevojë dhe sigurimi i përputhshmërisë gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave, lidhur me ndryshimin e furnizuesit” neni 24, “zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Këto procese janë iniciuar përgjatë viteve 2014-2015 dhe një pjesë e tyre kanë përfunduar gjykimin në Gjykatën e shkallës së parë, duke u pranuar kryesisht padia e Palëve paditëse, Konsumatorë. Gjykimi i këtyre Çështjeve vijon në gjykatat Kompetente.

3.5.2 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur

ERE ka qënë palë e paditur në 9 procese gjyqësore në vijim të vitit 2015 e përgjatë vitit 2016. Sjellim në vëmendje se në 4 prej tyre, ERE është e paditur nga shoqëria CEZ Shpërndarje në lidhje me vendimmarrje të saj të cilat datojnë në vitet 2010-2011, e për rrjedhojë vetë objekti i kërimit i pretenduar nga pala zëvendësuese paditëse OSHEE sh.a., ka humbur aktualitetin. Bëhet fjalë për vendimmarrjet e ERE-s në lidhje me klauzola të Kontratës së furnizimit për klientët familjarë në vitet 2011-2012, apo marrëveshje të subjekteve të licencuara OSHEE sh.a. – OST sh.a., etj, të cilat pikërisht për shkak të vendimmarrjeve të reja, zëvendësuese, të pagoditura gjyqësisht me tej, në vitet në vijim, kanë humbur aktualitetin. Shpallja nul e këtyre vendimmarrjeve nuk prodhon asnjë efekt mbi palët, pikërisht për shkaqet

sipërcituara. Të katërta këto gjykime, kanë përfunduar me vendim të formës së prerë në gjykatën e apelit, pas rrëzimit të padive nga gjykata kompetente.

Edhe pas përfundimit të aftit për paraqitjen e rekursit në Gjykatën e Lartë, për vendimet e formës së prerë të dhëna nga Gjykata Administrative e Apelit, nuk rezulton asnjë rekurs i këtyre vendimeve nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a.

1. Procesi gjyqësor në Gjykatën Admin. e Apelit, çështja Nr.33, me palë: Paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme AREA, Paditur ERE; me objekt: Deklarim e pavlefshmërisë së Vendimit Nr. 156, datë 24.12.2015 “Mbi lënien në fuqi të Vendimeve Nr. 139, Nr. 140, Nr. 141, Nr. 145, Nr. 146, Nr. 147, Nr. 148, datë 26.12.2014, si dhe Vendimit Nr. 27, datë 16.02.2015” . Me vendim Nr.21, datë 26.05.2016. Gjykata ka vendosur me vendim të formës së prerë rrëzimin e padisë.
2. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për çështjen me palë Paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme AREA, e paditur ERE, me objekt padie Shfuqizimin e Vendimit të ERE Nr. 13, dt. 16.02.2016, ”Mbi tarifën Fikse të Energjisë Elektrike që do tu paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga Hidrocentralet për vitin 2016”. Gjykata me vendim të formës së prerë ka vendosur rrëzimin e padisë.
3. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për çështjen me Nr. 91/49, me palë paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme AREA, të paditur ERE dhe me objekt padie: Deklarimin e pavlefshëm të Vendimit të ERE-s Nr. 143, dt. 26.12.2014 “Për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhim e nergjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013-2014”, Deklarimin e pavlefshëm të Vendimit të ERE-s Nr. 144, dt. 26.12.2014 “Për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhim e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013-2014”. Gjykata me vendim të formës së prerë , ka vendosur rrëzimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë dhe rrëzimin e padisë.
4. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për çështjen me palë paditëse Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme AREA, të paditur ERE dhe me objekt padie: Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të ERE-s Nr.101, dt. 23.06.2016 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës për shitblerjen e energjisë

- elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe Prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike miratuar me vendimin Nr. 80, dt. 23.10.2009”. Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes me kërkesë të paditësit.
5. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për çështjen me palë paditëse Shoqëria “Çez shpërndarje”sh.a, dhe të paditur ERE me objekt: Anullimin dhe pezullimin e aktit administrativ Vendimit të ERE-s Nr. 128, dt.11.09.2012, “Për procedimin administrativ për vendosje gjobe ndaj shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.”. Gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë.
 6. Procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, me palë: Shoqëria “Emikel”sh.p.k dhe Bardhyl Ibro dhe të paditur ERE me objekt: Anullimin e Vendimeve të ERE-s me Nr. 52, dt. 03.05.2013, “Për Licensimin e shoqërisë “TUCEP” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “TUCEP” dhe Nr. 53, dt. 03.05.2013 “Për modifikimin e Licensës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë EMIKEL 2003 sh.p.k”. Gjykata ka vendosur me vendim të formës së prerë rrëzimin e padisë.
 7. Procesi gjyqësor në Gjykatën Admin. Apelit, çështja me Nr. 86, me palë: Shoqëria “OSHEE” sh.a., të paditur ERE, palë e tretë “KESH” sh.a. dhe Avokatura e Shtetit, me objekt: Deklarimin e pavlefshmërisë dhe anulimin e pjesshëm të Vendimit të ERE-s me Nr. 31, dt. 31.03.2011, “*Mbi kontratën për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2011*”. Kjo çështje është ngritur në gjykatë nga ana e shoqërisë “ÇEZ Shpërndarje” sh.a. dhe më vonë me heqjen e licencës së kësaj shoqërie është bërë zëvendësimi procedural nga shoqëria “OSHEE” sh.a.. Me vendim të formës së prerë Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur rrëzimin e padisë se “OSHEE” sh.a..
 8. Procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, çështja me palë: Shoqëria “Çez Shpërndarje” sh.a., të paditur ERE, palë e tretë “Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë” dhe “Certified Solution Corporator” sh.p.k., me objekt: Pavlefshmërinë e Vendimeve të ERE-s me Nr. 62, dt. 22.07.2011 “*Për miratimin e kontratës tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit fillestar dhe periodik të matësave të energjisë elektrike*”, me Nr. 73, dt. 09.08.2011 “*Mbi ankimimin e ÇEZ Shpërndarje Sh.a të vendimit të bordit të komisionerëve të ERE-s Nr. 62 datë 22.07.2011 “Për miratimin e kontratës tip për shërbimin e verifikimit dhe kontrollit fillestar dhe periodik të matësave të energjisë elektrike*”. Kjo

çështje është ngritur në gjykatë nga ana e shoqërisë “ÇEZ Shpërndarje” sh.a. dhe më vonë me heqjen e licencës së kësaj shoqërie është bërë zëvendësimi procedural nga shoqërinë “OSHEE” sh.a.. Me vendim të formës së prerë Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur rrëzimin e padisë së shoqërisë OSHEE sh.a.

9. Procesi gjyqësor në Gjykatën Admin. Apelit, çështja me palë Shoqëria “Çez Shpërndarje” sh.a., të paditur ERE, me objekt: *Pavlefsbmerinë dhe anulimin e pjesbhem të Vendimit të ERE me Nr. 110, dt. 21.10.2011 “Për miratimin e rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”*. Kjo çështje është ngritur në gjykatë nga ana e shoqërisë “ÇEZ Shpërndarje” sh.a. dhe më vonë me heqjen e licencës së kësaj shoqërie është bërë zëvendësimi procedural nga shoqëria “OSHEE” sh.a.. Me vendim të formës së prerë Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur rrëzimin e padisë së shoqërisë OSHEE sh.a.

3.6 Zhvillimi i Seancave Dëgjimore në ERE.

Në total për vitin 2016 shënohen 38 seanca dëgjimore teknike ose jo, të organizuara nga ERE në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licensuar të tregut energjistik apo edhe seanca diskutimesh me palët e interesuara në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr.43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*".

1. Përgjatë vitit 2016 në ERE janë zhvilluar 22 seanca dëgjimore me diskutime me palët e interesuara në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për Sektorin e Energjisë Nr. 43/2015. Ndër aktet nënligjore që kanë qënë objekt i diskutimeve të seancave dëgjimore me palët e interesit veçojmë, “Marrëveshjen e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” midis OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike, praktikë e cila ka rezultuar me disa seancave dëgjimore me palët e interesit deri në miratimin nga ERE të draftit të dakortësuar.

Një tjetër praktikë që kërkoi angazhimin e grupit të punës së ERE-s dhe palëve të interesit ka qënë ajo miratimit të Kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a dhe Prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike miratuar me vendimin Nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar, për të cilën janë zhvilluar rreth katër seanca dëgjimore të cilat çuan më pas drejt miratimit nga ERE të këtij akti me ndryshime. Po ashtu edhe për

Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe Furnizuesit, ERE ka zhvilluar disa seanca dëgjimore me palët e interesit.

2. Përgjatë vitit 2016 në ERE janë zhvilluar 16 seanca dëgjimore teknike ose jo, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licensuar të tregut energjistik. Ndër to përmendim problematikën e “Power Elektrike Slabinja” sh.p.k në lidhje me saktësimin e dispozitave të parashikuara në kontratën konçesionare të shoqërisë për çmimin më të cilën kjo shoqëri garantohet nga autoriteti shtetëror të shesë energjinë elektrike tek KESH sh.a., sot OSHEE sh.a. pas daljes së VKM 244 30.03.2016 “*Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*”, problematikën e “Gjo Spa Power” sh.p.k në lidhje me kyçjen e linjës në nënstationin 110 kv Lapaj – Kukës si dhe një sërë mosmarrëveshjesh mes operatorëve KESH sh.a. OSHEE sh.a. dhe OST sh.a..

3.7 Korrespondencat e trajtuara gjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2016 nga Sektori i Legjislacionit janë trajtuar 285 korrespondenca dhe kryesisht me tematikat: interpretim ligjor, propozime për kuadrin ligjor nga subjektet e Licensuara, kërkesë për vendimarrje nga ERE, kërkesë për opinionin e ERE-s zgjidhje mosmarrëveshjesh

Ndër kërkesat për Opinion veçojmë korrepondencat me MEI në lidhje me problematikat si më poshtë :

- Dosku Energji sh.p.k dhe Dardania Energji sh.p.k. Kjo praktikë ka kërkuar korrespondencë të dëndur me këto dy subjekte por edhe me MEI në cilësinë e Autortietit shtetëror përgjegjës të marrëveshjes koncesionare të lidhur me koncesionarin Dardania Energji sh.p.k.. ERE është në proces të shqyrtimit të kësaj praktike për revokimin e liçensës së subjektit Dosku Energji sh.p.k. dhe saktësimin nga ana e Autoritetit shtetëror MEI si dhe koncesionarit Dardania Energji sh.p.k. të shoqërisë koncesionare të krijuar si detyrim i marrëveshjes koncesionare.

- Shërbimet Ndhimëse dhe Disbalancat. OST sh.a kërkoi miratimin e ERE për të siguruar shërbimet ndihmëse nga KESH sh.a duke theksuar se humbjet teknike të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit janë shumë më të vogla se humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe nuk kanë asnjë ndikim negativ për rezervën hidrike. Aktualisht në tregun Shqiptar të energjisë elektrike vetëm njësitë gjeneruese të të licensuarit KESH sh.a mund të shërbejnë për sigurimin e shërbimeve ndihmëse. Në vijim ERE me vendimin Nr.194, datë 30.12.2016 miratoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat. Kjo vendimmarrje erdhi edhe pas disa komunikimeve me MEI në cilësinë e organit përgjegjës të sektorit elektro-energjitik.
- Kontrata e shitblerjes së energjisë midis OSHEE sh.a. dhe PPE. Disa prej subjekteve koncesionare kundërshtuan lidhjen e kontratës së miratuar dhe rishikuar nga ERE me vendimin Nr. 101, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin Nr. 80 datë 23.10.2009, të ndryshuar”, me bindjen se transferimi i të drejtave dhe detyrimeve të shoqërisë KESH sh.a tek shoqëria OSHEE sh.a do të çenonte të drejtat dhe garancitë e fituara nga investitorët

Në vijim Shoqata AREA ka dërguar në ERE propozimet e koncesionarëve të energjisë elektrike duke shprehur se këto propozime janë hartuar bazuar në deklaratimet e shprehura nga përfaqësuesit e MEI, se garancitë e fituara më parë nga PPE-të në bazë të kontratave të shit-blerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a nuk do të çenohen nga transferimi i Blerësit të energjisë elektrike për disa ndryshime në këtë kontratë.

Në vijim ERE me vendimin Nr.132, datë 15.08.2016, vendosi “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e propozimeve për disa shtesa dhe ndryshime në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis OSHEE sh.a. dhe PPE të miratuar me vendimin Nr. 101, datë 23.06.2016”. Pas marrjes së opinionit të MEI, seancave dëgjimore të zhvilluara nga ERE me palët e interesit dhe rishikimit të vendimit Nr.101, tashmë rezulton se të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike e kanë nënshkruar këtë kontratë me OSHEE sh.a.

- Power Elektrike Slabinje sh.p.k. Në lidhje me problematikën për saktësimin e dispozitave të parashikuara në kontratën koncesionare të shoqërisë “Power

Elektrike Slabinje” me Autoritetin Kontraktues, në të cilën përcaktohet se : Autoriteti kontraktues (METE) “garanton blerjen e energjise elektrike nga shoqëria KESH sh.a., për 15 vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike me çmimin sipas formulës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr 27. Datë 19.01.2007”, vlen të theksohet fakti se ERE ka konsumuar korrespondenca të shumta me vetë shoqërinë në fjalë dhe MEI në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe garantit të kësaj kontrate. Në vijim të komunikimeve me MEI, ERE ka organizuar zhvillimin e disa seancave dëgjimore dhe ka dhënë orientimin e saj lidhur me nënshkrimin nga Power Elektrike Slabinja sh.p.k, të kontratës së shitblerjes së energjisë me OSHEE sh.a. mbështetur në VKM Nr. 244 datë 30.03.2016 , duke shpjeguar se kjo kontratë garanton shitblerjen e energjisë elektrike nga PPE tek OSHEE sh.a.. Tashme jemi vënë në dijeni se Power Elektrike Slabinje sh.p.k ka nënshkruar kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike me OSHEE sh.a në zbatim të ligjit, VKM 244 datë 30.03.2016 dhe vendimarrjes së ERE-s.

- “Energji ASHTA” sh.p.k. ERE pas korrespondencave të vijueshme me MEI, KESH sh.a, OSHEE sh.a dhe Energji Ashta në lidhje me problematiken e marrëdhënieve në treg të Energji Ashta sh.a. referuar kushteve specifike të operimit të këtij subjekti, bazuar në kontratën e miratuar me Vendimin Nr. 170 Datë 18.12.2012 të Bordit të ERE-s “Për miratimin e marrëveshjes së shitjes së energjisë elektrike mes KESH sh.a dhe Energji Ashta sh.p.k” miratuar me VKM Nr. 1363, datë 17.10.2008, ka orientuar drejt zbatimit të vendimarrjes së saj Nr. 101, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin Nr. 80 datë 23.10.2009, të ndryshuar”. Po ashtu ERE ka bërë me dije se sa i takon vijueshmerisë në treg të këtij subjekti duhet të rregullohet në kuadër të të drejtave dhe detyrimeve reciproke mes “Energji ASHTA” sh.p.k dhe OSHEE të cilët aktualisht kanë nënshkruar kontratën midis tyre.
- Prodhimi i energjisë nga Parqet Eolike. Në lidhje me këtë çështje në ERE kanë mbërritur gjatë këtij viti kërkesa për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së licencave për centralet me erë. Në vijim ERE ka ngritur një grup pune i cili aktualisht është duke monitoruar ecurinë e punimeve për subjektet e licensuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet eolike. Ndërkohë MEI i pergjigjet kërkesës së ERE për opinion duke *u shprehur se*

vlerësimi i kërkesave lidhur me licensat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qënë në fuqi në kohën e miratimit të këtyre licensave.

Sa më sipër, Bordi i ERE-s do të konkludojë mbi këto centrale pasi të përfundojë puna e Grupit të monitorimit të ngritur për këtë qëllim.

3.8 Veprimtaria e ERE-s në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.

ERE në zbatim të Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ushtron autoritetin dhe përgjegjësinë e tij në drejtim të zbatimit të masave më efektive për garantimin e mbrojtjes së klienteve të energjisë elektrike, për të pasur tarifa që reflektojnë kostot e drejta dhe të argumentuara për një shërbim furnizimi me energji elektrike të pandërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së furnizimit.

Mbrojtja e Konsumatorëve është e orientuar tashmë edhe në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve të energjisë elektrike dhe të licencuarve, sikurse përcaktohet në nenin 24 të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenin 98 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Roli i ERE-s në veprimtarinë e mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2016, gjithashtu ka konsistuar edhe në hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe monitorimit të zbatimit nga Furnizuesi i Shërbimit Universal të akteve nënligjore të tilla si Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë (etj).

Në funksion të detyrave që i atribuohen nga ligji dhe në ushtrim të funksioneve të tij, ERE ka analizuar të dhënat lidhur me numrin e ankesave të klientëve të paraqitura gjatë vitit 2016 dhe ka evidentuar se ky numër është shumë më i vogël në krahasim me vitin 2015. Për vitin 2016, në ERE janë paraqitur dhe trajtuar 957 ankesa për energjinë elektrike, ndërkohë që gjatë vitit 2015 janë paraqitur dhe trajtuar 3519 ankesa. Përveç ankesave të paraqitura, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit në zbatim të përgjegjësisë dhe objektivave të tij ka ofruar asistencë dhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve dhe konsultimeve verbale dhe me e-mail e telefon, për të gjithë klientët e energjisë elektrike. Objekti i ankesave të paraqitura ka konsistuar në shkeljen e kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë” të miratuar me Vendimet e Bordit të ERE-s,

me Nr. 108 dhe Nr. 109, datë 21.10.2011, në të cilat përcaktohen detyrimet reciproke të palëve në kontratë. ERE në referencë të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe akteve nënligjore të rrjedhura prej tij, ka trajtuar dhe analizuar ankesat e klientëve të energjisë elektrike duke ia përcjellë shoqërisë “OSHEE“ sh.a. së bashku me udhëzimet përkatëse.

Në tabelën e mëposhtme jepen të detajuara sipas objektit ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2016.

OBJEKTI =>	ENERGJI E PAMATUR	FATURIM AFORFE	MBIFATURIM	FATURIM RIKTIV	KONTRATE FIKTIVE	MUKT	VLERE REFERUESE	TE NDRYSHME	TOTALI
MUAJI									
JANAR	24	7	11	6	0	3	0	4	37
SHKURT	46	11	19	2	3	4	0	13	100
MARS	39	19	36	2	4	7	0	9	116
PRILL	37	8	19	3	4	3	0	11	87
MAJ	30	3	24	7	3	9	0	13	93
QERSHOR	24	12	17	2	2	10	0	3	72
KORRIK	10	2	13	2	1	4	0	1	33
GUSHT	22	7	11	3	3	1	0	6	37
SHTATOR	19	13	22	6	0	3	0	6	73
TETOR	24	8	34	4	4	2	27	13	118
NETOR	14	2	24	1	3	7	21	8	80
DHJETOR	19	9	13	3	1	3	12	9	71
Σ	308	105	243	43	32	64	60	102	957
								TOTALI =	957

Figure 62 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2016.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016 janë trajtuar nga ERE në total rreth 957 ankesa. Nga të dhënat e administruara konstatohet se ankesat me objekt “energjinë e pamatur” zënë vendin kryesor në trajtimin e ankesave, të ndjekura nga ankesat me objekt “mbifaturimin” dhe “faturimin aforfe”.

Siç treguar në tabelën e mësipërme, gjatë vitit 2016 janë paraqitur 308 ankesa për “energji të pamatur”; 243 ankesa për “mbifaturim” të energjisë elektrike dhe 105 për “faturim aforfe” të energjisë elektrike.

Në mënyrë grafike ky informacion jepet në Figurën 63.




Figure 63 Tipi i ankesave në %.

3.8.1 Ankesat për “Energji të pamatur“.

Nga analiza e treguesve statistikore konstatohet se spektrin më të madh të ankesave e zënë ankesat për faturimin nën emërtimin “energji e pamatur“, në masën 308 ankesa ose 32% e totalit të ankesave. Vihet re se këto ankesa janë të mbartura dhe përfshijnë faturime të energjisë elektrike, të cilat kanë ardhur si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga shoqëria “CEZ Shpërndarje“ sh.a, përgjatë periudhës 2011-2013, ku vihet re se në shumicën e rasteve të paraqitura, procesverbalet e mbajtura për konstatimin e ndërhyrjeve të paautorizuara në sistemin e matjes janë kryer jo në prezencën e klientit, në bokse kolektive të matësive të energjisë elektrike si dhe raste ku është lëshuar më shumë se një faturë, brenda 1 viti, që përmban “energji të pamatur“.

Pavarësisht trajtimit të një pjese të konsiderueshme të këtyre faturimeve nga shoqëria “OSHEE“ sh.a., vijon të ketë ende ankesa të pazgjidhura lidhur me këtë problematikë.

Theksojmë faktin se konstatohen gjatë vitit 2016, ende ankesa nga klient të energjisë elektrike, të cilët edhe pse periudha e faturimit të tyre nën emërtimin “dëm ekonomik“ dhe “energji e pamatur“, sipas procesverbaleve të mbajtur është bërë në periudhën Tetor 2008-Prill 2011, këto faturime nuk janë anuluar nga kompania “OSHEE“sh.a. (si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr. 90 të Bordit të ERE-s, datë 15.11.2010).

3.8.2 Ankesat për mbifaturimin e energjisë elektrike.

Ankesat e rregjistruara në ERE me objekt “mbifaturimin“ e energjisë elektrike për vitin 2016 janë 243 ankesa, ose rreth 25% e totalit të ankesave. Këto ankesa janë shkaktuar nga problematika të ndryshme si: mosrakordimi i gjendjes së hedhur në sistemin e faturimit me gjendjen reale të matësit, gabime nga ana e faturuesve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësve të rinj në sistem. Për të gjitha këto ankesa, ERE ka kërkuar nga shoqëria “OSHEE” sh.a verifikimin e praktikave dhe procedurave lidhur me faturimet e kryera së bashku me korrigjimet përkatëse që duhen realizuar në zbatim të afateve të përcaktuara për trajtimin e ankesave. Janë evidentuar gjithashtu raste kur pas mbifaturimit të këtyre klienteve, nga ana e shoqërisë nuk është lëshuar faturë korrektive, por klienti është faturuar me konsum 0 kwh për muajt në vazhdim dhe është emetuar nga kompania “OSHEE“ sh.a faturë e energjisë elektrike, e cila përmban vetëm tarifën e shërbimit, ndërkohë që klienti konsumon energji elektrike. Kjo bie në kundërshtim me nenin 12.5 të “Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjare dhe Jofamiljare”.

3.8.3 Ankesat për “faturim aforfe“.

Ankesat e paraqitura në ERE me objekt “faturimin aforfe“ të energjisë elektrike kanë zënë gjithashtu një vend të rëndësishëm edhe gjatë vitit 2016. Janë paraqitur dhe trajtuar rreth 105 raste ose gati 11% e totalit të ankesave. Problematikë vazhdojnë të mbeten faturimet aforfe të energjisë elektrike për periudhën 2007 – 2015, lidhur me sasinë e energjisë elektrike të faturuar aforfe të përcaktuara në Vendimet e Bordit të ERE-s si dhe me afatin final të aplikimit të këtij faturimi bazuar në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.104, date 22.12.2009 “Për përcaktimin e kohëzgjatjes për faturimin aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike”. Ka patur ankesa nga klientë, të cilët edhe pse kanë qenë të pajisur me matës të energjisë elektrike, përsëri janë faturuar aforfe në kundërshtim me Vendimin e Bordit të ERE –s Nr. 146, datë 24.12.2013 ”Mbi kërkesën e kompanisë “Cez-Shpërndarje” sh.a, në administrim të përkohshëm, për vendosjen e faturimit aforfe”. Gjithashtu për klientët familjare me matës të dëmtuar dhe jashtë kushtit teknik, Vendimi Nr. 146, datë 24.12.2013 i Bordit të ERE-s, pika 2 e

tij, përcakton qartë që *“për konsumatorët me matësa të demtuar dhe jashtë kushtit teknik faturimi aforfe sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi aplikohet për një periudhë jo më shumë se 2 (dy) muaj”*.

3.8.4 Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.

Grupi i ankesave të paraqitura në ERE lidhur me “matjet jashtë kushteve teknike”, konsiston në rreth 64 ankesa ose 7% e totalit. Ky faturim është bërë në rastet e evidentimit të matësive të energjisë elektrike, jashtë klasës së saktësisë në matje ose për shkak të dëmtimit të tyre. Faturimi i tyre është bërë bazuar në procesverbalet e mbajtur nga ana e shoqërive të autorizuara për verifikimin e saktësisë së matësive të energjisë elektrike ashtu siç përcaktohet në pikën IV.9 të Kodit të Matjes. Megjithatë, duhet vënë në dukje se mos zëvendësimi i këtyre matësive në afat ka sjellë ngarkimin e konsumatorëve me energji të faturuar për “matje jashtë kushteve teknike”, në kundërshtim me Kontratën për Furnizimin me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, neni 8, pika 2, ku përcaktohet se *“nëse Furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditor për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e Furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero”*. Gjithashtu, problematike mbetet gjendja lidhur me faturimet për matje “jashtë kushtit teknik” të viteve të mëparshme, ku ankimmimet e klientëve të furnizimit me energji elektrike, ende nuk kanë marrë përgjigje nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a.

3.8.5 Ankesat mbi “kontratat fiktive” dhe “faturimin fiktiv”.

Gjatë vitit 2016 janë konstatuar në total rreth 75 ankesa lidhur me kontratat fiktive dhe faturime fiktive. Nga këto 43 ankesa janë për faturim fiktiv ose 5% e totalit të ankesave dhe 32 ankesa për kontrata fiktive ose 3% e totalit, të ankesave që klientët e energjisë elektrike kanë bërë ndaj shoqërisë “OSHEE” sh.a. Këto ankesa lidhen kryesisht me kontrata të furnizimit me energji elektrike të dubluara me kontratat origjinale të klientëve, me kontrata të hapura në mënyrë të njëanshme pa marrëveshje mes palëve, kontrata provizore të hapura gjatë viteve të mëparshme, faturime fiktive për kontrata të cilat janë të shkëputura nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike ose për objekte të cilat nuk ekzistojnë më, apo nuk kanë ekzistuar asnjëherë. Duhet përmendur se problemet kryesore lidhur me kontratat dhe faturimin fiktiv vijnë nga zonat me ndërtime informale, objektet e të cilave kanë qenë ose janë në proces legalizimi nga ana e ALUIZNI-t.

3.8.6 Ankesa “të ndryshme“.

Në grupin e ankesave të klasifikuara “të ndryshme“ janë futur ankesat me objekt: refuzimin e të drejtës për lidhje të re në sistemin e shpërndarjes; ankesat për kreditim të pagesave të energjisë elektrike; ndryshim tarifimi; kolaudim matësi etj. Në grupin e ankesave të ndryshme konstatohen rreth 102 ankesa të cilat zënë 11% të totalit të ankesave.

3.8.7 Ankesa për “vlera referuese“ .

Gjatë vitit 2016 pranë ERE janë depozitur një grup ankesash me objekt kontestimin e vleres referuese. Janë trajtuar rreth 60 ankesa ose 6% e totalit të ankesave. Problematikat e ankesave mbi “vlerat referuese“, u konstatuan në muajin gusht 2016 e në vijim. Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” në nenin 76 te tij, ka përcaktuar ndër të tjera, në pikat 3 dhe 4 të tij se:

Energjia elektrike e hedhur në rrjet ose e furnizuar te klientët fundorë matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e Kodeve të Rrjetit dhe Kodin e Matjes, si dhe në legjislacionin në fuqi për metrologjinë. Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

Në kuptim të sa më sipër parashtruar, vërehet se ligji i atribuon ERE-s, përcaktimin e metodologjisë së llogaritjes së vlerave referuese të matjes së energjisë elektrike, në rastet kur konstatohet se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, duke përcaktuar gjithashtu se vlerat referuese që do të përdoren nga kompania nuk mund të jenë për një kohë më të gjatë se 3 muaj.

Sa me sipër, bazuar në nenin 16 dhe 76 të ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 44/2015, nenit 15 te “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE me Vendimin e tij Nr.104, datë 23.06.2016 vendosi :

1. Shfuqizimin e vendimeve të ERE-s Nr. 49, date 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matësa jashtë kushtit teknik” dhe Nr. 146, datë 24.12.2013 “*Mbi kërkesën e CEZ shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe*” dhe të çdo vendimi që bie në kundërshtim me këtë vendim”
2. Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë me të gjatë së një muaj (matësi është i dëmtuar apo jashtë kushtit teknik) e bën faturimin duke u bazuar në mesataren mujore të faturimit me matje të 3 muajve respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.

Lidhur me zbatimin e këtij vendimi nga ana e kompanisë “OSHEE”sh.a, ERE konstatoi një sërë ankesash të ardhur nga kliente të energjisë elektrike, të cilët ankimonin faturat e vendosura nën zërin “faturim me vlerë referuese” .

ERE ia ka parashtuar këtë problematikë kompanisë “OSHEE” sh.a, ku ka evidentuar ankesat e disa klientëve të energjisë elektrike të cilët ishin faturuar për muajin Gusht 2016 e në vijim, nën zërin “konsum aktiv vlerë referuese” dhe ka kërkuar nga OSHEE sh.a : verifikimin e praktikës dhe procedurës së ndjekur për faturimin e këtyre klientëve të energjisë elektrike dhe anulimin e çdo mbifaturimi të bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Në vijimësi të kësaj problematike shoqëria “OSHEE” sh.a. ka kërkuar nga ERE interpretim të Vendimit të Bordit të ERE-s, Nr.104, datë 23.06.2016 “*Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme si dhe mbi shfuqizimin e Vendimeve të ERE Nr.49, datë 21.10.2004, dhe Nr. 146, datë 24.12.2013*”.

Lidhur me kërkesën për interpretim ERE ka sqaruar se : se Vendimi Nr.104 i Bordit të ERE-s, datë 23.06.2016, përcakton mënyrën e faturimit të energjisë elektrike në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj. Në këtë vendim, nuk parashikohen rastet kur matësi i energjisë elektrike punon jashtë klasit të lejuar të saktësisë në matje, për shkak se në këtë rast përlllogaritja e sasisë së energjisë që duhet të faturohet ose kompensohet respektivisht në zbatim të rezultateve të testimit, bëhet me përlllogaritje të saktë matematikore dhe jo me vlera referuese zëvendësuese siç parashikon Vendimi Nr.104 i Bordit të ERE-s , datë 23.06.2016 dhe neni 76, pika 4 e ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ku mbështetet vendimi i lartpërmendur.

Faturimi i energjisë elektrike, në rastet kur matësi i kalon kufinj të saktësisë të përcaktuara në Kodin e Matjes, të miratuar me Vendimin Nr.101 të Bordit të ERE-s, datë 26.08.2008, do të bëhet bazuar në pikën IV.9 të Kodit të Matjes.

Gjithashtu, në Vendimin Nr.104 të Bordit të ERE-s, datë 23.06.2016, nuk përfshihen as rastet e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike apo sistemin e matjes së saj, të cilat trajtohen sipas parashikimeve të pikes 9, të nenit 77 të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe metodologjisë së llogaritjes të dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë shpërndarëse nga çdo ndërhyrje e paligjshme, të miratuar nga ERE.

Për të zgjidhur problematikën e sipërcituar ERE, ka gjykuar të drejtë zhvillimin e një seance degjimore me shoqërinë “OSHEE” sh.a. Gjatë seancës degjimore nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a. u paraqiten një sërë problematikash lidhur me zbatueshmërinë nga ana e saj të Vendimit Nr.104 të Bordit të ERE-s, datë 23.06.2016.

Sipas OSHEE sh.a, këto problematika kanë lindur me kontratat e furnizimit të energjisë elektrike për ata klientë që nuk kanë një historik faturimi, lidhur me konsumin me matje të energjisë elektrike.

Për të shmangur këtë problematikë, u propozua që për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të viteve të mëparshme të konsumit me matje të energjisë elektrike (pra për klientet e rinjë të energjisë elektrike), ***faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të rregjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.***

Gjithashtu, për të patur një përlllogaritje sa më të saktë të vlerave referuese të faturimit të energjisë elektrike, ***faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese të bëhet bazuar në mesataren e faturimit me matje të energjisë elektrike, për muajin respektiv i cili do të faturohet, gjatë 3 viteve të mëparshme.***

Nga ana e ERE-s, u paraqit shqetësimi lidhur me ankesat e paraqitura në ERE, për faturimin me vlera referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes në bokse kolektive. Në këto kushte u pa e arsyeshme të bëhen disa ndryshime në Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.104 datë 23.06.2016. Keto ndryshime konsistuan në:

Së pari, të përcaktohet se përjashtohen nga faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes, të gjitha kontratat e furnizimit me energji elektrike me matës të energjisë elektrike të instaluar në bokse kolektive.

Së dyti, për faturimet me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes, në momentin e leximit të të dhënave të matjes, Furnizuesi do të axhustojë në faturën pasardhëse të energjisë elektrike, diferencën ndërmjet sasisë së energjisë

elektrike të faturuar me vlerë referuese dhe sasisë së energjisë së konsumuar referuar të dhënave të matjes.” **Për gjithë sa më sipër parashtruar, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr.181**, datë 23.11.2016, vendosi “Për disa ndryshime në vendimin Nr.104 datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritëshme si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s Nr.49, datë 21.10.2004 dhe nr 146 datë 24.12.2013””.

Përgjigje të ardhura nga OSHEE sh.a gjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2016 janë trajtuar nga OSHEE sh.a 906 ankesa të klientëve për të cilat ERE ka kërkuar zgjidhjen e tyre. Në analizë të përgjigjeve të ardhura në ERE vërehet se janë:

- 256 përgjigje të ardhura nga OSHEE gjatë 2016, për ankesa të dërguara për verifikim dhe trajtim gjatë vitit 2016;
- 394 përgjigje të ardhura nga OSHEE gjatë 2016, për ankesa të dërguara për verifikim dhe trajtim gjatë vitit 2015;
- 256 përgjigje të ardhura nga OSHEE gjatë 2016, për ankesa të dërguara për verifikim dhe trajtim gjatë vitit 2014;

Sa i takon problematikës së ankesave të trajtuara nga OSHEE sh.a. vërehet se nga 906 përgjigje të ardhura nga OSHEE gjatë vitit 2016 :

-189 prej tyre kanë patur si subjekt anulimin e faturave të ankimuar;

-322 prej tyre kanë patur si subjekt kthim përgjigje lidhur me ankesat e paraqitura;

-283 prej tyre kanë patur si subjekt përgjigje negative lidhur me ankesat e klientëve për “energji të pamatur” ose “dëm ekonomik”;

-57 prej tyre kanë patur si subjekt përgjigje tejkalimin e afatit të përcaktuar në kontratë për paraqitjen e një ankese;

-64 prej tyre kanë patur si subjekt përgjigje mungesën e dokumentacionit nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a, për të gjykuar mbi ankesat e paraqitura.

Treguesit e vazhdueshmërisë dhe cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike.

		SHKAKU I NDERPRERJES				Numri i Konsumatoreve të prekura			Nderprerje të Planifikuara					Nderprerje të PaPlanifikuara					SAIFI	SAIDI	CAIDI
		Nderprerje e Planifikuar	Force Madhore	Pergjegjesi e paleve te treta	Pergjegjesi e OSHEE	GJITHSEJ	ZONE URBANE	ZONE RURALE	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RURALE	Nr konsumatoresh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RURALE	Nr konsumatoresh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)			
Janar	Total TL	12	17	18	141	1,327,780	717,022	610,758	58,347	5,455	52,092	141,709	26	1,059,339	329,655	729,684	1,323,431	358	0.84	1.10	1.31
	Tot TM	95	146	168	3,615	1,327,780	717,022	610,758	148,067	13,109	134,958	527,427	3,939	4,869,045	1,154,317	3,715,789	11,862,678	18,280	3.78	9.33	2.47
Shkurt	Total TL	83	26	14	104	1,327,780	717,022	610,758	322,049	162,820	159,229	511,003	161	723,778	216,380	507,398	1,770,728	311	0.79	1.72	2.18
	Tot TM	104	102	142	3,520	1,327,780	717,022	610,758	109,973	4,894	105,079	497,200	334	4,472,647	954,482	3,518,135	10,094,557	12,770	3.45	7.98	2.31
Mars	Total TL	88	14	3	49	1,327,780	717,022	610,758	359,895	117,762	242,127	709,938	172	496,253	139,615	356,638	1,116,496	239	0.64	1.38	2.13
	Tot TM	435	173	39	2,243	1,327,780	717,022	610,758	585,396	92,334	493,062	1,625,672	1,384	3,024,091	666,223	2,357,868	7,077,013	8,517	2.72	6.55	2.41
Prill	Total TL	141	7	7	72	1,327,780	717,022	610,758	502,131	152,656	349,475	1,367,819	328	439,920	106,846	333,078	550,628	184	0.71	1.44	2.04
	Tot TM	298	53	67	1,675	1,327,780	717,022	610,758	541,152	95,267	445,885	1,952,764	1,926	2,606,630	709,718	1,897,687	5,298,754	5,547	2.37	5.46	2.30
Maj	Total TL	151	7	3	50	1,327,780	717,022	610,758	547,029	119,033	427,996	1,751,699	418	310,637	92,393	218,244	492,086	120	0.65	1.69	2.62
	Tot TM	477	90	31	1,691	1,327,780	717,022	610,758	534,968	59,959	475,009	1,758,824	2,071	2,365,292	511,278	1,856,069	4,924,493	6,104	2.18	5.03	2.30
Qershor	Total TL	160	13	4	90	1,327,780	717,022	610,758	609,620	176,439	433,181	2,597,829	502	440,739	82,954	357,785	846,185	279	0.79	2.59	3.28
	Tot TM	301	55	31	1,930	1,327,780	717,022	610,758	374,652	70,189	304,563	1,297,605	11,286	2,476,545	614,260	1,840,704	4,770,501	7,824	2.15	4.57	2.13
Korrik	Total TL	84	9	6	83	1,215,818	682,435	533,383	274,133	111,141	163,202	1,233,562	381	347,344	81,810	265,534	705,620	239	0.51	1.59	3.12
	Tot TM	200	396	61	2,097	1,215,818	682,435	533,383	209,574	56,468	153,106	534,359	600	2,934,020	801,331	2,132,239	5,508,424	8,140	2.59	4.97	1.92
Gusht	Total TL	57	26	12	80	1,215,818	682,435	533,383	185,516	67,563	117,953	584,684	231	427,270	119,074	308,208	548,362	213	0.50	0.93	1.85
	Tot TM	137	73	60	2,196	1,215,818	682,435	533,383	171,538	51,915	119,624	309,719	302	2,840,150	746,924	2,098,309	5,411,863	5,802	2.48	4.71	1.90
Shtator	Total TL	139	22	6	78	1,215,818	682,435	533,383	636,625	199,909	436,716	1,822,141	408	471,537	119,143	352,394	772,936	245	0.91	2.13	2.34
	Tot TM	284	146	79	2,880	1,215,818	682,435	533,383	333,528	56,465	277,063	903,301	834	3,557,711	963,793	2,593,918	7,769,634	9,368	3.20	7.13	2.23
Tetor	Total TL	166	3	0	133	1,215,818	682,435	533,383	672,655	231,834	440,821	1,379,611	388	436,938	134,470	302,468	903,474	396	0.91	1.88	2.06
	Tot TM	478	79	102	2,900	1,215,818	682,435	533,383	644,075	148,095	495,980	1,482,635	1,323	3,507,658	937,761	2,569,897	7,894,466	9,879	3.41	7.71	2.26
Nentor	Total TL	87	28	9	132	1,215,818	682,435	533,383	388,050	113,585	274,465	918,898	373	761,266	179,602	581,664	1,001,248	315	0.95	1.58	1.67
	Tot TM	478	170	128	3,112	1,215,818	682,435	533,383	471,723	90,253	381,470	1,327,442	1,336	4,132,743	1,057,825	3,073,891	11,347,771	14,656	3.79	10.43	2.75
Dhjetor	Total TL	116	0	0	101	1,215,818	682,435	533,383	281,901	176,560	105,341	545,883	417	438,949	229,861	209,088	503,709	254	0.59	0.86	1.46
	Tot TM	247	40	45	1,897	1,215,818	682,435	533,383	327,303	105,411	225,036	891,690	914	2,390,172	802,282	1,627,950	4,315,711	6,324	2.24	4.28	1.92
JANAR-DHJETOR 2016	Total TL	1,284	172	82	1,113	1,215,818	682,435	533,383	4,837,951	1,634,757	3,202,598	13,564,775	3,804	6,353,970	1,831,803	4,522,183	10,534,903	3,154	8.80	18.91	2.15
	Tot TM	3,534	1,523	953	29,756	1,215,818	682,435	533,383	4,451,949	844,359	3,610,833	13,108,639	26,250	39,176,704	9,920,194	29,282,456	86,275,865	113,211	34.35	78.16	2.28
		4,818	1,695	1,035	30,869	1,215,818	682,435	533,383	9,289,900	2,479,116	6,813,431	26,673,414	30,053	45,530,674	11,751,997	33,804,639	96,810,769	116,365	43.15	97.07	2.25

Figure 64 Treguesit e cilesisë së shërbimit.

SAIFI = NUMRI TOT I KLIENTEVE TE PREKUR

NUMRI TOT I KLIENTEVE

SAIDI =	$\frac{\text{KOHA TOT E NDERPRERJEVE}}{\text{NUMRI TOT I KLIENTEVE}}$
----------------	---

CAIDI =	$\frac{\text{KOHA TOT E NDERPRERJEVE}}{\text{NUMRI I KLIENTEVE TE NDERPRERE}}$
----------------	--

Lidhur me treguesit e vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike, nga raportimet e shoqërisë “OSHEE“ sh.a vihet re se janë përmirësuar treguesit e vazhdueshmërisë së shërbimit në krahasim me vitin 2015. Këto tregues janë nxjerrë nga llogaritja e ndërprerjeve në Tension të Lartë dhe të Mesëm. Llogaritja e ndërprerjeve në Tension të Ulët do të behet e mundur me funksionimin e sistemit SCADA.

Vlerat totale (TL + TM) të SAIFI-t, SAIDI-t dhe CAIDI-t për vitin 2016 janë përkatësisht 43,15; 78,16 dhe 2,25.

TREGUESIT E VAZHDUESHMERISE SE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE 2011-2015				
		SAIFI	SAIDI	CAIDI
Viti 2015	TM	35.53	85.11	2.4
	TL	13.55	36.84	2.72
	Viti 2015	49.08	121.95	2.48
Viti 2016	TM	12.15	34.25	2.82
	TL	39.71	77.57	1.95
	Viti 2016	51.86	111.82	2.16

Figure 65 Treguesit e vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike gjatë viteve 2015 – 2016.




Figure 66 Treguesit e vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike në tension të mesëm gjatë vitit 2016.




Figure 67 Treguesit e vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike në tension të lartë gjatë vitit 2016.

3.9 Hartimi i akteve nënligjore të Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” lindi si detyre miratimi dhe përmirësimi i një sërë aktesh sekondare të cilat tashmë në funksion të ligjit të ri të sektorit, i pajisin palët e interesit me të drejta të plotësuara por edhe i vendosin përpara detyrimeve të reja.

Në mbështetje të attributeve që burojnë nga Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, janë hartuar disa akte nënligjore, të cilat kanë qënë objekt i punës së ERE.

1. “Rregullorja Për Lidhjet e Reja”.

Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit cituar më sipër, në bazë të nenit 27 pika 3, ERE miraton Rregulloren për procedurat për lidhjet e reja, të propozuara nga i licënsuari, ku përshihet metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarte e lidhjes, të cilat janë transparente dhe efçente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.

Duke mbajtur në konsideratë dispozitën 27, pika 3, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, kompania OSHEE sh.a, propozoi “*Draftin me ndryshimet e kërkuara në rregulloren e lidhjeve të reja për të përmirësuar punën e OSHEE-se në garantimin e pa ndërprerë të energjisë elektrike dhe parametrave teknikë të saj*”.

OSHEE sh.a, edhe më parë ka paraqitur ndryshime të kësaj rregulloreje, të cilat janë marrë në shqyrtim nga ERE dhe kjo e fundit është shprehur me Vendimin Nr.53, datë 17.04.2015 të Bordit të Komisionerëve “*Për disa ndryshime në Rregulloren e Lidhjeve të Reja në sistemin e Shpërndarjes*”.

Për sa më sipër shpjeguar ka patur korrespondenca të herë pas herëshme mes ERE, OSHEE sh.a. dhe MEI, si pas ngritjes së grupit të punës mes palëve dhe për shqyrtimin e propozimeve për ndryshime mbi draftin e rregullores për lidhjet e reja. Këto ndryshime dhe propozime pasi u analizuan u evidentuan në Draft- Rregulloren përkatëse.

Pasi u njoh me ndryshimet e reflektuara në Draft -Rregullore dhe me relacionin shpjegues të saj, Bordi i ERE-s, në zbatim të nenit 27, pika 3; 108 dhe 110 të Ligjit, Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, në vendimin Nr. 60, date 29.04.2016 vendosi:

Fillimin e procedurave për shqyrtimin e Draft - Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes.

ERE në zbatim të nenit 25 të “*Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s*”, ka ftuar të gjitha palët e interesuara për komente dhe opinione lidhur me këtë Draft – Rregullore.

Në përfundim të afatit 15 ditor, të përcaktuar në nenin 25 të “*Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s*”, u konstatuan disa komente të ardhura nga këto institucione, si MZHETTS ; MEI; Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Autoriteti i Konkurrencës; Avokati i Popullit; Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Shoqata e Konsumatorit Shqiptar. ERE mori në konsideratë komentet përkatëse dhe në mbështetje të nenit 16; nenit 20 gërmat “a”; nenit 27, pika 3; nenit 108, pika 3; nenit 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 26 të “*Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurat e ERE-s*”, miratuar me Vendimin Nr. 96, date 17.06.2016, në Vendimin e ERE-s Nr.166, datë 10.10.2016 vendosi : “Miratimin e “*Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes*”, se bashku me anekset përkatëse si Tarifatat për Lidhjet e Reja dhe Marrëveshja e Lidhjes së Re.

Pas miratimit të kësaj rregullore, me shkresën me Nr.795/1 Prot, datë 01.11.2016, është bërë një kërkesë nga ana e kompanisë “OSHEE” sh.a, për ndryshime në “*Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes*”, të miratuar me Vendimin Nr.166 të Bordit të ERE, datë 10.10.2016.

Në këtë shkresë, nga shoqëria “OSHEE” sh.a janë sjellë argumentet përkatëse lidhur me gjithë ndryshimet e propozuara në rregullore, të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e tarifave T1, T2 dhe T4, të cilat janë komponente të tarifës që paguhet nga aplikanti për realizimin e lidhjes së re.

Lidhur me sa më sipër, Bordi i ERE-s miratoi me Vendimin Nr. 177, datë 08.11.2016, “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve, të propozuara nga shoqëria “OSHEE” sh.a, në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, të miratuar me Vendimin Nr. 166 të Bordit të ERE-s, datë 10.10.2016”.

2. “Rregullorja mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”.

ERE në bazë të nenit 77 pika 6, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ka detyrimin të miratojë procedurën për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuarit, kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës dhe paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit të rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për verifikimin e aparatit matës.

Lidhur me sa më sipër, në mbështetje të neneve 16; 77, pika 6; të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr.67, datë 27.05.2016, vendosi të fillojë procedurat për miratimin e Rregullores mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike.

Pas miratimit të fillimit të procedurave, drafti i rregullores u publikua në faqen e internetit të ERE-s dhe iu dërgua për mendim të gjithë palëve të interesuara bazuar në nenin 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”. Në përfundim të afatit të përcaktuar për dhënien e mendimit nga palët e interesuara, u konstatua se kishte komente të ardhura mbi draftin nga MEI, MZHETTS, OST, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Shoqata e Konsumatorit Shqiptar. ERE tashmë i ka analizuar të gjitha komentet e ardhura nga palët e interesuara dhe është në fazën përmbyllëse të kësaj rregullore.

3. Rregullore për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike

Këto rregulla përcaktojnë kushtet dhe procedurat për ndryshimin e furnizuesit. Ndryshimi i furnizuesit, sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, bëhet me kërkesë të klientit fundor dhe pa kosto shtesë për të Kalimi të furnizuesi i ri bëhet në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ana e klientit fundor, përveçse kur është një rast i furnizimit si një detyrim i shërbimit publik apo furnizimit të mundësisë së fundit, sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

Në mbështetje të nenit 88 të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” neni 88, u përgatit drafti i “***Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike***”.

Objekti i këtyre rregullave konsiston në hartimin e kushteve dhe procedurave për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike, i cili do të furnizojë klientin fundor, sipas kontratës së plotë të furnizimit si dhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit dhe të operatorit të sistemit në kuadër të procedurës së ndryshimit të

furnizuesit. Draft rregullorja në fjalë, në frymën e hartimit të saj ka mbrojtjen e interesave të klientëve të energjisë elektrike, nëpërmjet një procedure të drejtë dhe transparente, të barabartë dhe jodiskriminuese, ndaj të gjithë klientëve të energjisë elektrike, në respektim të së drejtës së tyre legjitime për të marrë shërbimin me energji elektrike, me çmime konkureses dhe me cilësinë e duhur.

Për sa me sipër argumentuar, Bordi i ERE-s në Vendimin Nr. 93, datë 09.06.2016 vendosi: **“Fillimin e procedurave për miratimin e Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”**.

Në zbatim të nenit 25, pika 2 të Rregullave dhe Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, iu është dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draft Rregullorja “Për ndryshimin e furnizuesite të energjisë elektrike” për tu konsultuar dhe për të mirëpritur komentet e tyre me qëllim përmirësimin e parashikimeve të propozuara nga grupi i punës së ERE, në zbatim të legjislacionit në fuqi, por mbi të gjitha në respekt të mbrojtjes të të drejtave të klienteve të energjisë elektrike.

Në përfundim të afatit 15 ditor të përcaktuar në nenin 25, pika 3 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-” nuk rezultoi asnjë koment apo opinion nga palet e treta dhe grupet e interesit mbi këtë rregullore.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nenit 16; nenit 88; si dhe nenit 25 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s“, Bordi i ERE-s, në Vendimin e tij Nr.113, date 08.07.2016 vendosi : Miratimin e “Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.

4. “Rregullorja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”

Kjo rregullore përcakton procedurat dhe afatet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klienteve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në frymën e zbatimit të Ligjit Nr. 43/2015 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit Nr. 102/2015 ”Për sektorin e Gazit Natyror” .

Për hartimin e kësaj rregulloreje është mbajtur në konsideratë, përveç praktikat më të mira të vendeve të rajonit dhe legjislacioni në fuqi si:

- Kodi i Procedurave Administrative;
- Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

- Ligji Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Nëpërmjet kësaj rregulloreje garantohet roli i ERE-s në gjykimin sa më të drejtë, transparent në mbrojtje të të drejtave të klientëve dhe sigurimin e trajtimit sa më të barabartë dhe jodiskriminues ndaj operatorëve të tregut të energjisë në respekt dhe në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të tregut të energjisë elektrike.

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “ë”; 24, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë elektrike”; nenit 17, pika “ë”; neni 98, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Gazin Natyror”; dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr.92, datë 09.06.2016 vendosi të miratojë fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Sikurse dhe në rastet e tjera për aktet nenligjore, pas marrjes së vendimit nga Bordi i ERE-s për fillimin e procedurave të miratimit të këtyre rregullave, drafti i Rregullores u konsultua me të gjitha grupet e interesit. Në përfundim të afatit të përcaktuar për dhënien e mendimit nga palët e interesuara dhe analizimit të komenteve të tyre, Bordi i ERE, me Vendimin Nr. 114, datë 08.07.2016, vendosi “Për miratimin e rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

5. Rregullorja “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të krijojë kushtet e një shërbimi të garantuar për furnizim të pandërprerë (brenda limiteve të lejuar të përcaktuara në këtë rregullore) me energji elektrike, të klienteve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Kjo rregullore synon të përcaktojë treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike të klienteve të energjisë elektrike, përmes rregullave për vazhdueshmerinë e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet evidentimit të ndërprerjeve të energjisë elektrike, në sistemin e shpërndarjes si dhe klasifikimin e ndërprerjeve. Ky akt nënligjor në frymën e hartimit të tij ka mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, nëpërmjet përcaktimit të parametrave të cilësisë së furnizimit dhe detyrimeve të ndërsjellta të furnizuesve dhe klientëve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, për të ruajtur një marrëdhënie transparente në tregun e energjisë elektrike. Bazuar në përcaktimet e nenit 7, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes hartojnë rregulla

specifike që përcaktojnë mënyrën e operimit të rrjeteve të tyre, përfshirë kushtet për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit. Rregullat e cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit miratohen dhe monitorohen nga ERE. Në këto kushte, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, shoqëria “OSHEE” sh.a, me shkresën Nr.351/6 Prot hyrës, datë 06.06.2016, ka paraqitur në ERE një draft rregullore për kushtet minimale të cilësisë së shpërndarjes së energjisë elektrike.

Për sa më sipër argumentuar, në mbështetje të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neni 7, pika 1; nenit 16, nenit 20, pika “g” nenit 110, pika 2 si dhe në zbatim të nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, Bordi i i ERE-s në vendimin Nr.95, datë 17.06.2016 vendosi: ***Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.***

Në zbatim të nenit 25, pika 2 të “Rregullave dhe Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, iu është dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draft Rregulloren “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” për tu konsultuar dhe për të mirëpritur komentet e tyre. Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 25, pika 3 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Proçedurave të ERE-”, subjekte si “Operatori i Sistemit të Transmetimit” dhe “Shoqata e Mbrojtjes së Tregtarëve dhe Tregut të Shqipërisë” sollën komente lidhur me këtë draft rregullore. ERE e ka konsultuar draft rregulloren dhe me USAID, i cili ka paraqitur komentet të tij në lidhje me draft –Rregulloren, duke hartuar një draft të ri rregullash lidhur me kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Në vijim të konceptimit të këtyre rregullave, në funksion të ndryshimeve të ndodhura në fundmi në sektorin e energjisë elektrike, si ristrukturimi i tij dhe implementimi i Modelit të Ri të Tregut, në këto rregullore parashikohet se nivelet e pritshme të performancës të OSSH, bazuar mbi treguesit e matjes së cilësisë së shërbimit, do të vihen në zbatim brenda datës 31 Dhjetor 2018, duke u rivlerësuar në funksion të performancës së ushtruar gjatë kësaj periudhe tranzitore dhe gjendjes së sektorit të energjisë elektrike. Për kjo periudhe, nga hyrja në fuqi e rregullores deri me datë 31 Dhjetor 2018, do të shërbejë si një periudhe tranzitore për të parë performancën e ofruar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Për këtë arsye, në nenin 7.2 të Rregullores parashikohet se OSSH nuk do të jetë subjekt i kërkesës për kompensim nga ana e klientëve fundor, lidhur me mospërmbushjen e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, përpara datës 31 Dhjetor 2018.

Drafti i propozuar nga USAID ,ju është bërë me dije edhe njëherë të gjitha palëve të interesuara. Lidhur me këtë draft, kanë ardhur komente nga ana e MZHETTS, OST dhe Shoqata e Konsumatorit Shqiptar. Palët kanë qënë parimisht dakord me propozimin e ardhur dhe ERE është në fazën përfundimtare të dërgimit për miratim pranë Bordit të ERE-s të kësaj rregullore.

6. “Rregullorja për parametrat e cilësisë së furnizimit dhe performances se sigurise se rrjetit ne sistemin e transmetimit te energjise elektrike”.

Ligji Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjise Elektrike”, ka ngarkuar ERE-n me detyrimin e miratimit dhe monitorimit të kushteve të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit, të cilat janë draftuar nga vetë operatori, shoqeria “OST” sh.a.

Gjithashtu po ky ligji i atribuon ERE-s të drejtën për të mbikëqyrur mbajtjen e një niveli të përshtatshëm të kapacitetit rezervë teknik të transmetimit prej Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i cili bashkëpunon edhe me operatorët e transmetimit të vendeve fqinje që është i ndërlidhur, me qëllim garantimin e sigurisë së rrjetit. Rregullat dhe parametrat e cilësisë së funizimit me energji elektrike nga rrjeti i sistemit të transmetimit përcaktojnë kërkesat për cilësinë e furnizimit me energji elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit të sistemit të transmetimit, pjesëmarrësit që operojnë në tregun e energjisë dhe shërbimeve ndihmëse, duke përcaktuar kushtet për përdorimin transparent dhe pa-diskriminim të rrjetit, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

Rregullat e cilësisë së furnizimit përcaktojnë kërkesat dhe parametrat që duhet të përmbushen nga operatori i sistemit të transmetimit dhe nga të gjithë përdoruesit e rrjetit të sistemit të transmetimit, për të siguruar prodhimin (gjenerimin), transmetimin dhe konsumin e energjisë elektrike në një rrjet të qëndrueshëm të përbashkët të energjisë elektrike.

Për sa më sipër argumentuar, në mbështetje të Ligjit Nr. 43/2015 “Mbi Sektorin e Energjisë Elektrike”; neni 7, pika 1; nenit 16, neni 20, pika “g” neni 110, pika 2 si dhe në zbatim të dhe neni 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, Bordi i i ERE-s në vendimin Nr.5, date 27.01.2016 vendosi: Fillimin e procedurave per shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores **“Rregullave të cilësisë së furnizimit dhe performacës së sigurisë së rrjetit të transmetimit”.**

Në zbatim të Rregullave dhe Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, iu dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draft Rregulloren “Për paramentrat e

cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike” për tu konsultuar dhe për të mirepritur komentet e tyre me qëllim përmirësimin e kësaj rregulloreje, në respekt të mbrotjes të të drejtave të klienteve të energjisë elektrike. Lidhur me këto rregullore rezultuan komentet nga palë si “Operatori i Sistemit të Transmetimit” dhe “Shoqata e Mbrojtjes së Tregëtarëve dhe Tregut të Shqipërisë”. ERE e ka konsultuar draft rregulloren dhe me USAID i cili ka paraqitur komentet e tij në lidhje me draft –Rregulloren. Këto komente iu janë bërë me dije të gjitha palëve të interesuara.

7. Rregullorja për “Metodologjinë e llogaritjes së rimbursimit të dëmit ekonomik nga Operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”.

Kjo metodologji hartohet në kushtet kur si rezultat i ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes, Operatorit të Sistemit, i shkaktohen humbje në sistemin e shpërndarjes dhe furnizuesi nuk mund të realizojë matjen e saktë të konsumit të energjisë elektrike në sistemin matës, gjë që mund të sjellë si pasojë moslëshimin e faturës së saktë të energjisë elektrike. Kjo do të penalizojë si klientin ashtu dhe furnizuesin. Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ka përcaktuar detyrimin ligjor të ndarjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Humbjet teknike dhe jo teknike, sjellin një ndikim negativ në sistemin e shpërndarjes, sidomos për shkak të dëmtimeve që i shkaktohen rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe sistemit matës, në pikën e lidhjes midis shoqërisë dhe klienteve. Qëllimi i kësaj metodologjie konsiston në rregullimin e marrëdhënieve midis Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, Furnizuesit dhe Klientëve/Individëve/Subjekteve, të cilët ndërhyjnë në mënyrë të paautorizuar në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, lidhur me rimbursimin e humbjeve ndaj operatorit të sistemit si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes, nga ana e personave të paautorizuar. ERE, në mbështetje të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” neni 16; neni 77, pika 9; neni 110, pika 2; si dhe në zbatim të nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, në vendimin e Bordit Nr. 94, datë 17.06.2016 vendosi Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e ***“Metodologjisë së llogaritjes së rimbursimit të dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”.***

Edhe për këtë akt nënligjor sikurse parashikohet në “Rregullat e Praktikës dhe Proçedurave të ERE”, përmbajtja e kësaj draft metodologjie, iu dërgua për konsultim me të gjitha grupet e interesit.

8. “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

Kontrata e furnizimit me energji elektrike bën pjesë në ato kontrata që quhen kontrata të rregulluara. Këto kontrata rregullojnë marrëdhënien në veprimtarinë e furnizimit për klientët tariforë.

Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, parashikon ndryshime të rëndësishme në kushtet e furnizimit me energji elektrike për *shërbimin universal të furnizimit ndaj konsumatorëve fundorë*. “Shërbim universal i furnizimit” është një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t’u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese. Ky ligj përcakton detyrime më specifike për furnizuesin e ngarkur me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik si dhe të drejta e detyrime të qarta për klientët fundorë.

Hartimi i kontratës për shërbimin universal të furnizimit ndaj klientëve fundorë, ka për qëllim garantimin e standardeve bashkohore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve fundorë, si një detyrim i cili buron nga Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Në këto kushte në mbështetje të nenit 20 gërmat “a” dhe “h”; nenit 80, 81, 82, 83, 84, 85, 94 dhe 96 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s, në Vendimin e tij me Nr.59, date 29.04.2016 vendosi :

Fillimin e proçedurave për miratimin e **“Kushteve të përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Konsumatorët Fundorë”**. Sikurse aktet e sipër përmendura dhe përmbajtja e kësaj draft kontrate, iu dërgua për konsultim të gjitha paleve të treta dhe grupeve të interesit me qëllim përmirësimin e saj në respekt të mbrotjes të të drejtave të klientëve të energjisë elektrike.

Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 25, pika 3 të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Proçedurave të ERE-s” rezultuan të ardhura komentet nga OST sh.a; Ministria e Energjisë dhe Industrisë; MZHETTS, OSHEE sh.a, Autoriteti i Konkurrencë si dhe shoqatat e mbrotjes së konsumatorit. Lidhur me sa më sipër, ERE ka zhvilluar një sërë seancash dëgjimore, me palët të cilat kanë

dërguar opinionet e tyre lidhur me këtë kontratë, në kuadër të miratimit të një procesi sa më transparent dhe gjithë përfshirës.

9. “Kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

Qëllimi i këtyre Rregullave/kushteve, është të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të shërbimit të furnizimit të klientëve të energjise elektrike, përmes vendosjes së kushteve të përgjithëshme, në shërbim të furnizimit me energji elektrike të ofruar nga të Licensuarit në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, për klientët fundore. Kjo rregullore normon marrëdhënien mes furnizuesve dhe të furnizuarve (klientëve fundore) duke paracaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe rolin e ERE në monitorimin e kësaj marrëdhënie.

Ky akt nënligjor në frymen e hartimit të tij ka mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, nëpërmjet një procedurë të drejtë dhe transparente, të barabarte dhe jodiskriminuese, ndaj të gjithë klienteve të energjise elektrike dhe në respekt të të drejtave që kanë klientët e energjisë elektrike për të zgjedhur furnizuesin e tyre vendas ose të huaj, me çmime të parregulluara sipas një marrëveshje furnizimi e cila është në përputhje me rregullat e tregut.

Në këto kushte, në mbështetje të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nenit 16, nenit 20, 79, neni 94, pika 1; nenit 110, pika 2 si dhe në zbatim të nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s, në vendimin e tij Nr. 66, datë 27.05.2016 vendosi: Fillimin e procedurave për miratimin e ***“Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”*** i cili është konsultuar me palët e treta. Në përfundim të afatit të përcaktuar rezultuan të ardhura komentet nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregëtisë dhe Sipërmarrjes; OST sh.a dhe OSHEE sh.a. Këto komente janë objekt i shqyrtimit në ERE.

3.10 Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.

Komunikimi me pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike është një ndër

prioritet e ERE-s, që burojnë nga legjislacioni bazë i sektorit të energjisë elektrike. Në këtë këndvështrim me qëllim ekuilibrimin e interesave të shtetit, të konsumatorëve dhe investitorëve ERE, ka vendosur një bashkëpunim me pjesëtarët e tregut në sektorin e energjisë elektrike për një koordinim sa më të mirë dhe transparent të tregut të energjisë. Konsultimet dhe takimet me operatorët e tregut të energjisë elektrike, përpunimi dhe dhënia në kohë e informacionit të kërkuar nga subjektet e interesuara lidhur me çështjet e tregut të energjisë elektrike, legjislacionit dhe zbatimit të detyrimeve që burojnë prej tij.

3.11 Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit.

Edhe gjatë vitit 2016 ka vijuar puna intesive për përditesimin e faqes zyrtare të internetit të ERE-s, duke ofruar një pasqyrë sa më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. Një nga prioritet kryesor ka qënë dhe mbetet azhurnimi sistematik i faqes së Internetit, duke u ofruar të gjithë të interesuarve një informacion të përditësuar mbi legjislacion primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, të gjitha vendimmarrjet e ERE, publikimi i akteve nënligjore të miratura dhe ato për të cilat është filluar procedura e miratimit dhe priten komentet nga palët e treta; regjistrin e të licensuarëve, kushtet e licencimit. Informacion të detajuar për klientët e energjisë elektrike, mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike, broshurë informuese mbi të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në tregun energjetik. Gjithashtu në faqen zyrtare vazhdon të sigurohet aksesimi dhe plotësimi online i formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit.

Edhe gjatë vitit 2016, faqja e web-it të ERE-s ka vazhduar të ofrojë informacione mbi mbledhjet e Bordit të Komisionerëve, vendimet përkatëse si dhe për veprimtaritë e ERE-s në nivel kombëtar dhe rajonal. Ka vazhduar puna me intensitet për përkthimin në gjuhën Angleze dhe publikimin në faqen zyrtare të ERE-s të të gjitha vendimeve të Bordit si dhe çdo informacion tjetër, i cili lidhet me veprimtarinë e ERE-s.

3.12 Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Prioritet i ERE-s është investimi për një përfaqësim sa më dinjitoz të vendit dhe Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare, duke patur si qëllim përpunimin dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të BE-së.

Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Kjo është një ndër arsyet për të cilat mund të përmendim aktivitetin dhe rolin e ERE-s në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, në organizimin e konferencave ndërkombëtare, në bashkëpunimin me institucionet e tjera për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare, workshopeve apo takimeve multilaterale dhe bilaterale.

Për vitin 2016 ERE ka punuar me një intensitet të lartë për realizimin e bashkëpunimeve sa me frytdhënëse në dobi të sektorit të energjisë të vendit. Duke vendosur këto prioritete, ERE ka punuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si Sekretariati i Energjisë së Vjenës ECRB, MEDREG, ERRA, USAID, NARUC, IGU, Florence School of Regulation etj. Por në forcimin e rolit të ERE-s dhe harmonizimin e kuadrit Rregullator, janë mbajtur gjithashtu marrëdhënie bilaterale me institucione të tjera Rregullatore si motra. Duke realizuar takime të përbashkëta dhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat dhe aktivitetet ndërkombëtare të lidhura me energjinë.

3.12.1 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare.

- ERE është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Evropës Juglindore dhe Euro-Azisë (ERRA), duke realizuar një pjesëmarrje të rregullt në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, në konferencën e përvitshme të Investimeve të ERRA-s takimet e dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Liçensimit e Monitorimit dhe atij të Tarifave e Çmimeve që zhvillohen në vendet anëtare të ERRA-s.
- ERE është anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike dhe gjate vitit 2016 Kryetari i ERE-s Petrit Ahmeti, ka patur dhe rolin e zëvendës presidentit të Rregullatorëve të Mesdheut. Gjithashtu Komisioneri Maksim Shuli është nën kryetar i grupit të punës së Gazit të MEDREG. Kjo tregon angazhimin e ERE-s në arenën ndërkombëtare dhe siguron një përfaqësim për tu shënuar të vendit.

Stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës për konsumatorin, energjitë e rinovueshme, çështjet e gazit, të grupit të punës së elektricitetit duke qene dhe draftues i materialeve të grupeve të

punës.

Përfaqesues të niveleve të larta në ERE kanë marrë pjesë në takimet e Asamblesë së Përgjithshme se MEDREG, takimet e komiteteve drejtues të MEDREG si dhe në takimet e presidencës të MEDREG. Gjithashtu ERE në rolin e zëvendës Presidentit dhe nënkryetarit të grupit të punës së gazit ka mirëpritur një sërë takimesh të MEDREG në Tiranë si takimin e radhës të Presidencës së MEDREG i cili ishte një takim që u pasua më pas me firmosjen e protokollit të bashkëpunimit midis MEDREG dhe PAM(Asamblesë Parlamentare Europiane) .

Gjithashtu ERE në cilësinë e nënkryetarit të grupit të punës së gazit të MEDREG ka mirëpritur dhe zhvillimin e takimit të grupit të punës së gazit të MEDREG në Shqipëri në të cilin përveç vendeve anëtare ishin të ftuar dhe përfaqësues të TAP.

Kjo shoqatë e mbështetur nga Komisioni European është një mundësi e vlefshme në drejtim të njohjes së mundësive, harmonizimit të kuadrit rregullator dhe potencialeve energjetike të Vendeve të Mesdheut. Por në të njëjtën kohë jep mundësinë e vendosjes së një klime mirëkuptimi dhe bashkëpunimi të rregullatorëve të këtyre vendeve për çështje të ndryshme të interesit ndërmjet tyre.

- Për vitin 2016 ERE ka mbajtur një bashkëpunim të frytshëm me USAID dhe NARUC në projektin e përbashkët afatgjatë të përkrahur nga USAID dhe NARUC në lidhje me sfidat e rregullimit në vendet e Europës Juglindore.
- ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit 2016 ka marrë pjesë aktive në Forumet e Energjisë Vjenës, së Athinës, Forumin e Gazit në Lubjanë dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës. Gjithashtu ERE ka marrë pjesë aktivitete duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Sekretariatit të Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për çështjet delikate. Gjithashtu dhe draft vendimet e marra prej nesh si dhe draft rregulloret e hartuara nga ana jone i janë dërguar për konsultim Sekretariatit të Vjenës ose janë realizuar takime me to për të patur një kuptim sa më të mirë të çështjes, si dhe jemi ndihmuar nga Sekretariati i Vjenës në draftimin e akteve sekondare në kuadër të

ligjeve të reja. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës të ECRB për çështjet e konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, burimeve të rinovueshme, statistikave, elektricitetit, eficensës, sigurisë së furnizimit, gazit natyror, platforma e gazit si dhe forumet e organizuara nga Sekretariati i Vjenës si është forumi i ligjit apo forumi i Athinës dhe takimet e Bordit Rregullator të ECRB. Për realizimin e një pune sa më të mirë dhe arritjen e rezultateve të larta, ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatit të Vjenës për sa i përket implementimit të paketës së tretë legislative në kuadër të legjislacionin sekondar i cili ka qënë në proces draftimi dhe miratimi nga Bordi, si dhe për sa i përket procesit të certifikimit si një koncept i ri në implementimin e ligjit të ri të energjisë elektrike dhe të gazit. Vlen të theksohet që ERE ka marrë pjesë edhe në workshopet e organizuara nga ana e Sekretariatit për sigurinë e furnizimit, energjitë të rinovueshme, eficensën, certifikimin e OST sh.a. për energji elektrike dhe certifikimin e TAP si dhe workshopet për statistikave. Përfaqësuesit e Sekretariatit të Vjenës e kanë përkrahur në mënyrë aktive ERE-n për zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë vitit 2016. Institucioni jonë është munduar të përfitojë sa më shumë nga këto aktivitete dhe nga eksperiencia e rregullatorëve të bashkimit Europian, për harmonizimin e legjislacionit, praktikave dhe procedurave me qëllim krijimin e një tregu të përbashkët rajonal të energjisë, transparent, konkurrues, jo diskriminues dhe me akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

3.12.2 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.

Marrëdhëniet bilaterale të ERE-s për vitin 2016 kanë pasur si qëllim të forcojnë kapacitetin institucional të saj dhe vendosjen e bashkëpunimeve sa më të suksesshme në dobi dhe përmirësim të sektorit energjistik të vendit. ERE ka punuar në drejtim të bashkëpunimit bilateral bazuar në marrëveshjet bilaterale, ku mund të përmendim takimet të ndërsjellat me qëllim shkëmbimin e eksperiencës për paketën e trete legislative në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit. Gjatë vitit 2016 janë intensifikuar në mënyrë të mëtejshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (AEEG) si dhe atë Grek (RAE). Ky bashkëpunim ka bërë të mundur realizimin në kohë të vendimeve të përbashkëta të tre rregullatorëve në lidhje me projektin TAP. Gjithashtu gjatë këtij viti ERE ka mbajtur një bashkëpunim aktiv me

institucionet rregullatore të rajonit e më gjerë, ku mund të përmendim Rregullatorin e Kosovës, Francës, Italisë me të cilat ka zhvilluar dhe takime bilaterale për të diskutuar për tematika të caktuara.

3.12.3 Pjesëmarrja në Konferenca dhe Aktivitete Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2016 ERE i ka kushtuar një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare. Interesi i Institucionit tonë në këto aktivitete ka qenë i lartë për t'u njohur me eksperiencat evropiane dhe botërore në sektorin energjetik, gjithashtu dhe zhvillimet më të fundit dhe me gjerë në shkallë botërore duke marrë pjesë në këto aktivitete ndërkombëtare. Ndër aktivitetet më të rëndësishme mund të përmendim Konferencat Evropiane për Energjinë (POWER GEN 2016) në të cilën kryetari i ERE-s në cilësinë e zëvendës-presidentit të MEDREG ishte në një panel diskutimi me përfaqësues të niveleve të larta Evropiane dhe u diskutua për sfidat në Sektorin e Energjisë për vendet e MESDHEUT. Gjithashtu mund të përmendim pjesëmarrjen e ERE-s në DISTRIBUTECH 2016 e cili është një konferencë dhe panair i zhvilluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe përfaqësues të niveleve të larta të sektorit të Energjisë në Shqipëri marrin pjesë.

PJESA IV:Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s

Edhe për vitin 2016 përsa i takon fushës së Burimeve Njerëzore është zbatuar me përpikmëri Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar me ligjin Nr.86/2012 datë

18.09.2012, i ndryshuar me Ligjin Nr.44/2014 datë 24.04.2014 dhe Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik" i ndryshuar me ligjin Nr.85/2012 datë 18.09.2012 dhe Ligjin Nr.45, datë 24.04.2014.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga të 10 zyrtarët (që janë subjekt i këtij detyrimi), sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu kemi marrë pjesë rregullisht në trajnimet e organizuar nga ILDKPKI.

Në zbatim të Vendimit Nr. 181, datë 05.05.2008 të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e strukturës dhe organikës është zbatuar me përpikmëri Ligji Nr. 9584 datë 11.07.2006, "Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", si dhe Vendimi Nr. 589, datë 17.07.2013 "Për miratimin e strukturës dhe te niveleve te pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet ne varësi te këshillit te ministrave, kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit" si dhe Vendimin Nr. 610, datë 24.07.2012 " Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 717, datë 23.06.2009 të këshillit të ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore " të ndryshuar.

Në vijim të Ligjit Nr. 43/2015, datë 30.4.2015 " Për Sektorin e Energjisë" i ndryshuar, për përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin në detyrë të personelit është zbatuar ligji Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Per nëpunësin civil" si dhe të gjithë aktet nënligjore të dalë në funksion të zbatimit me përpikmëri të Ligjit

4.1 Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s

Në fushën e administrimit dhe financës janë zbatuar me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për administrimin e financave të ERE-s, përfshirë ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për “ Prokurimet Publike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe akte te tjera ligjore.

Janë zbatuar të gjitha afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe akteve te tjera nen ligjore.

Gjithashtu, është kryer inventarizimi i pasurisë që ERE ka në administrim. Për sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen nga pagesat e rregullimit që ERE ka vendosur për të licencuarit. Për vitin 2016 të ardhurat e planifikuara nga pagesat e rregullimit janë realizuar 57%.

Bilanci i shpenzimeve të kryera nga ERE, si pjesë e përmbushjes së detyrimit ligjor për të garantuar një punë normale të institucionit, si edhe më parë kanë konsistuar në përmbushjen e nevojave më të domosdoshme që ka pasur ERE gjatë vitit, kurse me kryesorët mund të përmendim:

Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni ynë ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nuk është debitor.

Publikimet për informim të opinionit publik

Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve si ujë, energji elektrike, telefon për të cilat institucioni ynë gjithashtu nuk është debitor, shpenzime për shërbime të domosdoshme për mbarrëvajtjen e punës si dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara etj.

Tarifat e primit te sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, si dhe taksat vjetore të regjistrimit të automjeteve.

Gjithashtu janë kryer procedurat e prokurimeve në kuadër të blerjeve të vogla (si pjesë e Komisionit të blerjeve Vogla) në zbatim të legjislacionit të prokurimeve elektronike për fondet publike.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s gjatë vitit 2016 është audituar nga një ekspert kontabël i regjistruar dhe i licencuar për këtë aktivitet bazuar në ligjin nr. 10091, date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit te miratuar”. Në vijim të këtij paragrafi paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël.

Ludmilla Paluka
Ekspert Kontabel i Regjistruar
Licenca Nr 161, date 25.01.2007
Cel.0692036339

Raport i Audituesit te Pavarur

Per

Entin Regullator te Energjise
Viti ushtrimor i mbyllur me 31.12.2016

Tirane, me 1 Mars 2017

1

Ludmilla Puhka
 Ekspert Kontabel i Regjistruar
 Licenca Nr 161, date 25.01.2007
 Cel.0692036339

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Kryetarit te Entit Regullator te Energjise,

Z. Petrit AHMETI

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te **Entit Regullator te Energjise**, te cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të **Entit Regullator te Energjise** me datën 31 Dhjetor 2016, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

2

Ludmilla Paluka
 Ekspert Kontabel i Regjistruar
 Licenca Nr 161, date 25.01.2007
 Cel.0692036339

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Entit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë.
 Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.
 Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Eksperte Kontabel e Regjistruar
Ludmilla Paluka

Ludmilla Paluka



Rr.H.Hidi, Ndertesa nr 2, Zyra 9, Tirane
 Nr.kontakti 069 20 36 339.

Tirane, me 1 Mars 2017

Emertimi dhe Forma ligjore	Enti Rregullator i Energjise - Ent Publik
NIPT -i	K 51717024 I
Adresa e Selise	Bul "Bajram Curri" Rr "Viktor Eftimiu" Godina KESH Tirane
Data e krijimit	15.10.1995
Nr. i Regjistrimit Tregetar	
Veprimtaria Kryesore	Rregullatori i Tregut te Energjise

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permiresuar dhe Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2016

Pasqyra Financiare jane individuale	po
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara	po
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne	Lek
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne	po (te plote)
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare	Nga 01.01.2016
	Deri 31.12.2016
Data e mbyljes se Pasqyrave Financiare	28.02.2017

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Nr	A K T I V E T	Shenimet	2016	2015
	Aktivitet Afatshkurtra			
	▶ Aktivitet monetare	1	8,167,752	67,459,093
	1 Banka		8,167,752	67,459,093
	2 Arka		0	
	▶ Investime	2	0	0
	1 Në tituj pronësie të njëjësive ekonomike brenda grupit	2.1		
	2 Aksionet e veta	2.2		
	3 Të tjera Financiare	2.3		
	▶ Të drejta të arkëtueshme	3	72,993,553	15,717,915
	1 Kërkesa të arkëtueshme (punonjës)	3.1	27,414	102,615
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit	3.2		
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	3.3		
	4 Të tjera pagesa rregullimi	3.4	72,966,139	15,615,300
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar	3.5		
	▶ Inventarët	4	3,849,381	4,410,424
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	4.1		
	2 Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	4.2		
	3 Produkte të gatshme	4.3		
	4 Mallra	4.4	3,532,221	4,410,424
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)	4.5		
	6 AAGJM të mbajtura për shitje	4.6		
	7 Parapagime për inventar	4.7	317,160	
	▶ Shpenzime të shtyra	5		
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	6		
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		85,010,686	87,587,432
	Aktivitet Afatgjata			
	▶ Aktive financiare	7	0	0
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	7.1		
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit	7.2		
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	7.3		
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	7.4		
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata	7.5		
	6 Tituj të tjerë të huadhënies	7.6		
	▶ Aktivitet materiale	8	13,192,172	4,777,453
	1 Toka dhe ndërtesa	8.1	0	0
	2 Impiante dhe makineri	8.2	1,478,758	2,360,268
	3 Të tjera Instalime dhe pajisje	8.3	11,713,414	2,417,185
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces	8.4		
	▶ Aktivitet biologjike	9		
	▶ Aktive jo materiale:	10	0	0
	1 Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjaj	10.1		
	2 Emri i Mirë	10.2		
	3 Parapagime për AAJM	10.3		
	▶ Aktive tatimore të shtyra	11		
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar	12		
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		13,192,172	4,777,453
	AKTIVE TOTALE		98,202,858	92,364,885

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenimet	2016	2015
▶	Detyrime afatshkurtra:	13	2,991,981	3,901,692
1	<i>Titujt e huamarjes</i>	13.1		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	13.2		
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	13.3		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	13.4		0
5	<i>Deftesa të pagueshme</i>	13.5		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit</i>	13.6		
7	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	13.7		
8	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	13.8	1,210,093	3,841,497
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	13.9	1,584,893	0
10	<i>Të tjera të pagueshme</i>	13.10	196,995	60,195
▶	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	14		
▶	Të ardhura të shtyra	15		
▶	Provizione	16		0
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera		2,991,981	3,901,692
▶	Detyrime afatgjata:	17	0	0
1	<i>Titujt e huamarjes</i>	17.1		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	17.2		
3	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>	17.3		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	17.4		
5	<i>Deftesa të pagueshme</i>	17.5		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit</i>	17.6		
7	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	17.7		
8	<i>Të tjera të pagueshme</i>	17.8		
▶	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	18		
▶	Të ardhura të shtyra	19		0
▶	Provizione:	20	0	0
1	<i>Provizione për pensionet</i>	20.1		
2	<i>Provizione të tjera</i>	20.2		
▶	Detyrime tatimore të shtyra	21		
	Totali i Detyrimeve afatgjata		0	0
	DETYRIMET TOTALE		2,991,981	3,901,692
▶	Kapitali dhe Rezervat	22	95,210,878	88,463,193
▶	Kapitali i Nënshkruar	23		
▶	Primi i lidhur me kapitalin	24		
▶	Rezerva rivlerësimi	25		
▶	Rezerva të tjera	26	0	0
1	<i>Rezerva ligjore</i>	26.1		
2	<i>Rezerva statutore</i>	26.2		
3	<i>Rezerva të tjera</i>	26.3		
▶	Fitimi i pashpërndarë	27		
▶	Fitim / Humbja e Vitit	28		
	Totali i Kapitalit		95,210,878	88,463,193
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		98,202,858	92,364,885

Pasqyra e Performancës
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenimet	2016	2015
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	29	116,826,170	94,209,650
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	30	1,230,064	1,229,112
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	31		
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	32	1,649,561	
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33	0	0
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33.1		
	2 Të tjera shpenzime	33.2		
▶	Shpenzime të personelit	34	-80,051,052	-64,944,562
	1 Paga dhe shpërblime	34.1	-72,910,652	-58,280,469
	2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	34.2	-7,140,400	-6,664,093
▶	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	35	0	0
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36	-2,507,128	-1,919,055
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	37	-33,250,509	-30,300,971
▶	Të ardhura të tjera	38	0	51,187
	1 Të ardhura nga interesi	38.1	0	39,062
	2 Të ardhura nga kursi kembimit	38.2	0	7,425
	3 Të ardhura tjera	38.3	0	4,700
▶	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	39		
▶	Shpenzime financiare	40	-86,044	0
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	40.1		
	2 Shpenzime të tjera financiare	40.2	-86,044	
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	41		
▶	Fitimi/Humbja para tatimit	42	3,811,061	-1,674,639
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	43	0	0
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	43.1		
	2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë	43.2		
	3 Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve	43.3		
▶	Fitimi/Humbja e vitit	44	3,811,061	-1,674,639
▶	Fitimi/Humbja për:	45		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë	45.1		
	Interesat jo-kontrolluese	45.2		

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Nr	Pershkrimi i Elementeve		2016	2015
▶	Fitimi/Humbja e vitit	46	3,811,061	-1,674,639
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	46.1		
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	46.2		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	46.3		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje	46.4		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	46.5		
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	47	0	0
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	48	3,811,061	-1,674,639
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:	49		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë	49.1		
	Interesat jo-kontrolluese	49.2		

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
(metoda indirekte)

	2016	2015
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
<i>Rritje / Pakesim i fondit gjate vitit</i>	3,811,061	-1,874,639
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	2,507,126	1,919,055
<i>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
<i>Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	-57,275,638	-11,117,087
<i>Rënie/(ritje) në inventarë</i>	561,043	-1,121,104
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	-909,711	-3,917,897
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	-51,306,118	-15,911,672
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>		
<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Vlera neto e aktiveve të dhururara-ty</i>	511,822	5,397,985
<i>Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>	-8,497,045	-271,805
<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
<i>Dividendë të arkëtuara</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-7,985,223	5,126,180
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
<i>Rritje/Pakesim i fondit gjate vitit</i>		
<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>Hua të arkëtuara</i>		
<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
<i>Ritëjeje e aksioneve të veta</i>		
<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>Pagesa e huave</i>		
<i>Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>		
<i>Interes i paguar</i>		
<i>Dividendë të paguar</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	0	0
	-59,291,341	-10,785,493
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	-59,291,341	-10,785,493
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 2016	67,459,093	78,244,586
<i>Efëkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2016	8,167,752	67,459,093

SHENIMET SPJEGUESE

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i përmirësuar. Plotësimi i të dhënave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të përcaktuara në SKK 2 të përmirësuar. Rradha e dhënies së shpjegimeve duhet të jetë:

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënime të shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabël i aplikuar: Standardet Kombetare të Kontabilitetit në Shqipëri (SKK 2;)
- 3 Baza e përgatitjes së PF: Mbi bazën e konceptit të materialitetit (SSK 1, 1-3)
- 4 Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare: (SKK 1; 40 - 90)
 1. Parimi i njësisë ekonomike: mban në llogarite e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta.
 2. Parimi i vijimesisë: veprimtaria ekonomike e njësisë sone raportuese është e siguruar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.
 3. Kompensimi: midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK.
 4. Kuptueshmëria e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.
 5. Materialiteti është vlerësuar nga ana jone dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zëra materiale.
 6. Besueshmëria për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme:
 - Parimin e paraqitjes me besnikëri
 - Parimin e përparesisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore
 - Parimin e paaneshmerisë pa asnjë influencim të qëllimshëm
 - Parimin e maturisë pa optimizim të teperuar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm
 - Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të PF.
 - Parimin e qendrueshmërisë për të mos ndryshuar politikën e metodat kontabël
 - Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Për përcaktimin e kostos së inventareve është zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e parë, dalje e parë) (SKK 4;)

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me kosto. (SKK 5;)

Për prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga një hua, koston e huamarrjes (dhe interesat) është metoda e kapitalizimit në koston e aktivitetit për periudhën e investimit. (SKK 5;)

Për vlerësimin e mëposhtëm të AAM është zgjedhur modeli i kostonë duke i paraqitur në bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5;)

Për llogaritjen e amortizimit të AAM (SKK 5;) njësisia jone ekonomike ka përcaktuar si metode të amortizimit të A, Agj, M metodën e amortizimit mbi bazën e vlefes së mbetur ndërsa normat e amortizimit janë përdorur të njëjtoja me ato të sistemit fiskal në fuqi dhe konkretisht:

- Për ndërtesat me 5 % të vlefes së mbetur.
- Komputera e sisteme informacioni me 25 % të vlefes së mbetur
- Të gjitha AAM të tjera me 20 % të vlefes së mbetur

Për llogaritjen e amortizimit të AAJM (SKK 5;) njësisia ekonomike raportuese ka përcaktuar si metode të amortizimit ato lineare me normën e amortizimit 15 % në vit.

Referenca

B Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare**I AKTIVET AFAT SHKURTERA****1 Aktivet monetare**

1.1

Banka

Nr	Emri i Bankes	Monedha	Nr llogarise	Vlera ne valute	Kursi fund vitit	Vlera ne leke
	BKT lek	lek				5,301,722.6
	BKT euro	euro		8968.07		1,212,752
	Raiffeisen	lek				838,088
	Union bank mast.card	euro		2334.69		0
	Union bank lek	lek				470
	Union bank mast.card	euro		5,876.36		794,660
	BKT dollar	dollar		156.53		20,059
Totali						8,167,752

1.2

Arka

Nr	EMERTIMI	Vlera ne valute	Kursi fund vitit	Vlera ne leke
	Arka ne Leke	0		0
	Arka ne Euro	0		0
	Arka ne Dollare	0		0
Totali		0		0

3.1

3 Të drejta të arkëtueshme**72,993,553***Nga aktiviteti i shfrytëzimit*

27,414

Kliente pagesat e rregullimit

72,966,139

> *Fatura te pa likuiduara nen nje vit*

8,436,578

4.4

Mallra> *Iventar I imet ne perdorim***3,849,381**> *Zhvierësimi i mallrave dhe (produkteve) për shitje*

8.1

*Toka dhe ndërtesa***13,192,172**

8.2

Makina

1,478,758

8.3

Të tjera pajise zyre e info

11,713,414

8.4

Parapagime për aktive materiale dhe në proces

13.8

III DETYRIMET DHE KAPITALI**13 Detyrime afatshkurtra:****1,407,088***Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore*> *Paga dhe shpërblime***0**> *Sigurime shoqërore dhe shëndetsore*

1,210,093

> *Detyrime të tjera*

196,995

13.9

Të pagueshme për detyrimet tatimore> *Tatim mbi të ardhurat personale*

1,584,893

17.4

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit> *Furnitorë për mallra, produkte e shërbime mbi nje vit***95,210,878****22 Fondi pasuror I ERE-s****96,617,965****PASIVI****C Shënime të tjera shpjeguese**

Ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat behen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat nuk behen rregullime nuk ka.

Gabime materiale te ndodhura ne perldhat kontabel te mepareshme te konstatuara gjate periudhes rraportuese dhe qe korigjim nuk ka.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Alfredi Buntaku
A. Buntaku

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike



Alfredi Buntaku

Shtojca 1 Regjistri i Vendimeve të ERE-s për Vitin 2016

Nr. 1	Datë 27.01.2016	Mbi kundërshtimin e vendimit të ERE-s nr. 156, datë 24.12.2015, “Mbi lënie në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 140, nr. 141, nr.145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, si dhe të vendimit nr. 27, datë 16.2.2015, të Bordit të Komisionereve të ERE-s për periudhën 1 janar 2016 – 30 qershor 2016”	Fletore zyrtare Nr.22 datë 15.02.2016
Nr. 2	Datë 27.01.2016	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e Kodit të Transmetimit	Fletore zyrtare Nr.22 datë 15.02.2016
Nr. 3	Datë 27.01.2016	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike	Fletore zyrtare Nr.22 datë 15.02.2016
Nr. 4	Datë 27.01.2016	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike	Fletore zyrtare Nr.22 datë 15.02.2016
Nr. 5	Datë 27.01.2016	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të çelësive së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit	Fletore zyrtare Nr.22 datë 15.02.2016
Nr. 6	Datë 27.01.2016	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullave të menaxhimit të kapacitetit ndërkufitar	Fletore zyrtare Nr.22 datë 15.02.2016
Nr. 7	Datë 27.01.2016	Për licencimin e shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore zyrtare Nr.22 datë 15.02.2016

Nr. 8	Datë 27.01.2016	Mbi licencimin e shoqerise “Phoenix Petroleum” sh.a., ne aktivitetin e furnizimit te gazit natyror	Fletore zyrtare Nr.22 date 15.02.2016
Nr. 9	Datë 27.01.2016	Mbi fillimin e procedures per miratimin e kontrates Tip mbi verifikimin e matesve te energjise elektrike dhe vulosjen e tyre	Fletore zyrtare Nr.22 date 15.02.2016
Nr. 10	Datë 27.01.2016	Mbi nje ndryshim ne vendimin nr.157, date 28.12.2015, te Bordit te ERE-s “Per miratimin e nje ndryshimi ne rregullat e tregut shqiptar te energjise elektrike”	Fletore zyrtare Nr.22 date 15.02.2016
Nr. 11	Datë 27.01.2016	Mbi licencimin e shoqerise “Albanian General Eletricity” sh.a., ne aktivitetin e furnizimit te energjise elektrike	Fletore zyrtare Nr.22 date 15.02.2016
